

**Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e
Legjislacionit Mjedisor**

Një projekt për Shqipërinë financuar nga Bashkimi Evropian

Projekt VKM

**për Përmbajtjen, Zhvillimin dhe Zbatimin e Strategjisë Kombëtare
të Ujërave, Planeve të Menaxhimit të Rretheve të Baseneve Lumore
dhe Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet¹**

Drafti 1

Versioni 1

30 Korrik 2010

¹ Ky Vendim transponon: Direktivën 2000/60/EC për Krijimin e Kuadrit për Veprimtarinë e Komunitetit në Fushën e Politikave për Ujërat e amenduar me Direktivën 2008/32/EC dhe Direktivën 2009/31/EC; Direktivën 2009/90/EC për Përcaktimin e Specifikimeve Teknike për Analizat Kimike dhe Monitorimin e Statusit të Ujërave; Direktivën 2006/118/EC Për Mbrojtjen e Ujërave Nëntokësore ndaj Ndotjes dhe Përkeqësimit; dhe Direktivën 2007/60/EC Për Vlerësimin dhe Menaxhimin e Rreziqeve nga Përmbytjet.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

VENDIM

(Drafti 1 Versioni 1 i datës 30 Korrik 2010)

Nr. _____, datë _____

PËR

Përmbajtjen, Zhvillimin dhe Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Ujërave, Planeve të Menaxhimit të Rretheve të Baseneve Lumore dhe Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet²

Në mbështetje të Nenit 100 të Kushtetutës dhe Neneve xxxx të Ligjit nr.____, datë_____ “Për Menaxhimin e Integruar të Ujërave”, Këshilli i Ministrave;

VENDOSI:

² Ky Vendim transponon: Direktivën 2000/60/EC për Krijimin e Kuadrit për Veprimtarinë e Komunitetit në Fushën e Politikave për Ujërat e amenduar me Direktivën 2008/32/EC dhe Direktivën 2009/31/EC; Direktivën 2009/90/EC për Përcaktimin e Specifikimeve Teknike për Analizat Kimike dhe Monitorimin e Statusit të Ujërave; Direktivën 2006/118/EC Për Mbrojtjen e Ujërave Nëntokësore ndaj Ndotjes dhe Përkeqësimit; dhe Direktivën 2007/60/EC Për Vlerësimin dhe Menaxhimin e Rreziqeve nga Përmbytjet.

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky Vendim përcakton përmbajtjen dhe procedurat për zhvillimin dhe zbatimin e:
 - (a) Strategjisë Kombëtare të Ujërave;
 - (b) Planet e Menaxhimit të Rretheve të Baseneve Lumore; dhe
 - (c) Planet e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet.

2. Strategjia Kombëtare e Ujërave, Planet e Menaxhimit të Rretheve të Baseneve Lumore dhe Planet e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet duhet të marrin në konsideratë përkatësisht:
 - (a) Aktet ligjore ndërkombëtare të nënshkruara dhe ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, dhe
 - (b) Politikat dhe legjislacionin e adoptuar nga Bashkimi Evropian, sidomos ato të fushës së politikave për ujërat.

II. Përkufizime

Për qëllim të këtij Vendimi termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

"Trup uhor artificial" është trupi me ujëra sipërfaqësorë i krijuar nga veprimtaria njerëzore (p.sh. rezervuarë, depo ruajtjeje, kanale, pellgje peshku, etj.)

- (a) **"Ujëmbajtës"** është shtresa nësipërfaqësore, ose janë shtresa shkëmbore ose shtresa të tjera gjeologjike me porozitet dhe përshkueshmëri të mjaftueshme për të lejuar ose rrjedhjen e konsiderueshme të ujërave nëntokësore ose nxjerrjen e sasive të konsiderueshme të ujërave nëntokësore.
- (b) **"Burim i disponueshëm me ujëra nëntokësore"** është norma afatgjatë mesatare vjetore e ngarkimit të përgjithshëm të trupit me ujëra nëntokësore minus normën afatgjatë vjetore të rrjedhës së nevojshme për të arritur objektivat e cilësisë ekologjike për ujërat sipërfaqësore që kanë lidhje në mënyrë që të shmangët çdo zvogëlim i dukshëm në statusin ekologjik të ujërave të tilla dhe që të shmangët çdo dëmtim i konsiderueshëm i ekosistemeve tokësore që kanë lidhje.
- (c) **"Niveli bazë"** është vlera mesatare e matur gjatë periudhës së parë për të cilën është e disponueshme një periudhë përfaqësuese e monitorimit të të dhënave.
- (d) **"Niveli i sfondit"** është përqëndrimi i një substance ose vlera e një treguesi në një trup me ujëra nëntokësore që korrespondon me asnjë apo vetëm me pak ndryshime antropogjene në kushte të rregullta.
- (e) **"Biota"** nënkupton të gjitha gjallesat bimore dhe shtazore të një zone të caktuar.
- (f) **"Trup me ujëra nëntokësore"** është vëllimi i veçantë i ujërave nëntokësore brenda ujëmbajtësit apo ujëmbajtësve.

- (g) **"Trup me ujëra sipërfaqësore"** është elementi i dallueshëm dhe i rëndësishëm i ujërave sipërfaqësore të tilla si liqen, rezervuar, përrua, lumë ose kanal, pjesë e një përroi, lumi ose kanali, ujëra tranzitore ose një shtrirje të ujërave bregdetare.
- (h) **"Ujëra bregdetare"** janë ujërat sipërfaqësore në anën me drejtim nga toka të një vije, në një distancë prej një milje detare në anën me drejtim nga deti nga vija bazë prej së cilës matet gjerësia e ujërave territorial, duke u zgjeruar sipas nevojës deri në kufirin e jashtëm të ujërave tranzitore.
- (i) **"Shkarkimi i drejtpërdrejtë në ujërat nëntokësore"** është shkarkimi i ndotësve në ujërat nëntokësore pa filtrim nëpërmjet tokës ose nëntokës.
- (j) **"Statusi ekologjik"** është shprehja e cilësisë së strukturës dhe funksionimit të ekosistemeve ujore që lidhen me ujërat sipërfaqësore, klasifikuar në përputhje me aktet e veçanta ligjore.
- (k) **"Kontrollet e emetimeve"** janë kontrollet që kërkojnë një kufizim specifik për emetimet, për shembull një standard teknik mjedisor, ose ndryshe që specifikojnë kufijtë ose kushtet mbi efektet, natyrën ose kushte të tjera të cilat ndikojnë tek emetimet.
- (l) **"Norma mjedisore e cilësisë së ujit"** është përqëndrimi i një ndotësi të veçantë ose një grupi ndotësish në ujë, sedimenti ose biota (gjithë organizmat bimore dhe shtazore të një krahine) që nuk duhet të tejkalohet në mënyrë që të mbrojtë shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Normat mjedisore të cilësisë duhet të përcaktohen në akte të veçanta ligjore.
- (m) **"Norma teknike e shkarkimeve në mjedis"** ka kuptimin që i është dhënë nga Neni xxx i Ligjit për Mbrojtjen Mjedisore.
- (n) **"Përmbytja"** është mbulimi i përkohshëm nga uji i tokës që normalisht nuk mbulohet nga uji. Kjo do të përfshijë përmbytjet nga lumenjtë, përrenjtë malorë, rrjedhat ujore kalimtare dhe përmbytjet nga deti në zonat bregdetare, por përjashton përmbytjet nga sistemet e kanalizimit.
- (o) **"Rreziku nga përmbytjet"** është kombinimi i probabilitetit të ngjarjes së përmbytjes dhe të pasojave negative të mundshme për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgimninë kulturore dhe aktivitetin ekonomik që lidhet me ngjarjes e përmbytjes.
- (p) **"Potencial i mirë ekologjik"** është potenciali ekologjik i një trupi ujqor tepër të modifikuar ose i një trupi ujqor artificial kur vlerësohet po aq 'i mirë', sa ç'është përcaktuar në aktet ligjore specifike.
- (q) **"Status i mirë ekologjik"** është statusi ekologjik i arritur nga një trup me ujëra sipërfaqësore, kur vlerësohet po aq 'i mirë', saç është përcaktuar në aktet ligjore specifike.
- (r) **"Statusi kimik i mirë i ujërave nëntokësore"** është statusi kimik i një trupi me ujëra nëntokësore, kur vlerësohet po aq 'i mirë', saç është përcaktuar në aktet ligjore specifike.
- (s) **"Statusi sasior i mirë i ujërave nëntokësore"** është statusi sasior i një trupi me ujëra nëntokësore, kur vlerësohet po aq 'i mirë', sa ç'është përcaktuar në aktet ligjore specifike.
- (t) **"Statusi i mirë i ujërave nëntokësore"** është statusi i arritur nga një trup me ujëra nëntokësore, kur so statusi i tij sasior, ashtu edhe statusi

kimik vlerësohen të paktën po aq 'të mirë', saç përcaktohen në aktet ligjore specifike.

- (u) "**Statusi kimik i mirë i ujërave sipërfaqësore**" është statusi kimik i kërkuar për të përmbushur objektivat mjedisore për ujërat sipërfaqësore siç përcaktohet në aktet ligjore specifike.
- (v) "**Statusi i mirë i ujërave sipërfaqësore**" është statusi i arritur nga një trup në ujërat sipërfaqësore, kur si statusi i tij ekologjik ashtu edhe status kimik vlerësohet të paktën po aq 'të mirë', sa ç'është përcaktuar në aktet ligjore specifike.
- (w) "**Ujërat nëntokësore**" janë të gjitha ujërat që ndodhen nën sipërfaqen e tokës në zonën e ngopjes dhe në kontakt të drejtpërdrejt me tokën ose me nëntokën.
- (x) "**Norma e cilësisë së ujërave nëntokësore**" është norma mjedisore e cilësisë e shprehur si përqendrim i një ndotësi të veçantë, një grupi ndotësish ose indikatorit të ndotjes në ujërat nëntokësore, që nuk duhet tejkaluar me qëllim që të mbrohet shëndeti i njeriut dhe mjedisi.
- (y) "**Statusi i ujërave nëntokësore**" është shprehja e përgjithshme e statusit të një trupi me ujëra nëntokësore, i vendosur nga statusi i tij sasior dhe kimike më i varfër.
- (z) "**Substanca të rrezikshme**" ka kuptimin që i është dhënë nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit.
- (aa) "**Trup uJOR tepër i modifikuar**" është trupi me ujëra sipërfaqësore, i cili si rezultat i ndryshimeve fizike nga aktiviteti njerëzor ka ndryshuar karakterin e tij rrënjësisht, siç është shpallur nga autoriteti kompetent në përputhje me legjislacionin përkatës.
- (bb) "**Ujëra të brendshëm**" janë të gjithë ujërat që qëndrojnë ose rrjedhin në sipërfaqen e tokës, dhe të gjitha nëntokësore në anën me drejtim nga toka të vijës bazë prej së cilës matet gjerësia e ujërave territoriale.
- (cc) "**Futja e ndotësve në ujërat nëntokësore**" është hyrja e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë e ndotësve si rezultat i aktivitetit njerëzor.
- (dd) "**Liçeni**" është trupi me ujëra të brendshëm sipërfaqësore të qëndrueshëm .
- (ee) "**Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit**" është Ligji Nr._____, datë _____ "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- (ff) "**Kufiri i zbulimit**" është sinjali i prodhimit ose vlera e përqendrimit mbi të cilën mund të konfirmohet, me një nivel të sigurt besimi se kampioni është i ndryshëm nga një kampion bosh që nuk ka përcaktues interes (me rëndësi).
- (gg) "**Kufiri i kuantifikimit**" është shumëfishi i caktuar i kufirit të zbulimit në një përqendrim të përcaktuesit që mund të vendoset llogjikisht me një nivel të pranueshëm saktësie dhe preçizioni. Kufiri i kuantifikimit mund të llogaritet duke përdorur një standard apo kampion të përshtatshëm, dhe mund të përftohet ngapika më e ulët e kalibrimit në kurbën e kalibrimit, duke përjashtuar pjesën bosh.
- (hh) "**Ndotës**" është çdo substancë e prirur për të shkaktuar ndotje, në veçanti ato të përcaktuara në akte ligjore specifike.
- (ii) "**Ndotës**" ka kuptimin që i është dhënë nga Ligji Për Mbrojtjen e Mjedisit.

- (jj) "**Ndotje**" është futja e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, si rezultat i aktivitetit njerëzor, i substancave ose nxehtësisë në ajër, ujë ose tokë që mund të jenë të dëmshme për shëndetin e njeriut ose cilësinë e ekosistemeve ujore ose ekosistemeve tokësore që varen drejtpërdrejtë nga ekosistemet ujore, që rezultojnë në dëmtimin e pronës, ose që prish ose ndërhyjnë te pajisjet dhe përdorimet e tjera legjitime të mjedisit.
- (kk) "**Substancat prioritare**" janë ato substance që përfshijnë "substancat prioritare të rrezikshme" të listuara në akte ligjore specifike në përputhje me **Nenin xxx [Dir Neni 16 (2)]** për të cilat duhen ndërmarrë masa specifike që synojnë ndalimin ose ndërprerjen e shkarkimeve, emetimeve dhe humbjeve.
- (ll) "**Statusi sasior**" është shprehja e shkallës ndaj së të cilës një trup me ujëra nëntokësore ndikohet nga nxjerrjet e drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta.
- (mm) "**Lumi**" është trupi me ujëra të brendshëm që rrjedh në pjesën më të madhe të tij mbi sipërfaqen e tokës, por që mund të rrjedhë nën tokë në një pjesë të rrjedhës së tij.
- (nn) "**Baseni lumor**" është zona e tokës nga e cila të gjitha rrjedhat sipërfaqësore derdhen përmes një sekuence përrenjsh, lumenjsh dhe, mundësisht liqenesh në lumin që derdhet në det në një grykëderdhje të vetme lumi, grykë të gjerë ose deltë.
- (oo) "**Rrethi i basenit lumor**" zona e tokës dhe e detit, e përbërë nga një ose më shumë basene lumenjsh fqinjë së bashku me ujërat e tyre nëntokësore dhe bregdetare që identifikohet si njësi kryesore për menaxhimin e ujërave të baseneve lumore.
- (pp) "**Tendenca rritëse e konsiderueshme dhe qëndrueshme**" është çdo rritje e konsiderueshme statistikore dhe mjedisore e ndotësit, grupit të ndotësve, ose e indikatorit të ndotjes në ujërat nëntokësore për të cilat kthimi i tendencës identifikohet si i nevojshëm.
- (qq) "**Nën-baseni**" është zona e tokës prej së cilës të gjitha rrjedhat sipërfaqësore derdhen nëpërmjet një sërë përrenjsh, lumenjsh dhe mundësisht liqenesh në një pikë të veçantë të një rrjedhe ujore (normalisht liqen ose bashkërrjedhje lumi).
- (rr) "**Ujërat sipërfaqësore**" janë ujërat e brendshëm, përveç ujërave nëntokësore; ujërat tranzitorë dhe ujërat bregdetare, përveç se në llihdhje me statusin kimik i cili duhet të përfshijë edhe ujërat territoriale.
- (ss) "**Statusi i ujërave sipërfaqësore**" është shprehja e përgjithshme e statusit të një trupi me ujëra sipërfaqësore, përcaktuar nga statusi i tij ekologjik dhe kimik më i varfër.
- (tt) "**Vlera e Pragut**" është standarti i cilësisë së ujërave nëntokësore për ndotës të veçantë, grup ndotësish ose indikatorësh të ndotjes në ujërat nëntokësore që janë identifikuar si kontribues në karakterizimin e trupave ose grupeve të trupave të ujërave nëntokësore që janë në rrezik.
- (uu) "**Pasiguria e matjeve**" është një parametër jo negativ që karakterizon shpërndarjen e vlerave të sasisë që i atribuohet një matjeje, bazuar në informacionin e përdorur.

SHËNIM – duhen kontrolluar të gjitha përkufizimet me projekt Ligjin për Menaxhimin e Ujërave për të shmangur dublikimet (përsëritjen)

3. Të gjithë termat apo shprehjet e tjera të përdorura në këtë Vendim do të kenë kuptimin që u është dhënë nga Ligji "Për Menaxhimin e Ujërave", në qoftë se nuk specifikohet ndryshe.

PJESA 1 Strategjia Kombëtare e Ujërave

Kreu 1. Parimet Bazë

4. Strategjia Kombëtare e ujërave:
 - (a) hartohet bazuar në Nenet xxx dhe xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e Integruar të Ujërave"; dhe
 - (b) është subjekt i procedurës së vlerësimit strategjik mjedisor, siç përcaktohet në akte të tjera.
5. Strategjia Kombëtare e Ujërave është dokumenti bazë i planifikimit afat-gjatë për menaxhimin e integruar të ujërave në Republikën e Shqipërisë.
6. Menaxhimi i integruar i ujërave është një proces që inkurajon zhvillimin e koordinuar të administrimit dhe menaxhimit të ujërave dhe burimeve të lidhura me to me qëllim që të arrihet mirëqenie më e lartë ekonomike dhe sociale, në mënyrë uniforme dhe të pranueshme pa çrregulluar eko-sistemet që varen nga ujërat.

Kreu 2. Përmbajtja e Strategjisë Kombëtare të Ujërave

7. Strategjia Kombëtare e Ujërave duhet të përmbajë, të paktën:
 - (a) parimet dhe kriteret për përcaktimin e menaxhimin e integruar të ujërave;
 - (b) parimet dhe objektivat për ruajtjen dhe përmirësimin e statusit të ujërave si dhe për ujërat dhe ekosistemet e varura nga ujërat;
 - (c) detyrimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare;
 - (d) informacionin bazë dhe vlerësimin e gjendjes së ujërave dhe të sistemeve të ujërave;
 - (e) hartat bazë;
 - (f) parashikimet bazë për menaxhimin e ujërave;
 - (g) parashikimet bazë për planifikimin e zhvillimit të sistemeve të ujërave;
 - (h) planin e aktiviteteve dhe masat për zbatimin e objektivave;
 - (i) marrëveshjet institucionale për zbatimin e objektivave;
 - (j) vlerësimin e kostove financiare të lidhura me menaxhimin e ujërave.
8. Strategjia Kombëtare e Ujërave do të përcaktojë përparësitë në menaxhimin e integruar të ujërave sipas parametrave objektivë të identifikuar, të përshtatur me nevojat aktuale dhe potencialin ekonomik, por që nuk lënë pas dore vizionin integral të zhvillimit të ardhshëm të sistemit të ujërave.

9. Strategjia Kombëtare e Ujërave do të përfshijë gjithashtu edhe një përmbledhje jo-teknike të informacionit të përcaktuar në Paragrafët 8 dhe 9 më lart. Përmbledhja jo-teknike duhet të përmbajë faktet kryesore, vlerësimet dhe propozimet.

Kreu 3. Procedurat për zhvillimin e Strategjisë Kombëtare të Ujërave

10. Strategjia Kombëtare e Ujërave do të përgatitet në përputhje me Nenin xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave".
11. Këshillat e Baseneve Lumore dhe institucionet e tjera do të ofrojnë informacion dhe ndihmë siç kërkohet për zhvillimin e Strategjisë Kombëtare të Ujërave.
12. Së paku dy vjet përpara fillimit të periudhës së cilës i referohet Strategjia Kombëtare e Ujërave, Këshilli Kombëtar i Ujërave përgatit një grafik dhe program pune për krijimin e Strategjisë Kombëtare të Ujërave.
13. Grafiku dhe programi i punës të referuara në Paragrafin 13, duhet të vihen në dispozicion të publikut.
14. Projekt Strategjia Kombëtare e Ujërave duhet botuar të paktën 18 muaj përpara fillimit të periudhës së cilës i referohet Strategjia Kombëtare e Ujërave.
15. Projekt Strategjia Kombëtare të Ujërave e referuar në Paragrafin 15 duhet të vendoset në faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Ujërave dhe në faqen e internetit të Ministrisë.
16. Këshilli Kombëtar i Ujërave e dërgon projekt Strategjinë Kombëtare të Ujërave të referuar në Paragrafin 15 te:
 - (a) Ministri përgjegjës për mjedisin;
 - (b) Ministri përgjegjës për ujërat;
 - (c) Ministri i përgjegjës për pyjet;
 - (d) Ministrat përgjegjës për detin, turizmin, transportin dhe zhvillimin;
 - (e) Ministri përgjegjës për mbrojtjen e natyrës;
 - (f) Ministrat përgjegjës për ekonominë dhe energjinë;
 - (g) Ministri përgjegjës për shëndetësinë;
 - (h) Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
 - (i) Ministra dhe institucione të tjera që, sipas mendimit të Këshillit Kombëtar të Ujërave, kanë lidhje me këtë.
17. Autoritetet e referuara në Paragrafin 17 mund të bëjnë komente mbi projekt Strategjinë Kombëtare të Ujërave. Këto komente mund të jenë në formë të shkruar ose elektronike dhe duhet t'i drejtohen Këshillit Kombëtar të Ujërave. Komentet duhet të bëhen brenda një periudhe gjashtë mujore nga data e botimit të projekt Strategjisë Kombëtare të Ujërave.

18. Projekt Strategjia Kombëtare e Ujërave e referuar në Paragrafin 15 duhet të vihet në dispozicion të publikut.
19. Kur një anëtar i publikut dëshiron të shikojë projekt Strategjinë Kombëtare të Ujërave, ai ka të drejtë ta shikojë atë falas. Kur një anëtar i publikut dëshiron të marrë një kopje të projekt Strategjisë Kombëtare të Ujërave, Këshilli Kombëtar i Ujërave ka të drejtë t'i ngarkojë kostot e arsyeshme për ofrimin e kësaj kopjeje.
20. Çdo anëtar i publikut mund të komentojë projekt Strategjinë Kombëtare të Ujërave. Komente të tilla mund të jetë në formë të shkruar ose elektronike dhe duhet t'i drejtohen Këshillit Kombëtar të Ujërave. Këto komente duhet të bëhen brenda një periudhe gjashtë mujore nga data e botimit të projekt Strategjisë Kombëtare të Ujërave.
21. Këshilli Kombëtar i Ujërave miraton Strategjinë Kombëtare të Ujërave të finalizuar në përputhje me Nenin xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave". Gjatë përgatitjes së Strategjisë përfundimtare Kombëtare të Ujërave, Këshilli Kombëtar i Ujërave merr parasysh komentet e bëra nga ministrinë dhe institucionet e referuara në Paragrafin 17 dhe komentet e bëra nga publiku në përputhje me Paragrafin 21.

Kreu 4. Rishikimi dhe amendimi i Strategjisë Kombëtare të Ujërave

22. Strategjia Kombëtare e Ujërave duhet rishikuar dhe, nëse është e nevojshme, duhet amenduar në vitin 2015 dhe më pas çdo 15 vjet.
23. Dispozitat e Kreut 3 Pjesa 1 të këtij Vendimi do të aplikohen për të gjitha amendimet e Strategjisë Kombëtare të Ujërave.

Pjesa 2 Planet e Menaxhimit të Rretheve të Baseneve Lumore

Kreu 1. Karakteristikat e Rretheve të Baseneve Lumore

24. Për çdo rreth të baseneve lumore të identifikuar në Nenin xxx të Ligjit "Për Administrimin e Ujërave", Këshilli përkatës i baseneve lumore kryen një vlerësimin për atë rreth të baseneve lumore, në përputhje me Nenin xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave".
25. Vlerësimi i rrethit të baseneve lumore i referuar në Paragrafin 25, përfshin:
 - (a) Analizën e karakteristikave të tij, në përputhje me specifikimet e përcaktuara në Aneksin I të kësaj Vendimi, dhe
 - (b) Shqyrtimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore.

26. Vlerësimi i rretheve të baseneve lumore i referuar në Paragrafin 25, duhet të përfshijë gjithashtu edhe analizën ekonomike të përdorimit të ujit, e cila duhet të përmbajë informacion të mjaftueshëm për:
- (a) Të bërë llogaritjet përkatëse të nevojshme për të marrë në konsideratë parimin e rikuperimit të kostove të shërbimit të ujërave të referuara në Nenin xxx të Ligjit "Për Administrimin e Ujërave", duke patur parasysh parashikimin afatgjatë të ofertës dhe kërkesës për ujë në rrethin e baseneve lumore dhe, kur është e nevojshme;
 - i. Të vlerësojë vëllimin, çmimin dhe kostot e lidhura me shërbimet e ujërave, dhe
 - ii. Të vlerësojë investimet përkatëse duke përfshirë parashikimet për investime të tilla;
 - (b) Të bërë vlerësime në lidhje me kombinimin e masave me kosto më shumë efektive, për sa i përket përdorimeve të ujit, që do të përfshihen në programin e masave sipas Aneksit IV bazuar në vlerësimet e kostove potenciale për masa të tilla.
27. Vlerësimi i rretheve të baseneve lumore i referuar në Paragrafin 25 duhet të rishikohet dhe, nëse është e nevojshme, të përditësohet deri në fund të vitit 2013 dhe çdo gjashtë vjet pas këtij viti.
28. Vlerësimi i rretheve të baseneve lumore i referuara në Paragrafin 25 dhe të gjitha rishikimet e referuara në Paragrafin 28 duhet të miratohen nga Këshilli Kombëtar i Ujërave dhe të vendosen në faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Ujërave dhe në faqen përkatëse të internetit të Këshillit të Baseneve Lumore.
29. Vlerësimi i rretheve të baseneve lumore i referuar në Paragrafin 25 dhe të gjitha rishikimet e referuara në Paragrafin 28 duhet të vihen në dispozicion të publikut.

Kreu 2. Planet e Menaxhimit të Rretheve të Baseneve Lumore

30. Për çdo rreth të baseneve lumore të identifikuar në Nenin xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave", Këshilli përkatës i Baseneve Lumore përgatit planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore në përputhje me Nenin xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave".
31. Kur një rreth i baseneve lumore është pjesë e një rrethi baseni lumenjsh ndërkombëtar, Këshilli përkatës i Baseneve Lumore do të bëjë përpjekjet e tij maksimale për t'u koordinuar me autoritetet përkatëse në Shtetet e tjera për të hartuar një plan të vetëm ndërkombëtar të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore në përputhje me Nenin xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave".
32. Plani i menaxhimit të rrethit të baseneve lumore duhet të përmbajë të paktën informacionin e përcaktuar në Aneksin II të këtij vendimi.

33. Planet e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore rishikohen dhe, nëse është e nevojshme përditësohen, në fund të vitit 2015 dhe më pas çdo gjashtë vjet.

Kreu 3. Procedurat për zhvillimin e Planeve të Menaxhimit të Rretheve të Baseneve Lumore

34. Këshilli përkatës i Baseneve Lumore, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Ujërave, boton projekt grafikun dhe programin e punës për hartimin e Planit të Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore, tre vjet para fillimit të periudhës së cilës i referohet Plani i Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore, përfshirë këtu çdo rishikim të referuar në Paragrafin 34. Projekt grafiku dhe programi i punës duhet të përfshijnë veçanërisht afate të qarta kohore, institucionet dhe organizatat me të cilat duhet konsultuar, burimet e sugjeruara për financim si dhe institucionet dhe planin organizativ të sugjeruar për zbatim.
35. Projekt grafiku dhe programi i punës të referuara në Paragrafin 35, vendosen në faqen e internetit të Këshillit përkatës të Baseneve Lumore dhe në faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Ujërave.
36. Këshilli përkatës i Rrethit të Basenit Lumor dërgon projekt grafikun dhe programin e punës të referuara në Paragrafin 35 te:
- (a) Ministri përgjegjës për mjedisin;
 - (b) Ministri përgjegjës për ujërat;
 - (c) Ministri përgjegjës për pyjet;
 - (d) Ministrat përgjegjës për detin, turizmin, transportin dhe zhvillimin;
 - (e) Ministri përgjegjës për mbrojtjen e natyrës;
 - (f) Ministrat përgjegjës për ekonomisë dhe energjinë;
 - (g) Ministri përgjegjës për shëndetësinë;
 - (h) Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
 - (i) Këshillit Kombëtar i Ujërave;
 - (j) Autoritetet e pushtetit vendor në bashkitë brenda rrethit të baseneve lumore;
 - (k) Ministri dhe institucione të tjera që kanë lidhje sipas mendimit të Këshillit të Baseneve Lumore..
37. Autoritetet e referuara në Paragrafin 37 mund të bëjnë komentë për projekt grafikun dhe programin e punës. Këto komente mund të jenë në formë të shkruar ose elektronike dhe duhet t'i drejtohen Këshillit përkatës të Rrethit të Baseneve Lumore. Komentet duhen bërë brenda një periudhe gjashtë mujore nga data e botimit të projekt grafikut dhe programit të punës.
38. Çdo anëtar i publikut mund bëjë komente mbi projekt grafikun dhe programin e punës të referuar në Paragrafin 35. Këto komente mund të jenë në formë të shkruar ose elektronike dhe duhet t'i dërgohen Këshillit përkatës të Baseneve Lumore. Komentet duhen bërë brenda një periudhe gjashtë mujore nga data e botimit të projekt grafikut dhe programit të punës.
39. Këshilli përkatës i Baseneve Lumore, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Ujërave, boton grafikun dhe programin përfundimtar të punës të paktën dy

vjet përpara fillimit të periudhës së cilës i referohet Plani i Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore. Gjatë përgatitjes së grafikut dhe programit përfundimtar të punës, Këshilli përkatës i Baseneve Lumore duhet të marrë në konsideratë të gjitha komentet e bëra nga ministritë dhe institucionet e referuara në Paragrafin 37 si dhe komentet e bëra nga publiku në përputhje me Paragrafin 39.

40. Këshilli përkatës i Baseneve Lumore, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Ujërave, boton një projekt raport të ndërmjetëm të çështjeve të rëndësishme të menaxhimit të ujërave të identifikuar në rrethin e baseneve lumore, dy vjet përpara fillimit të periudhës së cilës i referohet Plani Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore, përfshirë këtu çdo rishikim të referuar në Paragrafin 34.
41. Projekt raporti i ndërmjetëm për çështjet e rëndësishme të menaxhimit të ujërave të referuara në Paragrafin 41, vendoset në faqen e internetit të Këshillit përkatës të Rrethit të Baseneve Lumore dhe në faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Ujërave.
42. Këshilli përkatës i Baseneve Lumore i dërgon autoriteteve të referuara në paragrafin 37 më sipër projekt raportin e ndërmjetëm të çështjeve të rëndësishme të menaxhimit të ujërave të referuara në Paragrafin 41.
43. Autoritetet e përmendur në paragrafin 43 mund të komentojnë mbi projekt raportin e ndërmjetëm të çështjeve të rëndësishme të menaxhimit të ujërave. Këto komente mund të jetë në formë të shkruar ose elektronike dhe duhet t'i drejtohen Këshillit përkatës të Rrethit të Baseneve Lumore. Komentet duhen bërë brenda një periudhë gjashtë mujore nga data e botimit të projekt raportit të ndërmjetëm për çështjet e rëndësishme të menaxhimit të ujërave.
44. Çdo anëtar i publikut mund të bëjë komente për projekt raportin e ndërmjetëm të çështjeve të rëndësishme të menaxhimit të ujërave. Këto komentet e tillë mund të jenë në formë të shkruar ose elektronike dhe duhet t'i drejtohen Këshilli përkatës të Rrethit të Baseneve Lumore. Komentet duhen bërë brenda një periudhe gjashtë mujore nga data e botimit të projekt raportit të ndërmjetëm për çështjet e rëndësishme të menaxhimit të ujërave.
45. Këshilli përkatës i Rrethit të Baseneve Lumore, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Ujërave, boton raportin e ndërmjetëm përfundimtar të çështjeve të rëndësishme të menaxhimit të ujërave të paktën 18 muaj përpara fillimit të periudhës së cilës i referohet Plani i Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore. Gjatë përgatitjes së raportit të ndërmjetëm përfundimtar për çështjet e rëndësishme të menaxhimit të ujërave, Këshilli përkatës i Rrethit të Baseneve Lumore duhet të marrë në konsideratë komentet e bëra nga ministritë dhe institucionet e referuara në Paragrafin 43 si dhe komentet e bëra nga publiku të referuara në Paragrafin 45.
46. Këshilli përkatës i Rrethit të Baseneve Lumore, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Ujërave, boton projekt planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore për rrethin e vet të baseneve lumore një vit përpara fillimit të periudhës

së cilës i referohet Plani i Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore, përfshirë këtu çdo rishikim të referuar në Paragrafin 34.

47. Projekt plani i menaxhimit të rrethit të baseneve lumore i referuar në Paragrafin 47, vendoset në faqen e internetit të Këshillit të Baseneve Lumore dhe në faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Ujërave.
48. Projekt plani i menaxhimit të rrethit të baseneve lumore duhet t'i nënshtrohet procedurave të vlerësimit mjedisor, siç përcaktohet në legjislacionet e tjera.
49. Këshilli përkatës i Baseneve Lumore dërgon projekt planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore të referuar në Paragrafin 47 tek autoritetet e referuara në Paragrafin 37 më lart dhe tek autoritetet përkatëse në Shtetet e tjera kur rrethi i baseneve lumore është pjesë e një rrethi ndërkombëtar të baseneve lumore.
50. Autoritetet e referuara në Paragrafin 50 mund të bëjnë komente mbi projekt planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore. Këto komente mund të jenë në formë të shkruar ose elektronike dhe duhet t'i dërgohen Këshillit përkatës të Baseneve Lumore. Komentet duhen bërë brenda një periudhe gjashtë mujore nga data e botimit të projekt planit të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore.
51. Çdo anëtar i publikut mund bëjë komente mbi projekt planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore. Këto komente mund të jenë në formë të shkruar ose elektronike dhe duhet t'i dërgohen Këshillit përkatës të Baseneve Lumore. Komentet duhen bërë brenda një periudhe gjashtë mujore nga data e botimit të projekt planit të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore.
52. Kur një anëtar i publikut dëshiron të shikojë dokumentat bazë dhe informacionet e përdorura për zhvillimin e projekt planit të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore, ai ka të drejtë ta bëjë këtë falas.
53. Kur një anëtar i publikut dëshiron të bëjë një fotokopje të çfarëdo dokumenti bazë dhe informacioni të përdorur për zhvillimin e projekt planit të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore, Këshilli përkatës i Baseneve Lumore mund t'i ngarkojë një shumë të arsyeshme për ta paguar, që mbulon shpenzimet e fotokopjimit.
54. Këshilli përkatës i Rrethit të Baseneve Lumore organizon seanca dëgjimore publike mbi projekt planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore brenda periudhës gjashtë mujore të referuar në Paragrafin 52.
55. Këshilli përkatës i Rrethit të Baseneve Lumore i dërgon Këshillit Kombëtar të Ujërave projekt planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore të paktën 6 muaj përpara fillimit të periudhës së cilës i referohet Plani i Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore. Gjatë përgatitjes së projekt planit përfundimtar të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore, Këshilli përkatës i Rrethit të Baseneve Lumore duhet të marrë parasysh:

- (a) Të gjitha rezultatet dhe konkluzionet e çdo vlerësimi strategjik mjedisor të referuar në Paragrafin 49,
- (b) Të gjitha komentet e bëra nga ministritë dhe institucionet e referuara në Paragrafin 50,
- (c) Të gjitha Komentet e bëra nga autoritetet përkatëse dhe Shtetet e tjera të referuara në Paragrafin 50,
- (d) Të gjitha komentet e bëra nga publiku sipas të paragrafit 52, dhe
- (e) Të gjitha komentet e bëra gjatë seancave dëgjimore publike të organizuara në përputhje me Paragrafin 55.

56. Këshilli Kombëtar i Ujërave miraton Planin përfundimtar të Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore në përputhje me Nenin xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave".

Kreu 4. Programi i masave

- 57. Këshilli përkatës i Rrethit të Baseneve Lumore krijon një program masash për çdo rreth të baseneve lumore me qëllim që të arrihen objektivat mjedisore të përcaktuara në Aneksin III të këtij Vendimi.
- 58. Programet e masave të referuara në Paragrafin 58 duhet të marrin në konsideratë rezultatet e vlerësimit të kërkuar sipas Pjesës 1, Kreu 1 më lart.
- 59. Programet e masave të referuara në Paragrafin 58 duhet të përfshijnë masat themelore të specifikuara në Aneksin IV Pjesa 1 dhe, kur është e nevojshme, edhe masat shtesë siç është specifikuar në Aneksin IV Pjesa 2.
- 60. Programet e masave të referuara në Paragrafin 58 duhet të hartohen deri në fund të vitit [Direktiva e datës 2009 – 9 vjet pas hyrjes në fuqi].
- 61. Programet e masave të referuara në Paragrafin 58 duhet të vihen në funksionim deri në fund të vitit [Direktiva e datës 2012 – 12 vjet pas hyrjes në fuqi].
- 62. Programet e masave të referuara në Paragrafin 58 duhen rishikuar, dhe nëse është e nevojshme përditësuar, në fund të vitit 2015 dhe më pas çdo gjashtë vjet. Masat e tjera të reja ose të rishikuara, të hartuara sipas programit të përditësuar duhet të vihen në funksionim brenda tre viteve nga hartimi i tyre.
- 63. Pa paragjykuar dispozitat e paragrafit 63, kur monitorimi i statusit të ujërave sipas Pjesës 4 të këtij Kreu, ose të dhëna të tjera që tregojnë se objektivat mjedisore të përcaktuara sipas Aneksit III për trupin ujqor nuk kanë gjasa të realizohen, duhen marrë masa shtesë sipas nevojës me qëllim që të arrihen këto objektiva mjedisore.
- 64. Kur shkaqet e dështimit për realizimin e objektivave mjedisore për një trup ujqor të referuara në Paragrafin 64 janë rezultat i shkaqeve natyrore ose forcave madhore të jashtëzakonshme dhe që nuk mund të parashikohen, në veçanti përmbytjet ekstreme dhe thatësitrat e tejzgjatura, Këshilli përkatës i

Baseneve Lumore mund të vendosë që masat shtesë nuk janë të praktikueshme, subjekt i Paragrafit 6 të Aneksit III.

Pjesa 3 Klasifikimi i trupave ujore

65. Qeveria [Këshilli Kombëtar i Ujërave] klasifikon statusin e trupave ujore në pajtim me dispozitat e Aneksit V të këtij Vendimi dhe sipas dhe të Neneve xxx dhe xx të Ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave".
66. Klasifikimi i trupave ujore i referuar në Paragrafin 66 duhet të rishikohet, dhe nëse është e nevojshme të përditësohet nga fundi i vitit 2015 dhe më pas çdo gjashtë vjet.

Pjesa 4 Monitorimi i statusit të ujërave

67. Këshilli përkatës i Baseneve Lumore haeton programe për monitorimin e statusit të ujërave me qëllim që të krijojë një pasqyrë koherente dhe gjithëpërfshirëse të statusit të ujërave brenda çdo rrethi të baseneve lumore, në pajtim me Nenin xxx të ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave".
68. Monitorimi i programeve të referuara në Paragrafin 68 duhet të miratohet nga Këshilli Kombëtar i Ujërave para se të vihet në funksionim.
69. Monitorimi i programeve të referuara në Paragrafin 68 duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Aneksit V të këtij Vendimi.
70. Specifikimet teknike dhe metodat e standartizuara për analizën dhe monitorimin e statusit të ujërave duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Aneksit VI të këtij Vendimi.
71. Për ujërat sipërfaqësore programet e monitorimit të referuara në Paragrafin 68, duhet të trajtojnë:
 - (a) Vëllimin dhe nivelin ose normën e rrjedhjes në masën përkatëse për statusin ekologjik dhe kimik dhe potencialin ekologjik;
 - (b) Statusin ekologjik;
 - (c) Statusin kimik; dhe
 - (d) Potencialin ekologjik.
72. Për ujërat nëntokësore monitorimi i programeve i referuar në Paragrafin 68, duhet të trajtojë:
 - (a) Statusin kimik; dhe
 - (b) Statusin sasior.
73. Për zonat e mbrojtura të specifikuar në Nenin xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave" programet e monitorimit të referuara në Paragrafin 68, duhet të plotësohen nga specifikime siç përmbahen në legjislacionin e hartuar për këto zona të mbrojtura.

Pjesa 5 Identifikimi i tendencave të konsiderueshme dhe të qëndrueshme në rritje të ndotjes së ujërave nëntokësore

74. Këshilli përkatës i Rrethit të Baseneve Lumore duhet të identifikojë të gjitha tendencat e rëndësishme dhe të qëndrueshme në rritje në përqendrimet e ndotësve, grupeve të ndotësve ose treguesve të ndotjes të gjetur trupa ose grup trupash me ujëra nëntokësore të identifikuar si në rrezik, duke marrë parasysh kërkesat e Aneksit VII të këtij Vendimi.
75. Këshilli përkatës i Baseneve Lumore merr masa në përputhje me Pjesën B të Aneksit VII të këtij Vendimi për të kthyer tendencat të cilat paraqesin rrezik të konsiderueshëm për dëmtimin e cilësisë së ekosistemeve ujore ose ekosistemeve tokësore, për shëndetin e njeriut, ose për përdorime legjitime aktuale ose potenciale të mjedisit ujor, nëpërmjet programit të masave të referuara në Aneksin IV të këtij Vendimi, me qëllim reduktimin progresiv të ndotjes dhe parandalimin e përkeqësimit të ujërave nëntokësore.
76. Plani i Menaxhimit të Këshillit të Rrethit të Baseneve Lumore përmbledh:
- (a) Mënyrën me të cilën vlerësimi i tendencave nga pikat individuale të monitorimit brenda një trupi ose grup trupash me ujëra nëntokësore ka kontribuar në identifikimin, në përputhje me Seksionin 2,5 të Aneksit V të këtij Vendimi, që këto trupa të jenë subjekt i tendencave të konsiderueshme dhe të qëndrueshme në rritje në përqendrimin e çdo ndotësi ose në kthimin e këtyre tendencave, dhe
 - (b) Arsyet për pikat fillestare të përcaktuara për kthimin e tendencave në përputhje me Pjesën B të Aneksit VII të këtij Vendimi.
77. Këshilli përkatës i Rrethit të Baseneve Lumore kryen vlerësime shtesë për tendencat kur është e nevojshme për të vlerësuar ndikimet e shtëllungave ekzistuese të ndotjes në trupat me ujëra nëntokësore që mund të kërcënojnë arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara në Aneksin III të këtij Vendimi, dhe në veçanti ato shtëllunga që rezultojnë nga burime pikë dhe nga toka e kontaminuar.
78. Vlerësimet shtesë për tendencat të referuara në Paragrafin 78 duhet të verifikojnë që shtëllunga të tilla nuk do të zgjerohen, nuk do të përkeqësojnë statusin kimik të trupit ose grupit të trupave me ujëra nëntokësore, dhe nuk paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.
79. Rezultatet e vlerësimeve shtesë për tendencat e referuara në Paragrafin 78, duhet të përmbliidhen në Planin e Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore.

Pjesa 6 Planet e Mbrojtjes nga Përmbytjet

Kreu 1. Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet

80. Këshilli përkatës i Baseneve Lumore, për çdo rreth të basenit lumore të identifikuar në Nenin xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave", bën vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet bazuar në informacionin e disponueshëm apo lehtësisht të derivueshëm, siç janë të dhënat dhe studimet mbi zhvillimet afatgjata, dhe në veçanti ndikimet e ndryshimeve klimaterike në rastin e ndodhjes së përmbytjeve.
81. Vlerësimi paraprak i rreziqeve nga përmbytjet i referuar në Paragrafin 81, duhet të përfshijë të paktën:
- (a) Hartat e rrethit të baseneve lumore në një shkallë të përshtatshme përfshirë edhe kufijtë e baseneve lumore, të gjitha nën-basenet dhe zonat bregdetare, duke treguar topografinë dhe tokën e përdorur;
 - (b) Një përshkrim të përmbytjeve që kanë ndodhur në të kaluarën dhe që kanë patur ndikime të rëndësishme negative për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik dhe për të cilën gjasat e ngjarjeve të ngjashme në të ardhmen janë ende relevante, përfshirë shkallën e tyre të përmbytjes dhe rrugët e bartjes si dhe vlerësimin e ndikimeve të tyre negative;
 - (c) Një përshkrim të përmbytjeve të rëndësishme të cilat kanë ndodhur në të kaluarën, kur mund të parashikohen pasoja të rëndësishme negative të ngjarjeve të ardhshme të ngjashme;
 - (d) Një vlerësim të pasojave potenciale negative të përmbytjeve në të ardhmen për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, duke marrë në konsideratë sa më shumë të jetë e mundur çështje të tilla si:
 - i. topografia,
 - ii. pozicioni i rrjedhave ujore dhe karakteristikat e tyre të përgjithshme hidrologjike e gjeo-morfologjike, duke përfshirë edhe rrafshet e përmbytjeve si zona natyrore retensionit (mbajtjeje),
 - iii. efektivitetin e infrastrukturës mbrojtëse ekzistuese të ndërtuar nga njerëzit,
 - iv. pozicionin e zonave të populluara,
 - v. pozicionin dhe natyrën e zonave me aktivitet ekonomik, dhe
 - vi. zhvillimet afatgjata përfshirë ndryshimet klimaterike nga ndodhja e përmbytjeve.
82. Kur një rreth i baseneve lumore është pjesë e një rrethi ndërkombëtar të baseneve lumore, Këshilli përkatës i Baseneve Lumore duhet të bëjë përpjekjet e tij më të mira për t'u koordinuar me autoritetet përkatëse në Shtetet e tjera, në veçanti përsa i përket shkëmbimit të informacionit përkatës.
83. Vlerësimi paraprak i rreziqeve nga përmbytjet i referuar në Paragrafin 81, duhet të përfundojë të paktën deri në datën [Direktiva datë 22 dhjetor 2011].
84. Vlerësimi paraprak i rreziqeve nga përmbytjet duhet rishikohet dhe në qoftë se është e nevojshme të përditësohet, brenda datës 22 dhjetor 2018 dhe më pas çdo gjashtë vjet. Çdo rishikim tjetër duhet të marrë në konsideratë ndikimin e mundshëm të ndryshimeve klimaterike në ndodhjen e përmbytjeve.

85. Vlerësimi paraprak i rreziqeve nga përmbytjet dhe çdo rishikim referuar në Paragrafin 85, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Ujërave, duhet të vendoset faqen e internetit të Këshillit përkatës të Baseneve Lumore dhe në faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Ujërave, dhe duhet të jetë i disponueshëm për publikun.
86. Këshilli Kombëtar i Ujërave, me propozim të Këshillit të Baseneve Lumore dhe në bazë të vlerësimit paraprak të rreziqeve nga përmbytjet ose të ndonjë rishikimi të referuar në Paragrafin 85, duhet të shpallë zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje.
87. Kur një rreth i baseneve lumore është pjesë e një rrethi ndërkombëtar të baseneve lumore, Këshilli Kombëtar i Ujërave duhet të bëjë përpjekjet e tij më të mira për t'u koordinuar me autoritetet përkatëse në Shtetet e tjera për shpalljen e zonave në rrezik nga përmbytjet të referuara në Paragrafin 87.

Kreu 2. Hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe hartat e riskut nga përmbytjet

88. Këshilli përkatës i Baseneve Lumore, për çdo rreth të baseneve lumore, duhet të përgatisë hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe harta e riskut nga përmbytjet, në shkallën më të përshtatshme, për zonat në rrezik nga përmbytjet, të shpallura sipas Paragrafit 87.
89. Kur një zonë në rrezik nga përmbytjet, është pjesë e një rrethi ndërkombëtar të baseneve lumore, Këshilli përkatës i Baseneve Lumore duhet të shkëmbejë informacion me autoritetet përkatëse në Shtetet e tjera para se të përgatisë hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe hartat e riskut nga përmbytjet të referuara në Paragrafin 89.
90. Hartat e rrezikut nga përmbytjet, të referuara në Paragrafin 89 duhet të mbulojnë zonat gjeografike që mund të përmbyten sipas skenarëve të mëposhtëm:
- (a) Përmbytje me një probabilitet të ulët ose skenarë të ngjarjeve të ekstreme;
 - (b) Përmbytjet me një probabilitet të mesëm (periudha e mundshme e rikthimit ≥ 100 vjet);
 - (c) Përmbytjet me një probabilitet të lartë, sipas nevojës.
91. Për çdo skenar të përmendur në Paragrafin 91 duhet të tregohen elementet e mëposhtme:
- (a) Shkalla e përmbytjes;
 - (b) Thellësia e ujit apo niveli i ujit, sipas nevojës;
 - (c) Shpejtësia e rrjedhjes, ose rrjedha përkatëse e ujit, sipas nevojës.
92. Harta e riskut nga përmbytjet e referuar në paragrafin 89 duhet të tregojë pasojat e mundshme negative lidhur me skenarët e përmbytjeve të referuara në Paragrafin 90 dhe të shprehura në kushtet e mëposhtme:
- (a) Numri i banorëve të prekur potencialisht;
 - (b) Lloji i veprimtarisë ekonomike të zonës së prekur potencialisht;

- (c) Instalimet që janë objekt i kërkesave për mbrojtjen e integruar të mjedisit, siç përcaktohet në legjislacionet e tjera, që mund të shkaktojnë ndotje aksidentale në rast përmytjesh, dhe zonat e mbrojtura me ndikim potencial të identifikuara në Nenin xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave";
- (d) Gjithë informacionin tjetër përkatës e të dobishëm, si përcaktimi i zonave ku mund të ndodhin përmytje me një përmbajtje të lartë të sedimenteve dhe mbetjeve të transportuara, dhe informacion për burime të tjera të rëndësishme të ndotjes.
93. Në rastet kur, sipas mendimit të Këshillit përkatës të Baseneve Lumore, është vendosur niveli i duhur i mbrojtjes për zonat bregdetare, përgatitja e hartave të rrezikut nga përmytjet mund të kufizohet sipas skenarit të referuar në Paragrafin 91 (a).
94. Për zonat në të cilat përmytjet vijnë nga burimet me ujërash nëntokësore, përgatitja e hartave të rrezikut nga përmytjet mund të kufizohet në skenarin e referuar në Paragrafin 91 (a).
95. Hartat e rrezikut nga përmytjet dhe hartat e riskut nga përmytjet të referuara në Paragrafin 89, duhet të përfundojnë maksimumi deri në *datën [Direktiva datë - 22 dhjetor, 2013]*.
96. Hartat e rrezikut nga përmytjet dhe hartat e riskut nga përmytjet duhet të rishikohen dhe në qoftë se është e nevojshme të përditësohen, deri në 22 Dhjetor 2019 dhe më pas çdo gjashtë vjet. Të gjitha këto rishikime duhet të marrin parasysh ndikimin e mundshëm të ndryshimeve klimaterike nga përmytjet.
97. Hartat e rrezikut nga përmytjet dhe hartat e riskut nga përmytjet dhe të gjitha rishikimet e referuara në Paragrafin 97 mund të integrohen në vlerësimin dhe rishikimin e karakteristikave të rretheve të baseneve lumore të referuara në Pjesën 2 Kreu 1 të këtij Vendimi. Në rastet kur nuk janë shumë të integruara, zhvillimi i hartave të rrezikut nga përmytjet dhe dhe hartave të riskut nga përmytjet si dhe të gjitha rishikimet duhet të koordinohen me vlerësimet dhe rishikimet e karakteristikave të rrethit të baseneve lumore.
98. Pas miratimit nga ana e Këshillit Kombëtar të Ujërave, hartat e rrezikut nga përmytjet dhe hartat e riskut nga përmytjet dhe të gjitha rishikimet duhet të vendosen në faqen e internetit të Këshillit përkatës të Baseneve Lumore dhe në faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Ujërave, si dhe të jenë të disponueshme për publikun.

Kreu 3. Planet e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmytjet

99. Këshilli Kombëtar i Ujërave duhet të përcaktojë objektivat e duhura për menaxhimin e rrezikut nga përmytjet për zonat e shapllura në rrezik nga përmytjet sipas Paragrafit 87. Këto objektiva duhet të fokusohen në reduktimin e pasojave të mundshme negative nga përmytjet për shëndetin e

njeriut, mjedisin, trashëgimninë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, dhe në qoftë se duhet, në iniciativat jo-strukturore dhe / ose në reduktimin e mundësisë për përmbytje.

100. Në bazë të hartave të rrezikut nga përmbytjet dhe hartave të riskut nga përmbytjet dhe të gjithë rishikimeve, Këshilli përkatës i Baseneve Lumore duhet të përgatisë planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet të koordinuara në nivelin e rrethit të baseneve lumore, për zonat e përcaktuara në rrezik nga përmbytjet në bazë të Paragrafit 87, në përputhje me Nenin xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave".
101. Planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet duhet të përfshijnë masa për të arritur objektivat e referuara në Paragrafin 100, dhe duhet të përmbajnë komponentët e përcaktuar në Pjesën 1 të Aneksit VIII të këtij Vendimi. Planet duhet të adresojnë të gjitha aspektet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet duke u fokusuar te parandalimi, mbrojtja, gadishmëria, përfshirë parashikimet nga përmbytjet dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe të marrin në konsideratë karakteristikat e baseneve ose nën-baseneve përkatëse të lumore. Planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet mund të përfshijnë gjithashtu promovimin e praktikave të qëndrueshme të përdorimit të tokës, përmirësimin e ruajtjes së ujërave si dhe përmbytjet e kontrolluara të zonave të caktuara në rastin e një ngjarjeje përmbytjeje.
102. Planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet duhet të marrin në konsideratë, sipas rastit:
 - (a) Kostot dhe përfitimet;
 - (b) Shkallën e përmbytjeve dhe rrugët e bartjes së përmbytjeve;
 - (c) Zonat të cilat kanë potencial për të mbajtur ujërat nga përmbytjet, rrafshet natyrore të përmbytjeje;
 - (d) Objektivat mjedisore të referuara në Aneksin III të këtij vendimi;
 - (e) Menaxhimin e tokës dhe të ujërave;
 - (f) Planifikimin hapësinor;
 - (g) Përdorimin e tokës;
 - (h) Ruajtjen e natyrës;
 - (i) Lundrimin; dhe
 - (j) Infrastrukturën e Portit.
103. Kur një rreth i baseneve lumore është pjesë e një rrethi ndërkombëtar të baseneve lumore, Këshilli përkatës i Baseneve Lumore duhet të bëjë përpjekjet e tij më të mira për t'u koordinuar me autoritetet përkatëse në Shtetet e tjera, për të përgatitur një Plan të vetëm ndërkombëtar të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, ose një seri planesh të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet të koordinuar në nivelin ndërkombëtar të rretheve të baseneve lumore. Kur këto plane nuk janë përgatitur, Këshilli përkatës i Baseneve Lumore duhet të përgatisë planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet që mbulojnë të paktën ato pjesë të rrethit ndërkombëtar të baseneve lumore që kalojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për aq sa është e mundur të koordinohet në rrethin ndërkombëtar të baseneve lumore.

104. Kur në një plan të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet propozohet të përfshihen masa, që për nga shkalla dhe ndikimi i tyre, rrisin ndjeshëm rreziqet nga përmbytjet me drejtim nga lart ose poshtë të Shteteve të tjera në të njëjtin basen ose nën-basen lumenjsh, Këshilli përkatës i Baseneve Lumore nuk duhet t'i përfshijë këto masa në planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet derisa këto masa të koordinohen me dhe të aprovohen nga Shtetet e përfshira.
105. Planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet do të adoptohen maksimumi deri në datën nga [Direktiva datë - 22 Dhjetor, 2015].
106. Planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet duhet të rishikohen, dhe nëse është e nevojshme të përditësohen, deri më 22 dhjetor 2021 dhe më pas çdo gjashtë vjet. Çdo rishikim i tillë duhet të përfshijë komponentët e përcaktuar në Pjesën 2 të Aneksit VIII të këtij Vendimi dhe duhet të marrë parasysh të ndikimin e mundshëm të ndryshimeve klimaterike nga ndodhja e përmbytjeve.

Kreu 4. Proçedurat për zhvillimin e Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet

107. Planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet dhe rishikimet e tyre të mëvonshme mund të integrohen në planet e menaxhimit të rretheve përkatëse të baseneve lumore dhe të rishikimet e tyre pasuese. Kur planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet nuk janë shumë të integruara, ato duhet të zbatohen në koordinim me planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore dhe rishikimeve të tyre të mëtejshme si dhe duhet të zbatohen dispozitat e Paragrafëve 109 deri 117 që vijojnë më poshtë.
108. Një vit përpara fillimit të periudhës së cilës i referohet plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, përfshirë çdo rishikim të referuar në Paragrafin 107, Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Ujërave, botojnë projektplanin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.
109. Projekt plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet i referuar në Paragrafin 109, duhet të vendoset në faqen e internetit të Këshillit përkatës të Baseneve Lumore dhe në faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Ujërave.
110. Projekt plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet duhet t'i nënshtrohet proçedurave të vlerësimit mjedisor strategjik, siç përcaktohet në legjisllacionet e tjera.
111. Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të dërgojnë projekt planin mbrojtës të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet tek autoritetet e referuara në Paragrafin 37 më lart dhe tek autoritetet përkatëse në Shtetet e tjera ku rrethi përkatës i baseneve lumore është pjesë e një rrethi ndërkombëtar të baseneve lumore.

112. Autoritetet e referuara në Paragrafin 112 mund të bëjnë komente mbi projekt planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet. Këto komente mund të jenë në formë të shkruar ose elektronike dhe duhet t'i drejtohen Këshillave përkatës të Baseneve Lumore. Komentet duhet të bëhen brenda një periudhe gjashtë mujore nga data e botimit të projekt planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.
113. Çdo anëtar i publikut mund të komentojë projekt planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet. Këto komente mund të jenë në formë të shkruar ose elektronike dhe duhet t'i drejtohen Këshillave përkatës të Baseneve Lumore. Komentet duhet të bëhen brenda një periudhe gjashtë mujore nga data e botimit të projekt planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.
114. Këshilli përkatës i Baseneve Lumore mund të organizojë seanca dëgjimore publike për projekt planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet brenda periudhës gjashtë mujore të referuar në Paragrafin 52.
115. Këshilli përkatës i Baseneve Lumore duhet të dërgojë projekt planin përfundimtar të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet te Këshilli Kombëtar i Ujërave të paktën 6 muaj përpara fillimit të periudhës së cilës i referohet plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet. Gjatë përgatitjes së projekt planit përfundimtar të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të marrin parasysh:
- (a) Të gjitha rezultatet dhe konkluzionet e vlerësimit mjedisor strategjik të referuar në Paragrafin 111,
 - (b) Të gjitha komentet e marra nga ministritë dhe institucionet e referuara në Paragrafin 112,
 - (c) Të gjitha komentet e marra nga autoritetet përkatëse të Shteteve të tjera të referuara në Paragrafin 112,
 - (d) Të gjitha komentet e marra nga publiku në përputhje me Paragrafin 114, dhe
 - (e) Të gjitha komentet e marra nga seancat dëgjimore publike të organizuara në përputhje me Paragrafin 115.
116. Këshilli Kombëtar i Ujërave miraton planin përfundimtar të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, në përputhje me Nenin xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave".

Pjesa 7 Shfuqizimet dhe dispozitat e fundit

Për t'u diskutuar:

A ekziston ndonjë legjislacion që duhet të shfuqizohet / amendohet?

A ekziston ndonjë Strategji Kombëtare të Ujërave që duhet të konsiderohet të jetë një strategji e hartuar sipas këtij vendimi?

A ekzistojnë PMRBL-e që duhet të konsiderohen si plane sipas këtij vendimi?

A ekzistojnë legjislacione (vendime) për klasifikimin e ujërave? A ka nevojë të themi ndonjë gjë për trupat ujqorë ekzistues të klasifikuar tashmë, dhe si lidhet kjo me klasifikimin e ri?

118. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA

Anekset

Aneks I	Karakteristikat e trupave ujqre
Aneks II	Përbajtja minimale e Planeve të Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore
Aneks III	Objektivat mjedisore
Aneks IV	Programet e masave
Aneks V	Klasifikimi i statusit të trupave ujqre
Aneks VI	Specifikimet teknike për analizat kimike dhe monitorimin e statusit të ujërave
Aneks VII	Identifikimi dhe kthimi i tendencave të konsiderueshme dhe të qendrueshme në rritje tek ndotja e ujërave nëntokësore
Aneks VIII	Planet e menaxhimit të rrezikut nga përmytjet

ANEKSI I: Karakteristikat e llojeve të trupave ujqorë

1 UJËRAT SIPËRFAQËSORE

1.1. Karakterizimi i llojeve të trupave me ujëra sipërfaqësore

Këshilli i Rrethit të Baseneve do të identifikojë vendndodhjen dhe kufijtë e trupave me ujëra sipërfaqësore dhe do të kryejë karakterizimin fillestar të të gjithë këtyre trupave në përputhje me metodologjinë e mëposhtme. Këshilli i Rrethit të Baseneve mund të grupojë së bashku trupat me ujëra sipërfaqësore për qëllim të këtij karakterizimi fillestar.

- (i) Trupat me ujëra sipërfaqësore brenda rrethit të baseneve lumore do të identifikohen që bien brenda një prej kategorive të mëposhtme me ujëra sipërfaqësore - lumenj, liqene, ujëra tranzitore ose ujërat bregdetare - ose si trupa me ujëra sipërfaqësore artificial apo trupa ujqorë tepër të modifikuar.
- (ii) Për çdo kategori të ujërave sipërfaqësore, trupat përkatës me ujëra sipërfaqësore brenda rrethit të baseneve lumore do të diferencohen sipas llojit. Këto lloje janë ato të përcaktuara duke përdorur sistemin e identifikuar në nenin 1.2 më poshtë.
- (iii) Trupat me ujëra sipërfaqësore brenda rrethit të baseneve lumore së pari duhet të diferencohen nga eko rajonet përkatëse në përputhje me zonat gjeografike të identikuara në nenin 1.2. Për lumenjtë dhe liqenet, të gjithë këta ujëra janë identifikuar si eko rajoni 'Ballkani Perëndimor Helenik/Grek' në përputhje me Hartën A të Aneksit XI të Direktivës Kuadër për Ujërat (Direktiva 2000/60/EC). Për ujërat tranzitore dhe ujërat bregdetare, të gjithë këto ujëra janë identifikuar si eko rajoni 'Deti Mesdhe' eko në përputhje me Hartën B të Aneksit XI të Direktivës Kuadër për Ujërat. Trupat ujqorë brenda çdo eko rajoni më pas do të diferencohen sipas llojeve të trupave me ujëra sipërfaqësore në bazë të përshkruesve të përcaktuara në tabelat e parashtruara në nenin 1,2 më poshtë.
- (iv) Për trupat me ujëra artificial dhe ata tepër të modifikuar diferencimi do të kryhet në përputhje me përshkruesve për cilëndo nga kategoritë e ujërave sipërfaqësore me të cilën ngjan më tepër trupi me ujëra artificial apo ai tepër i modifikuar.
- (v) Këshilli i Baseneve Lumore duhet të përgatisë hartën ose hartat në formatin GIS për vendodhjen gjeografike të llojeve kaq të diferencuara të trupave me ujëra sipërfaqësore.

1.2. Eko rajonet dhe llojet e trupave me ujëra sipërfaqësore

1.2.1. Lumenjtë

Tipologjia e caktuar	Përshkruesit
Eko-rajoni	Ballkani Perëndimor Helenik/Grek
Lloji	Tipologjia e lartësisë E lartë : >800 m Lartësi e mesme: 200 deri në 800 m Ultësirë: <200 m
	Tipologjia e madhësisë bazuar në zonën e shtrirjes E vogël: 10 deri në 100 km ² E mesme: >100 deri në 1 000 km ² E madhe: >1 000 deri në 10000 km ² Shumë e madhe: >10 000 km ²
	Gjeologjia Gëlqerore Silicore Organike

1.2.2. Liqenet

Tipologjia e caktuar	Përshkruesit
Eko-raioni	Ballkani Perëndimor Helenik/Grek
Lloji	Tipologjia e lartësisë E lartë : >800 m Lartësi e mesme: 200 deri në 800 m Ultësirë: <200 m
	Tipologjia e gjerësisë bazuar në gjerësinë mesatare: <3m 3 deri në 15 m >15 m
	Tipologjia e madhësisë bazuar në sipërfaqen e zonës: 0,5 deri në 1 km ² 1 derin në 10 km ² 10 deri në 100 km ² >100 km ²
	Gjeologjia Gëlqerore Silicore Organike

1.2.3. Ujërat tranzitore

Tipologjia e caktuar	Përshkruesit
Eko-raioni	Deti Mesdhe
Lloji	Bazuar në kripësinë mesatare vjetore <0,5 %: ujëra të ëmbla 0,5 deri në <5 %: oligohalin (ujëra pak të kripura) 5 deri në <18 %: mesohalin (ujëra mesatarisht të kripura) 18 deri në <30%: polihalin (ujëra shumë të kripura) 30 deri në <40%: euhalin (ujëra jashtëzakonisht të kripura)
	Bazuar në vargun baticor mesatar <2 m: mikrobaticor 2 to 4 m: mesobaticor > 4 m: makrobaticor

1.2.4. Ujërat Bregdetare

Tipologjia e caktuar	Përshkruesit
Eko-rajoni	Deti Mesdhe
Lloji	Bazuar në kripësinë mesatare vjetore: <0,5 %: ujëra të ëmbla 0,5 deri në <5 %: oligohalin (ujëra pak të kripura) 5 deri në <18 %: mesohalin (ujëra mesatarisht të kripura) 18 deri në <30%: polyhalin (ujëra shumë të kripura) 30 deri në <40%: euhalin (ujëra jashtëzakonisht të kripura)
	Bazuar në gjerësinë mesatare: Ujëra të cekët: <30 m Të ndërmjetëm: (30 deri në 200 m) Të thellë: >200 m

1.3 Përcaktimi i kushteve referencë sipas llojeve të trupave me ujëra sipërfaqësore

- (i) Duhet përcaktuar kushtet hidromorfologjike dhe fizikokimike sipas llojeve për çdo trup me ujëra sipërfaqësore të karakterizuar në përputhje me seksionin 1.1, që të përfaqësojnë vlerat e elementeve të cilësisë hidromorfologjike dhe fizikokimike të specifikuar në pikën 1.1 të Aneksit V për atë lloj trupi me ujëra sipërfaqësore në statusin e lartë ekologjik siç përcaktohet në tabelën përkatëse në pikën 1.2 të Aneksit V. Duhet përcaktuar kushtet biologjike referencë sipas llojeve që përfaqësojnë vlera të elementeve të cilësisë biologjike të specifikuar në pikën 1.1 të Aneksit V për atë lloj trupi me ujëra sipërfaqësore në statusin e lartë ekologjik siç përcaktohet në tabelën përkatëse në pikën 1.2 të Aneksit V.

- (ii) Gjatë zbatimit të procedurave të parashtuara në këtë seksion për trupat ujore tepër të modifikuar ose me ujëra sipërfaqësore artificial, referencat për statusin e lartë ekologjik duhen interpretuar si referenca të potencialit ekologjik maksimal siç përcaktohet në tabelën 1.2.5 të Aneksit V. Vlerat për potencialin ekologjik maksimal për një trup ujqor duhen rishikuar çdo gjashtë vjet.

- (iii) Kushtet sipas llojeve për qëllimet e pikave (i) dhe (ii) dhe kushtet e referencave biologjike sipas llojeve mund të jenë ose të bazuara në hapësirë ose në modelim, ose mund të rrjedhin nga kombinimi i këtyre metodave. Në rastet kur nuk është e mundur të përdoren këto metoda, Këshilli Kombëtar i Ujërave mund të përdorë gjykimin e ekspertëve për të përcaktuar kushte të tilla. Në përcaktimin e statusit të lartë ekologjik për sa i përket përqendrimeve të ndotësve sintetikë specifike, kufijtë e zbulimit janë ata që mund të arrihen në përputhje me teknikat e mundshme në kohën kur duhet të përcaktohen kushtet sipas llojeve.

- (iv) Për kushtet biologjike referencë sipas llojeve të bazuara në hapësirë, Këshilli Kombëtar i Ujërave duhet të zhvillojë një rrjet referencash për të gjitha llojet e trupave me ujëra sipërfaqësore. Rrjeti duhet të përmbajë një numër të mjaftueshëm territoresh me status të lartë për të siguruar një nivel të mjaftueshëm besimi për vlerat e kushteve referencë, në bazë të ndryshueshmërisë së vlerave të elementeve të cilësisë që korrespondojnë me statusin e lartë ekologjik për ato lloje trupash me ujëra sipërfaqësore dhe teknika modelimi që duhen zbatuar sipas paragrafit (v).

- (v) Kushtet referencë biologjike sipas llojeve në bazë të modelimit mund të vijnë si rezultat i përdorimit ose të modeleve parashikuese ose metodave të parashikimit retrospektiv (që përdorin të dhëna nga ngjarjet e kaluara për qëllime parashikimi). Metodot duhet të përdorin të dhëna historike, paleologjike dhe të dhëna të tjera të disponueshme s' idhe duhet të ofrojnë një nivel të mjaftueshëm besimi për vlerat e kushteve referencë që të sigurojnë që kushtet e rrjedhura në këtë mënyrë janë konsistente dhe të vlefshme për të gjitha llojet e trupave me ujëra sipërfaqësore.
- (vi) Në rastet kur nuk është e mundur të përcaktohen kushte referencë të besueshme sipas llojit për një element cilësie në llojet e trupave me ujëra sipërfaqësore për shkak të shkallës së lartë të ndryshueshmërisë natyrore tek ai element, jo vetëm si rezultat i ndryshimeve sezonale, atëherë ai element mund të përjashtohet nga vlerësimi i statusit ekologjik për atë lloj uji sipërfaqësor. Në rrethana të tilla Këshilli i Baseneve Lumore duhet të deklarojë arësyet për këtë përjashtim në planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore.

1.4. Identifikimi i Trysnive

Këshilli i Baseneve Lumore duhet të mbledhë dhe ruajë informacionin për llojet dhe madhësinë e trysnive antropogjenike të konsiderueshme ndaj të cilave janë të prirur t'u nënshtrohen trupat me ujëra sipërfaqësore në çdo rreth basenesh lumenjsh, në veçanti si më poshtë:

- (a) Vlerësimi dhe identifikimi i ndotjes nga burimet pikë të rëndësishme nga aktivitetet urbane, industriale, bujqësore si dhe instalime e aktivitete të tjera, bazuar, *ndërmjet të tjerash*, në informacionin e mbledhur për sa i përket:
 - (i) Impianteve të trajtimit të ujërave të përdorur urbane;
 - (ii) Instalimeve subjekt i legjislacionit të veçantë për kontrollin dhe parandalimin e integruar të ndotjes; dhe për qëllime të planit fillestar të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore;
 - (iii) Shkarkimit të substancave të rrezikshme në ujë;
 - (iv) Cilësisë së ujërave sipërfaqësore që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm;
 - (v) Cilësisë së ujërave për t'u larë;
 - (vi) Cilësisë së ujërave që përdoren për ujërat e butakëve.
- (b) Vlerësimi dhe identifikimi i ndotjes nga burimet shpërndarëse të rëndësishme, në veçanti nga substancat e përcaktuara në Nenin xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave", nga aktivitetet urbane, industriale, bujqësore si dhe instalime e aktivitete të tjera; bazuar, *ndërmjet të tjerash*, në informacionin e mbledhur sipas:
 - (i) Masave të marra për mbrojtjen e ujërave prej ndotjes nga nitratat nga burime bujqësore;
 - (ii) Masave të marra për mbrojtjen e ujërave nëntokësore dhe mjedisit nga efektet potencialisht të rrezikshme të të gjitha produkteve mbrojtëse të impianteve apo mbetjeve të të gjitha substancave aktive;
 - (iii) Masave të marra për mbrojtjen e ujërave nëntokësore dhe mjedisit nga efektet potencialisht të rrezikshme të të gjitha biocideve;

dhe për qëllime të planit të parë të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore:

 - (vii) Shkarkimeve të substancave të rrezikshme në ujë;
 - (viii) Cilësisë së ujërave sipërfaqësore që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm;
 - (ix) Cilësisë së ujërave për t'u larë;

- (x) Cilësisë së ujërave që përdoren për ujërat e butakëve.
- (c) Vlerësimi dhe identifikimi i nxjerrjes së konsiderueshme të ujërave për përdorime urbane, industriale, bujqësore dhe përdorime të tjera, përfshirë ndryshimet sezonale dhe kërkesën vjetore totale, dhe humbjet e ujit në sistemin e shpërndarjes.
- (d) Vlerësimi dhe identifikimi i ndikimit të rregulloreve për rrjedhat e konsiderueshem ujore, përfshirë transferimet dhe devijimet e ujit, në karakteristikat e përgjithshme të rrjedhës dhe balancat e ujërave.
- (e) Identifikimi i ndryshimeve të rëndësishme morfologjike tek trupat ujorë.
- (f) Vlerësimi dhe identifikimi i ndikimeve të tjera antropogjenike të rëndësishme në statusin e ujërave sipërfaqësore.
- (g) Vlerësimi i modeleve të përdorimit të tokës, përfshirë identifikimin e zonave kryesore urbane, industrial dhe bujqësore dhe, ku ka lidhje, zonave të rritjes së peshkut dhe pyjeve.

1.5. Vlerësimi i Ndikimit

- i. Këshilli i Baseneve Lumore duhet të kryejë një vlerësim të sensibilitetit të statusit të ujërave sipërfaqësore të trupave ndaj trysnive të identifikuara më sipër.
- ii. Këshilli i Baseneve Lumore duhet ta përdorë informacionin e mbledhur më sipër, dhe çdo informacion tjetër përkatës përfshirë të dhënat ekzistuese të monitorimit të mjedisit, për të kryer një vlerësim të probabilitetit që trupat me ujëra sipërfaqësore brenda rrethit të baseneve lumore nuk do të arrijnë të përmbushin objektivat e cilësisë mjedisore të përcaktuara për trupat sipas Aneksit III të këtij Vendimi. Këshilli i Baseneve Lumore mund të përdorë teknikat e modelimit për të asistuar në një vendim të tillë.
- iii. Për trupat e identifikuar në rrezik për mospërmbushjen e objektivave të cilësisë mjedisore, karakterizimi i mëtejshëm duhet të, ku duhet, kryhet në mënyrë që të optimizojë hartimin si të programeve të monitorimit ashtu edhe të programeve të masave që kërkohen sipas Aneksit IV të këtij Vendimi.

2. UJËRAT NËNTOKËSORE

2.1. Karakterizimi fillestar

Këshilli i Baseneve Lumore duhet të kryejë një karakterizim fillestar të të gjithë trupave me ujëra nëntokësore për të vlerësuar përdorimet e tyre dhe shkallën ndaj së cilës janë në rrezik për mospërbushjen e objektivave për çdo trup me ujëra nëntokësore sipas Aneksit III të këtij Vendimi. Këshilli i Baseneve Lumore mund të grupojë trupat me ujëra nëntokësore së bashku për qëllime të këtij karakterizimi fillestar. Kjo analizë mund të vërë në përdorim të dhëna ekzistuese hidrologjike, geologjike, pedologjike, për përdorimin e tokës, shkarkimet, nxjerrjen dhe të dhëna të tjera, por duhet të identifikojë:

- (a) vendodhjen dhe kufijtë e trupit ose trupave me ujëra nëntokësore,
- (b) trysnitë ndaj së cilave trupi ose trupat me ujëra nëntokësore është/janë të prirur/a t'i nënshtrohen përfshirë:
 - i. burimet shpërndarëse të ndotjes
 - ii. burimet pikë të ndotjes
 - iii. nxjerrjen
 - iv. rimbushjen artificiale,
- (c) karakterin e përgjithshëm të shtresave mbivendosëse në zonën e shtrirjes prej së cilës trupi me ujëra nëntokësore rimbushet,
- (d) ato trupa me ujëra nëntokësore për të cilat ekzistojnë ekosisteme me ujëra sipërfaqësore s ose ekosisteme tokësore drejtpërsëdrejti të varura nga to.

2.2. Karakterizimi i mëtejshëm

Në vijim të karakterizimit fillestar, Këshilli i Baseneve Lumore duhet të kryejë karakterizimin e mëtejshëm të atyre trupave apo grupeve të trupave me ujëra nëntokësore që janë identifikuar në rrezik me qëllim që të përcaktohet një vlerësim më i saktë për rëndësinë e këtij rreziku dhe identifikimin e të gjitha masave që kërkohen sipas Aneksit IV të këtij Vendimi. Në përputhje me rrethanat, ky karakterizim, duhet të përfshijë informacionin përkatës mbi ndikimin e aktivitetit njerëzor dhe, ku duhet, informacion për:

- (a) karakteristikat gjeologjike të trupave me ujëra nëntokësore përfshirë shkallën dhe tipin e njësive gjeologjike,
- (b) karakteristikat hidrogjeologjike të trupave me ujëra nëntokësore përfshirë përçueshmërinë hidraulike, porozitetin dhe izolimin,
- (c) karakteristikat e depozitave sipërfaqësore dhe tokës në zonën e shtrirjes prej së cilës trupi me ujëra nëntokësore rimbushet, përfshirë trashësinë, porozitetin, përçueshmërinë hidraulike, dhe veçoritë absorbuese të depozitave dhe tokës,
- (d) karakteristikat e shtresëzimit të ujërave nëntokësore brenda trupit me ujëra nëntokësore,
- (e) inventarin e sistemeve përkatëse sipërfaqësore, përfshirë ekosistemet tokësore dhe trupat me ujëra sipërfaqësore, me të cilat trupi me ujëra nëntokësore është i lidhur në mënyrë dinamike,
- (f) përlogaritjet për drejtimet dhe kurset e shkëmbimit të ujërave ndërmjet trupit me ujëra nëntokësore dhe sistemeve përkatëse sipërfaqësore,

- (g) të dhëna të mjaftueshme për të llogaritur normën mesatare vjetore afatgjatë të rimbushjes së përgjithshme,
- (h) karakterizimin e përbërjes kimike të ujërave nëntokësore, përfshirë specifikimin e kontributeve nga aktiviteti njerëzor. Këshilli i Baseneve Lumore mund të përdorë tipologji për karakterizimin e ujërave nëntokësore kur përcakton nivelet natyrore të sfondit për këta trupa me ujëra nëntokësore.

2.3. Rishikimi i ndikimit të aktivitetit njerëzor në ujërat nëntokësore

Për trupat me ujëra nëntokësore të cilat kalojnë kufijtë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe një ose më shumë shteteve ose që, sipas karakterizimit fillestar të ndërmarrë në përputhje me paragrafin 2.1, janë identifikuar në rrezik për të përmbushur objektivat e përcaktuara për çdo trup ujrë sipas Aneksit III të këtij Vendimi, ku nevojitet, duhet mbledhur dhe ruajtur informacioni i mëposhtëm për çdo trup me ujëra nëntokësore:

- (a) vendodhja e pikave në trupat me ujëra nëntokësore që përdoren për nxjerrjen e ujit me përjashtim të:
 - pikave për nxjerrjen e ujit prej të cilave sigurohet mesatarisht më pak se 10 m³ në ditë, ose,
 - pikave për nxjerrjen e ujit të destinura për konsum njerëzor prej të cilave sigurohet mesatarisht më pak se 10 m³ në ditë ose që u shërbejnë më pak se 50 personave,
- (b) normat mesatare vjetore të nxjerrjes nga këto pika,
- (c) përbërja kimike e ujit të nxjerrë nga trupat me ujëra nëntokësore,
- (d) vendodhja e pikave në trupat me ujëra nëntokësore në të cilat shkarkohen ujërat drejtpërsëdrejti,
- (e) normat e shkarkimit në pika të tilla,
- (f) përbërja kimike e shkarkimeve në trupat me ujëra nëntokësore, dhe
- (g) përdorimi i tokës në zonën ose zonat e shtrirjes prej të cilave trupi me ujëra nëntokësore rimbushet, përfshirë prurjet e ndotësve dhe ndryshimet antropogjenike në karakteristikat e rimbushjes siç janë ujërat e shiut dhe ndryshimi i drejtimit të rrjedhjeve nëpërmjet izolimit të tokës, rimbushjes artificial, vendosjes së digave ose kullimit.

2.4. Rishikimi i ndikimit të ndryshimeve në nivelet e ujërave nëntokësore

Këshilli i Baseneve Lumore duhet të identifikojë gjithashtu trupat me ujëra nëntokësore për të cilët do të specifikohen objektiva më të ulëta sipas Annex III të këtij Vendimi përfshirë si rezultat i marrjes në konsideratë të efekteve të statusit të trupave në:

- (i) ekosistemet e ujërave sipërfaqësore dhe ekosistemet të oksore e lidhura me to;
- (ii) rregullimin e ujërave, mbrojtjen nga përmytjet dhe sistemet e kullimit të tokave;
- (iii) zhvillimin njerëzor

2.5. Rishikimi i ndikimit të ndotjes në cilësinë e ujërave nëntokësore

Këshilli i Baseneve Lumore duhet të identifikojë trupat me ujëra nëntokësore për të cilët do të përcaktohen objektiva më të ulëta sipas Aneksit III të këtij Vendimi, kur, si rezultat i ndikimit të aktivitetit njerëzor, siç përcaktohet në Paragrafin 25 të këtij Vendimi, trupi me ujëra nëntokësore është kaq i ndotur sa arritja e statusit të mirë kimik të ujërave nëntokësore është jo praktike dhe jashtëzakonisht e shtrenjtë.

Aneksi II : Përmbajtja Minimale e Planeve të Menaxhimit të Rretheve të Baseneve Lumore

A. Planet e Menaxhimit të Rretheve të Baseneve Lumore duhet të trajtojnë elementët e mëposhtëm:

1. Përshkrimin e përgjithshëm të karakteristikave të rrethit të baseneve lumore të kërkuar sipas Paragrafit 25 dhe Aneksit I.

Ky duhet të përfshijë:

- 1.1 Për ujërat sipërfaqësore:

- Përcaktimin në hartë të vendndodhjes dhe kufijve të të gjithë trupave ujore,
- Përcaktimin në hartë të eko-rajoneve dhe tipat e trupave ujore sipërfaqësore brenda basenit lumor,
- Identifikimin e kushteve të referencës për tipat e trupave ujore sipërfaqësore

- 1.2 Për ujërat nëntokësore:

- Përcaktimin në hartë të vendndodhjes dhe kufijve të trupave me ujëra nëntokësore;
- Listën e vlerave përkatëse të pragut, duke përfshirë çdo ndryshim të listës nga versionet e mëparshme të planit të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore;
- Përmbledhjen e vlerësimit të statusit kimik të ujërave nëntokësore;
- Shpjegimin për mënyrën me të cilën janë marrë në konsideratë tejkallimet e standardeve të cilësisë të ujërave nëntokësore ose vlerat e pragut në pikat individuale të monitorimit;
- Përmbledhjen për mënyrën me të cilën janë krijuar vlerat e pragut. Kjo duhet të përfshijë në veçanti, ku është e mundur/praktike;

- (a) informacion për numrin e trupave ujore ose të grupeve të trupave ujore të karakterizuar si të rrezikuar dhe të ndotësve dhe treguesve të ndotjes që kontribuojnë për këtë klasifikim, duke përfshirë përqendrimet /vlerat e vërejtura;
- (b) informacion për numrin e trupave ujore të karakterizuar si të rrezikuar, në mënyrë të veçantë madhësinë e trupave, marrëdhëniet ndërmjet trupave me ujëra nëntokësore dhe me ujëra sipërfaqësore të lidhura me to, dhe ekosistemeve tokësore të varura drejtpërsdrejti prej tyre, si dhe, në rastin e substancave natyrore që ndodhen, nivelet e sfondit natyror në trupat me ujëra nëntokësore;
- (c) vlerat prag, nëse ato zbatohen në nivel kombëtar, në nivelin e rrethit të baseneve lumore ose pjesën e rrethit të baseneve lumore ndërkombëtarë brenda territorit të Shqipërisë, apo në nivelin e një trupi ose grup trupash me ujëra nëntokësore;
- (d) marrëdhëniet ndërmjet vlerave të pragut dhe:
 - (i) në rastin e substancave që ndodhen në mënyrë natyrore, nivelet e vërejtura të sfondit,
 - (ii) objektivat mjedisore të cilësisë dhe standarte të tjera për mbrojtjen e ujërave që ekzistojnë në nivel kombëtar, Komunitar ose ndërkombëtar, dhe
 - (iii) të gjithë informacionit përkatës përsa i përket toksikologjisë, eko-toksikologjisë, vazhdueshmërisë, potencialit për bioakumulim, dhe tendencës për shpërhapjen e ndotësve.

2. Përmbledhjen e trysnive të rëndësishme dhe ndikimit të aktivitetit të njeriut mbi statusin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, duke përfshirë:

- përlogaritjen e burimit pikë të ndotjes,
- përlogaritjen e burimit të përhapjes së ndotjes, duke përfshirë një përmbledhje të përdorimit të tokës,

- përllogaritjen e trysnive mbi statusin sasior të ujërave, duke përfshirë nxjerrjet,
 - Analizën e ndikimeve të tjera nga aktiviteti njerëzor mbi statusin e ujërave;
3. Identifikimin dhe përcaktimin në hartë të zonave të mbrojtura siç kërkohet nga Neni xxxxx i ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave
 4. Hartën e rrjeteve monitoruese të krijuar për qëllimet e Pjesës 4 dhe Aneksit V të këtij Vendimi, dhe paraqitjen në hartë të rezultateve të programeve të monitorimit të kryera sipas këtyre dispozitave për statusin e:
 - 4.1. Ujërave sipërfaqësore (ekologjike dhe kimike);
 - 4.2. Ujërave nëntokësore (kimike dhe sasiorë);
 - 4.3. Zonave të mbrojtura;
 5. Listën e objektivave mjedisore të krijuara nën Aneksin III për ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore dhe zonat e mbrojtura, duke përfshirë në veçanti identifikimin e rasteve kur përdorimi është bërë sipas Paragrafeve (4), (5), (6) dhe (7), dhe informacionit përkatës, të kërkuar nën atë Aneks;
 6. Përmbledhjen e analizave ekonomike të ujërave të përdorur siç kërkohet nga Paragrafi 27;
 7. Përmbledhjen e programit ose programeve të masave të adoptuara sipas Aneksit IV, duke përfshirë mënyrat me të cilat do të arrihen objektivat e përcaktuara në Aneksin III;
 - 7.1. Përmbledhjen e masave që kërkohen për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e ujërave;
 - 7.2. Raportin mbi hapat praktike dhe masat e ndërmarra për të zbatuar parimin e rikuperimit të kostove të përdorimit të ujit në përputhje me Nenin xxxx të ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave";
 - 7.3. Përmbledhjen e masave të ndërmarra për të përmbushur kërkesat e Neneve xxxxx të ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave" për ujin që përdoret për nxjerrjen e ujit të pijshëm;
 - 7.4. Përmbledhjen mbi kontrollet e nxjerrjes dhe mbylljes (depozitimit) të ujit, duke përfshirë referencat të regjistrat dhe identifikimet e rasteve kur janë bërë përjashtime sipas Aneksit IV (3) (e);
 - 7.5. Përmbledhjen e kontrolleve të adoptuara për burimet pikë të shkarkimeve dhe aktiviteteve të tjera me ndikim në statusin e ujit në përputhje me dispozitat e Aneksit IV (3) (g) dhe 11 (3) (i);
 - 7.6. Identifikimin e rasteve kur janë autorizuar shkarkime të drejtpërdrejta në ujërat tokësore në përputhje me dispozitat e Aneksit IV (3) (j);
 - 7.7. Përmbledhjen e masave të ndërmarra kundër ndotjes së ujërave nga substancat prioritare siç përcaktohet në Nenin xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave";
 - 7.8. Përmbledhjen e masave të ndërmarra për të parandaluar ose reduktuar ndikimin e incidenteve të ndotjes aksidentale;
 - 7.9. Përmbledhjen e masave të ndërmarra sipas Aneksit IV (5) për trupat ujore të cilat kanë gjasa për të mos përmbushur objektivat e përcaktuara në Aneksin III;
 - 7.10. Detajet e masave shtesë të identifikuara si të nevojshme me qëllim që të përmbushen objektivat e përcaktuara mjedisore;
 - 7.11. Detajet e masave të ndërmarra për të shmangur rritjen e ndotjes në ujërave detare në përputhje me Aneksin IV (6);
 8. Regjistrit e programeve më të detajuara dhe planeve të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore që lidhen me nën-basene të veçantë, sektorë, çështje ose lloje uji, së bashku me përmbledhjen e përmbajtjes së tyre;
 9. Përmbledhjen e informacionit publik dhe masave të ndërmarra nga konsultimet, rezultatet e tyre dhe ndryshimet e bëra në planin si rrjedhim i tyre;
 10. Listën e autoriteteve përkatëse kompetente për menaxhimin e ujërave;
 11. Pikat e kontaktit dhe procedurat për marrjen e dokumentacionit bazë dhe informacionit të referuar në Pjesën 2 të Kreut 3 të këtij Vendimi, dhe në veçanti detajet e masave të kontrollit të adoptuara në

përputhje me Aneksin IV (3) (g) dhe (3) (i) dhe të dhënave aktuale të monitorimit të mbledhura në përputhje me Pjesën 4 dhe Aneksin V.

B. Përditësimi i parë i Planit të Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore të gjitha përditësimet e tjera pasuese duhet të përfshijnë gjithashtu:

1. Përmbledhjen e ndryshimeve ose përditësimeve që nga botimi i versionit të mëparshëm të Planit të Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore, duke përfshirë përmbledhjen e rishikimeve që duhen kryer në përputhje me Aneksin III-të (4), (5), (6) dhe (7);
2. Vlerësimin e progresit të bërë drejt arritjes së objektivave mjedisore, duke përfshirë prezantimin e rezultateve të monitorimit për periudhën e planit të mëparshëm në formë harte, dhe shpjegimin për objektivat mjedisore të cilat nuk janë arritur ende;
3. Përmbledhjen, dhe shpjegimin për masat e parashikuara në versionin e mëparshëm të planit të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore, të cilat nuk janë ndërmarrë;
4. Përmbledhjen e masave të tjera të ndërmjetme shtesë të adoptuara sipas Aneksit IV (5) që nga botimi i versionit të mëparshëm të Planit të Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore.

Aneksi III Objektivat Mjedisore

1. Në bërjen operacionale të programeve të masave të specifikuar në Planet e Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore, Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të:
 - (a) për ujërat sipërfaqësore:
 - (i) të zbatojë masat e nevojshme për të parandaluar përkeqësimin e statusit të të gjithë trupave me ujëra sipërfaqësore, që i nënshtrohen zbatimit të paragrafëve 6 dhe 7 dhe pa paragjykuar paragrafin 8;
 - (ii) të mbrojnë, të rrisë dhe të rinovojë të gjithë trupat me ujëra sipërfaqësorë, që i nënshtrohen zbatimit të nënparagrafit (iii) për trupat ujore artificiale dhe trupat ujore tepër të modifikuar, me qëllim arritjen e statusit të mirë të ujërave sipërfaqësore maksimumi deri në fund të vitit 2015, në përputhje me dispozitat e parashtruara në Aneksin V, që i nënshtrohen zbatimit të shtyrjeve të përcaktuara në përputhje me paragrafin 4 dhe zbatimit të paragrafëve 5, 6 dhe 7 pa paragjykuar paragrafin 8;
 - (iii) të mbrojnë dhe të përmirësojnë të gjithë trupat ujore artificiale dhe ata tepër të modifikuar, me qëllim arritjen e potencialit ekologjik të mirë dhe status të mirë kimik të ujërave sipërfaqësore maksimumi deri në fund të vitit 2015, në përputhje me dispozitat e vendosura në Aneksin V, që i nënshtrohen zbatimit të shtyrjeve të përcaktuara në përputhje me paragrafin 4 dhe zbatimit të paragrafëve 5, 6 dhe 7 pa paragjykuar paragrafin 8;
 - (iv) të zbatojë masat e nevojshme me qëllim reduktimin progresiv të ndotjes nga substancat prioritare dhe ndalimin ose shkrirjen e emetimeve, shkarkimeve dhe humbjeve të substancave të rrezikshme prioritare.
 - (b) për ujërat nëntokësore:
 - (i) të zbatojë masat e nevojshme për të parandaluar ose kufizuar futjen e ndotësve në ujërat tokësore dhe për të parandaluar përkeqësimin e statusit të të gjitha trupave me ujëra nëntokësore, që i nënshtrohen zbatimit të paragrafëve 6 dhe 7 dhe pa paragjykuar paragrafin 8 dhe subjekt i kufizimeve për shkarkimet e drejtpërdrejta të ndotësve në ujërat tokësore siç përcaktohet në Aneksin IV (3) (j);
 - (ii) të mbrojnë, të rrisë dhe të rinovojë të gjithë trupat me ujëra nëntokësore, të sigurojnë një ekuilibër mes nxjerrjes dhe rimbushjes së ujërave nëntokësore, me qëllim arritjen e statusit të mirë të ujërave nëntokësore maksimumi deri në fund të vitit 2015, në përputhje me dispozitat e parashtruara në Aneksin V, që i nënshtrohen shtyrjeve të përcaktuara në përputhje me paragrafin 4 dhe zbatimit të e paragrafëve 5, 6 dhe 7 pa paragjykuar paragrafin 8 dhe subjekt i kufizimeve për shkarkimet e drejtpërdrejta të ndotësve në ujërat nëntokësore siç përcaktohet në Aneksin IV (3) (j);
 - (iii) të zbatojë masat e nevojshme për të kthyer të gjitha tendencat e konsiderueshme dhe të qëndrueshme në rritje të përqëndrimit të të gjithë ndotësve që rezultojnë nga ndikimi i

aktivitetit njerëzor, me qëllim që të reduktohet në mënyrë progressive ndotja e ujërave nëntokësore.

- (c) për zonat e mbrojtura:
- (i) të arrijë përmbushjen e të gjitha standarteve dhe objektivave maksimumi deri në fund të vitit 2015, në rast se nuk specifikohet ndryshe në legjislacionin sipas të cilit janë krijuar zonat e mbrojtura individuale.
2. Kur më shumë se një nga objektivat e paragrafit 1 lidhet me një trup ujqor të caktuar, duhet të zbatohen masat më të rrepta.
3. Këshilli përkatës i Baseneve Lumore mund të shpallë një trup me ujëra sipërfaqësore si artificial apo tepër të modifikuar, kur:
- (a) ndryshimet ndaj karakteristikave hidromorfologjike të atij trupi që do të jenë të nevojshme për arritjen e statusit të mirë ekologjik do të kenë efekte të kundërta në:
 - (i) mjedisin e gjerë;
 - (ii) lundrim, duke përfshirë edhe fasilitetet e portit, apo aktivitetet rekreative;
 - (iii) aktivitete për të cilat ujërat janë ruajtur, të tilla si furnizimi me ujë të pijshëm, prodhimi i energjisë ose ujitja;
 - (iv) rregullimin e ujit, mbrojtjen nga përmbytjet, kullimin e tokës; ose
 - (v) aktivitete të tjera njerëzore po aq të rëndësishme të zhvillimeve të qëndrueshme.
 - (b) objektivat përfituese llogjikisht nuk mund të arrihen me mjete të tjera që janë variant mjedisor shumë më i mirë, si rezultat i karakteristikave artificiale ose të modifikuara të trupave ujqore, për arsye të praktikitetit / fizibilitetit teknik apo kostove tepër të larta.
 - (c) ky përcaktim dhe arsyet për të duhet të përmenden veçanërisht në planet e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore dhe të rishikohen çdo gjashtë vjet.
4. Afatet e vendosura në paragrafin 1 mund të shtyhen me qëllim që të realizohet arritja me faza e objektivave për trupat ujqore, me kusht që të mos ndodhin përkeqësime të mëtejshme në statusin e trupit ujqor të prekur kur janë përmbushur të gjitha kushtet që vijojnë:
- (a) Këshillat përkatës të Baseneve Lumore përcaktojnë se të gjitha përmirësimet e nevojshme në statusin e trupave ujqore llogjikisht nuk mund të arrihen brenda afatit kohor të përcaktuar në këtë paragraf për të paktën një nga arsyet e mëposhtme:

- (i) shkalla e përmirësimeve të kërkuara mund të arrihet vetëm në fazat që e tejkalojnë afatin kohor, për arsye të fizibilitetit teknik;
 - (ii) realizimi i përmirësimeve brenda afatit kohor do të kushtonte shumë shtrenjtë;
 - (iii) kushtet natyrore nuk lejojnë përmirësimin në kohë të statusit të trupit ujqor.
- (b) Shtyrja e afatit dhe arsye të për këtë, janë përcaktuar në mënyrë specifike dhe janë shpjeguar në planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore.
- (c) Shtyrjet e afatit duhet të kufizohen në një maksimum prej dy përditësimesh të mëtejshme të planit të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore, përveç rasteve kur kushtet natyrore janë të tilla që nuk lejojnë arritjen e objektivave brenda kësaj periudhe.
- (d) Përmbledhja e programit të masave të kërkuara në Paragrafin 58 të cilat janë parashikuar si të nevojshme për të sjellë trupat ujqorë në mënyrë progresive në statusin e kërkuar brenda afatit të shtyrë, arsye të gjitha vonesat e konsiderueshme gjatë vënies në funksionim të masave, dhe grafiku i pritshëm për zbatimin e tyre janë përcaktuar në planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore. Rishikimi i këtyre masave dhe përmbledhja e masave shtesë duhet të përfshihen në përditësimin e planit të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore.
5. Këshillat përkatës të Baseneve Lumore mund të synojnë që të arrijnë objektiva mjedisore më pak strikte se sa ato të kërkuara sipas paragrafit 1 trupa ujqore specifike kur ata ndikohen shumë nga aktiviteti njerëzor, siç përcaktohet në përputhje me Paragrafin 25, ose gjendja e tyre natyrore është e tillë që arritja e këtyre objektivave do të jetë jopraktike ose të shumë e shtrenjtë, dhe që të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:
- (a) nevojat mjedisore dhe socio-ekonomike si rezultat i aktiviteteve njerëzore nuk mund të arrihen me mënyra të tjera, që janë alternativë mjedisore që nuk kërkojnë shpenzime shumë të larta;
 - (b) Këshillat përkatëse të baseneve Lumore sigurojnë që,
 - (i) për ujërat sipërfaqësore, është arritur statusi më i lartë i mundshëm ekologjik dhe kimik, në sajë të ndikimeve që llogjikisht nuk mund të shmangeshin për shkak të natyrës së aktivitetit njerëzor apo të ndotjes,
 - (ii) për ujërat nëntokësore, kanë ndodhur ndryshimet më të vogla të mundshme për statusin e mirë të ujërave nëntokësore, në sajë të ndikimeve që nuk mund të shmangeshin për shkak të natyrës së aktivitetit njerëzor ose ndotjes;
 - (c) nuk do të ndodhin përkeqësime të mëtejshme në statusin e trupave ujqorë të prekur;

(d) përcaktimi i objektivave mjedisore më pak strikte, si dhe arsyet për këtë, janë përmendur veçanërisht në planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore dhe këto objektiva janë rishikuar çdo gjashtë vjet.

6. Përkeqësimi i përkohshëm në statusin e trupave ujore nuk do të shkelë kërkesat e këtij Vendimi, në qoftë se kjo gjë është rezultat i rrethanave të shkaqeve natyrore ose *forcave madhore* të jashtëzakonshme apo që llogjikisht nuk mund të parashikohen, në veçanti përmbytjet ekstreme dhe thatësitat e stërzgjatura, ose rezultatet e rrethanave për shkak të aksidenteve që nuk mund të parashikohen, kur plotësohen të gjitha kushtet që vijojnë:

(a) janë ndërmarrë të gjitha hapat praktike për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të statusit dhe me qëllim për të mos kompromentuar arritjen e objektivave të ligjit "Për Menaxhimin e Ujërave" dhe të këtij Vendimi në trupat e tjerë ujore që nuk ndikohen nga këto rrethana;

(b) kushtet, nën të cilat rrethanat që përjashtohen ose që llogjikisht nuk mund të parashikohen mund të deklarohen, duke përfshirë adoptimin e indikatorëve të duhur, janë konstatuar në planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore;

(c) masat që do të merren në bazë të rrethanave të tilla të jashtëzakonshme janë përfshirë në programin e masave dhe nuk do të komprometojnë rikuperimin e cilësisë së trupit ujqor pasi rrethanat të kenë kaluar;

(d) efektet e rrethanave të jashtëzakonshme ose që llogjikisht nuk mund të parashikohen, rishikohen çdo vit, dhe në varësi të arsyeve të përcaktuara në paragrafin 4 (a), të gjitha masat praktike janë ndërmarrë me qëllim për të rikthyer trupin ujqor në statusin e tij para efekteve të këtyre rrethanave sa më shpejt që të jetë e mundur praktikisht, dhe

(e) përmbledhja e efekteve të rrethanave dhe këtyre masave të ndërmarra ose që do të ndërmerren në përputhje me paragrafët 6 (a) dhe 6 (d) janë të përfshira në përditësimin e ardhshëm të planit të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore.

7. Nuk do të jetë shkelje e këtij Vendimi, kur:

(a) mos arritja e statusit të mirë të ujërave nëntokësore, statusit të mirë ekologjik, ose kur është e mundur, potencialit të mirë ekologjik, ose mos parandalimi i përkeqësimit të statusit të një trupi me ujëra sipërfaqësore apo nëntokësore është rezultat i modifikimeve të reja të karakteristikave fizike të një trupi me ujëra sipërfaqësore ose i ndryshimeve në nivelin e trupave me ujëra nëntokësore, apo

(b) mos parandalimi i përkeqësimit/kalimit nga statusi i lartë në status të mirë të një trupi me ujëra sipërfaqësore është rezultat i aktiviteteve të reja njerëzore të zhvillimit të qëndrueshëm njerëzor,

dhe të gjitha kushtet e mëposhtme janë plotësuar:

(i) janë ndërmarrë të gjitha hapat praktike për të zbutur ndikimin negativ në statusin e trupit ujqor;

- (ii) arsyet për këto modifikime apo ndryshime janë përcaktuar dhe shpjeguar në mënyrë specifike në planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore dhe objektivat janë rishikuar çdo gjashtë vjet;
 - (iii) arsyet për këto modifikime janë në interesin thelbësor publik dhe / ose përfitimet për mjedisin dhe shoqërinë për të arritur objektivat e përcaktuara në paragrafin 1 janë mbizotëruese nga përfitimet e modifikimeve apo ndryshimeve të reja për shëndetin e njeriut, ruajtjen e sigurisë njerëzore apo zhvillimin e qëndrueshëm, dhe
 - (iv) objektivat përfituese si rezultat i këtyre modifikimeve apo ndryshimeve të trupit ujqor nuk mund të arrihen për arsye të fizibilitetit teknik apo të kostove shumë të larta, me mënyra të tjera që janë një variant mjedisor konsiderueshëm më i mirë.
8. Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore duhet të sigurojnë që zbatimi i paragrafëve 3, 4, 5, 6 dhe 7 nuk përjashton në mënyrë të përhershme apo nuk kompromenton arritjen e objektiveve të këtij Vendimi në trupa të tjerë ujqorë brenda të njëjtit rreth të baseneve lumore dhe është në përputhje me zbatimin e legjislacioneve të tjera për mjedisin.

Pjesa 1 Masat bazë

Masat bazë janë kërkesat minimale për t'u përmbushur dhe duhet të konsistojnë në:

1. Masat e kërkuara për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e ujërave, përfshirë masat e kërkuara sipas legjislacionit:
 - (a) Për ujin e pijshëm
 - (b) Për ujërat për banjë
 - (c) Për shkarkimin e substancave të rrezikshme në ujë
 - (d) Për kontrollin dhe parandalimin e integruar të ndotjes
 - (e) Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet e mëdha që përfshijnë substancat e rrezikshme
 - (f) Për trajtimin e ujërave urbane të përdorura
 - (g) Për llumrat nga ujëraët e zeza
 - (h) Për mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratet nga burimet bujqësore
 - (i) Për produktet për mbrojtjen e bimëve
 - (j) Për mbrojtjen e zogjve të egër
 - (k) Për mbrojtjen e habitateve
 - (l) Për vlerësimin e ndikimit në mjedis
2. Masat e nevojshme me qëllim zbatimin e parimit të rikuperimit të kostove për shërbimet për ujërat në përputhje me Nenin xxx të Ligjit "Për Menaxhimin e ujërave".
3. Masat e nevojshme për të promovuar një përdorim eficient dhe të qëndrueshëm të ujërave me qëllim shmangien e kompromentimit të arritjes së objektivave mjedisore të specifikuar në Aneksin III të këtij Vendimi.

4. Masat e nevojshme për të mbrojtur të gjitha trupat ujore që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm që ofrojnë mesatarisht më shumë se 10m³ në ditë ose që i shërbejnë më shumë se 50 personave, dhe të gjitha trupave ujorë të synuar për përdorim të tillë në të ardhmen.
5. Masat e domosdoshme për të ruajtur cilësinë e ujrave në mënyrë që të reduktohet niveli i trajtimit për purifikimin e kërkuar për prodhimin e ujit të pijshëm.
6. Kontrolllet gjatë nxjerrjes së ujërave të ëmbla sipërfaqësore dhe nëntokësore, dhe ruajtjen e ujëra sipërfaqësore të ëmbla.
7. Kontrolllet gjatë rimbushjeve artificiale ose shtimit të nivelit të trupave me ujëra tokësore.
8. Kontrolllet mbi shkarkimet e burimeve pikë përgjegjëse për shkaktimin e ndotjeve.
9. Kontrolllet mbi burimet shpërndarëse përgjegjëse për shkaktimin e ndotjeve.
10. Kontrolllet mbi të gjitha ndikimet e tjera të rëndësishme negative në statusin e ujërave të identifikuar në Kreun 2 Pjesa 1 dhe Aneksin I i këtij Vendimi, në veçanti masat për të siguruar që kushtet hidro-morfologjike të trupave ujorë janë në përputhje me arritjen e statusit të kërkuar ekologjik ose potencialeve të mira ekologjike për trupat ujore të shpallur si artificial apo tepër të modifikuar.
11. Ndalimi i shkarkimeve të drejtpërdrejta të ndotësve në ujë, subjekt i dispozitave të mëposhtme:
 - (a) Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në marrëveshje me Këshillin përkatës të Baseneve Lumore, mund të autorizojë ri-futjen e ujërave të përdorur në të njëjtin ujëmbajtës për qëllime gjeotermale
 - (b) Me kusht që shkarkime të tilla nuk e kompromentojnë arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara për atë trup të veçantë me ujëra nëntoëksore, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në marrëveshje me Këshillat përkatës të Baseneve Lumore mund të autorizojë, në varësi të kushteve të specifikuar;
 - i. injektimin e ujërave që përmbajnë substanca që rrjedhin nga operacionet për eksplorim dhe nxjerrjen e hidrokarbureve ose aktivitetet minerare, dhe injektimin e ujërave për arsye teknike, në formacionet gjeologjike nga të cilat janë nxjerrë hidrokarburet ose substancat e tjera, ose në formacione gjeologjike të cilat për arsye natyrore janë në mënyrë të përhershme të papërshtatshme për qëllime të tjera. Këto injektime nuk duhet të përmbajnë substanca të tjera përveç atyre që rezultojnë nga operacionet e mësipërme,

- ii. ri-injektimin e ujërave nëntokësore të pompuara nga minierat dhe guroret ose atyre që kanë lidhje me ndërtimin apo mirëmbajtjen e punimeve të inxhinjerisë së ndërtimit,
 - iii. injektimin e gazit natyror ose e gazit të lëngshëm të naftës (GLN), për qëllime ruajtje në formacione gjeologjike të cilat për arsye natyrore janë në mënyrë të përhershme të papërshtatshme për qëllime të tjera,
 - iv. injektimin e rrymave të dioksidit të karbonit për qëllime ruajtjeje në formacionet gjeologjike, të cilat për arsye natyrore janë në mënyrë të përhershme të papërshtatshme për qëllime të tjera, me kusht që ky injektim të jetë në përputhje me legjislacionin specifik për ruajtjen gjeologjike të dioksidit të karbonit,
 - v. injektimin e gazit natyror ose gazit të lëngshëm të naftës (GLN), për qëllime ruajtje në formacione të tjera gjeologjike ku ka nevoja thelbësore për sigurimin e furnizimit me gaz, dhe ku ky injektim është i tillë që parandalon çdo rrezik aktual ose të ardhshëm për përkeqësimin e cilësisë së ujërave nëntokësore që merrën,
 - vi. ndërtimin, punimet e ndërtimit dhe inxhinjerisë së ndërtimit dhe aktivitete të ngjashme, mbi ose në tokë e cila është në kontakt me ujërat nëntokësore,
 - vii. shkarkimet në sasi të vogla të substancave për qëllime shkencore për karakterizimin, mbrojtjen ose rehabilitimin e trupave ujore të kufizuar në sasinë e nevojshme për qëllimet në fjalë.
12. Masave për eliminimin e ndotjes së ujërave sipërfaqësore nga substancat prioritare siç përcaktohet në Nenin xxx të ligjit "Për Manaxhimin e Ujërave" dhe reduktimin progresiv të ndotjes nga substanca të tjera që në të kundërt do të shmangnin arritjen e objektivave mjedisore për trupat ujore, siç përcaktohet në Aneksin III të këtij Vendimi.
13. Masat e kërkuara për të parandaluar humbjet e rëndësishme të ndotësve nga instalimet teknike, dhe për të parandaluar dhe / ose për të reduktuar ndikimin e incidenteve të ndotjes aksidentale për shembull si rezultat i përmbytjeve, duke përfshirë edhe ato nëpërmjet sistemeve për të zbuluar ose për të paralajmëruar për ngjarje të tilla përfshirë, në rastin e aksidenteve që llogjikisht nuk mund të parashikohen, të gjitha masat e përshtatshme për të zvogëluar rrezikun për ekosistemet ujore.
14. Masat e nevojshme për të parandaluar futjen e substancave të rrezikshme në ujërat nëntokësore.
15. Masat e nevojshme për të kufizuar futjen e ndotësve jo të rrezikshëm që janë konsideruar se paraqesin rrezik ekzistues ose potencial për ndotjen e ujërave nëntokësore, si edhe për të siguruar që këto futje nuk shkaktojnë përkeqësim ose tendenca të konsiderueshme dhe

të qëndrueshëm në rritje në përqendrimet e ndotësve në ujërat nëntokësore. Këto masa duhet të marrin në konsideratë, të paktën, praktikat më të mira të krijuara, duke përfshirë këtu Praktikën më të Mirë Mjedisore dhe Teknikat më të Mira të Mundshme.

16. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në marrëveshje me Këshillat përkatës të Baseneve Lumore, mund të përjashtojë nga masat e listuara më sipër në paragrafët 14 dhe 15 futjen e ndotësve që:

- i. konsiderohen nga Këshillat përkatës të Baseneve Lumore se janë në sasi dhe përqendrim aq të vogël sa mund të shmangin çdo rrezik aktual ose të ardhshëm të përkeqësimit të cilësisë së ujërave nëntokësore marrëse;
- ii. janë pasoja të aksidenteve ose rrethanave të jashtëzakonshme nga shkaqet natyrore që nuk mund të ishin parashikuar, shmangur ose zbutur;
- iii. janë rezultate të rimbushjes artificiale ose shtimit të nivelit të trupave me ujëra nëntokësore të autorizuar në përputhje me paragrafin 11 më sipër;
- iv. në këndvështrimin e Këshillave përkatës të Baseneve Lumore, të paafta për arsye teknike për të shmangur apo kufizuar pa përdorur:
 1. masat që do të rrisnin rrezikun për shëndetin e njerëzve ose për cilësinë e mjedisit në tërësi; ose
 2. masat me kosto shumë të larta për të larguar sasinë e ndotësve, ose ndryshe për të kontrolluar filtrimin e tyre në tokën ose nëntokën e kontaminuar
- v. rezultat i ndërhyrjeve në ujërat sipërfaqësore për qëllim, midis të tjerash, të zbutjes së efekteve nga përmblytjet dhe thatësitë, si dhe për menaxhimin e ujërave dhe rrugëve ujore, duke përfshirë edhe ato në nivel ndërkombëtar. Këto aktivitete, duke përfshirë prerjen, pastrimin nëpërmjet gërmimit, rivendosjen (zhvendosjen) dhe depozitim të sedimenteve në ujërat sipërfaqësore, duhet të kryhen në përputhje me rregullat e përgjithshme detyruese, dhe ku është e zbatueshme, me lejet dhe autorizimet e lëshuara në bazë të rregullave të tilla, zhvilluar nga Ministria për këtë qëllim, me kusht që futje të tilla nuk kompromentojnë arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara për trupat ujore në fjalë në përputhje me Aneksin III.

Përjashtimet e parashikuara në pikat (i) deri në (v) të mund të përdoren vetëm kur Këshillat përkatës të Baseneve Lumore kanë përcaktuar se është kryer monitorimi eficient apo janë kryer monitorime të tjera të përshtatshme për trupat ujore në fjalë, në përputhje me pikën 2.4.2 të Aneksit V.

17. Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të mbajnë një inventar të përjashtimeve të referuara në paragrafin 16.

18. Kur është teknikisht e mundur duhet marrë në konsideratë futja e ndotësve nga burimet shpërndarëse të ndotjes që ka ndikim në statusin kimik të ujërave nëntokësore.

Pjesa 2 Masat plotësuese

Masat plotësuese janë ato masa që hartohen dhe zbatohen përveç masave bazë që kanë për qëllim arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara në përputhje me Aneksin III.

Më poshtë është një listë jo ekskluzive e masave plotësuese që mund të adoptohet brenda çdo rrethi të baseneve lumore:

1. kontrollet e emetimeve
2. kodet e praktikës së mirë
3. rigjenerimi dhe restaurimi i zonave ligatina
4. kontrollet e nxjerrjes
5. masat e menaxhimit të kërkesës, duke përfshirë, promovimin e prodhimit bujqësor të adoptuar si të lashtat që kërkojnë pak ujë në zonat e prekura nga thatësira
6. masat e efikasitetit dhe të ri-përdorimit, duke përfshirë, promovimin e teknologjive me efikasitet të ujit në industri dhe teknikat e ujitjes që kursejnë ujin
7. projektet e ndërtimit
8. impiantet e dekrupimit (largimit të kripës)
9. projektet e rehabilitimit
10. rimbushjet artificiale të ujëmbajtësve
11. projektet edukative/arsimore
12. projektet e kërkimit, zhvillimit dhe demonstrimit
13. masat e tjera përkatëse në mënyrë që të sigurohet mbrojtje shtesë ose përmirësim i ujërave
14. masat e tjera përkatëse për zbatimin e marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare.

Aneksi V: Statusi, Klasifikimi dhe Monitorimi i Ujërave

STATUSI I UJËRAVE SIPËRFAQËSORE

- 1.1. Elementet e cilësisë për klasifikimin e statusit ekologjik
 - 1.1.1. Lumenjtë
 - 1.1.2. Liqenet
 - 1.1.3. Ujërat tranzitore
 - 1.1.4. Ujërat bregdetare
 - 1.1.5. Trupat me ujëra sipërfaqësore artificial dhe tepër të modifikuar
- 1.2. Përkufizimet normative të klasifikimeve të statusit ekologjik
 - 1.2.1. Përkufizimet për statusin ekologjik të lartë, të mirë dhe të moderuar të lumore
 - 1.2.2. Përkufizimet për statusin ekologjik të lartë, të mirë dhe të moderuar të liqeneve
 - 1.2.3. Përkufizimet për statusin ekologjik të lartë, të mirë dhe të moderuar të ujërave tranzitore
 - 1.2.4. Përkufizimet për statusin ekologjik të lartë, të mirë dhe të moderuar të ujërave bregdetare
 - 1.2.5. Përkufizimet për potencialin ekologjik maksimal, të mirë dhe të moderuar për trupat ujorë tepër të modifikuar ose artificiale
 - 1.2.6. Procedurat për përcaktimin e standarteve të cilësisë kimike
- 1.3. Monitorimi i statusit ekologjik dhe statusit kimik për ujërat sipërfaqësore
 - 1.3.1. Projekti i monitorimit të survejimit
 - 1.3.2. Projekti i monitorimit operacional
 - 1.3.3. Projekti i monitorimit investigativ
 - 1.3.4. Shpeshësia e monitorimit
 - 1.3.5. Kërkesat shtesë të monitorimit për zonat e mbrojtura
 - 1.3.6. Standartet për monitorimin e elementeve të cilësisë
- 1.4. Klasifikimi dhe prezantimi i statusit ekologjik
 - 1.4.1. Krahasueshmëria e rezultateve biologjike monitoruese
 - 1.4.2. Prezantimi i rezultateve të monitorimit dhe klasifikimi i statusit ekologjik dhe potencialit ekologjik
 - 1.4.3. Prezantimi i rezultateve të monitorimit dhe klasifikimi i statusit kimik

UJËRAT NËNTOKËSORE

- 2.1. Statusi sasior i ujërave nëntokësore
 - 2.1.1. Parametri për klasifikimin e statusit sasior
 - 2.1.2. Përkufizimi i statusit sasior
- 2.2. Monitorimi i statusit sasior të ujërave nëntokësore
 - 2.2.1. Rrjeti i monitorimit të nivelit të ujërave nëntokësore
 - 2.2.2. Dendësia e territoreve të monitorimit

- 2.2.3. Shpeshhtësia e monitorimit
- 2.2.4. Interpretimi dhe prezantimi i statusit sasior të ujërave nëntokësore
- 2.3. Statusi kimik i ujërave nëntokësore
 - 2.3.1. Parametrat për përcaktimin e statusit kimik të ujëra nëntokësore
 - 2.3.2. Përkufizimi i statusit të mirë kimik të ujërave nëntokësore
- 2.4. Monitorimi i statusit kimik të ujërave nëntokësore
 - 2.4.1. Rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësore
 - 2.4.2. Monitorimi i survejimit
 - 2.4.3. Monitorimi operacional
 - 2.4.4. Identifikimi i tendancave tek ndotësit
 - 2.4.5. Interpretimi dhe prezantimi i statusit kimik të ujërave nëntokësore
- 2.5. Prezantimi i statusit të ujërave nëntokësore

1. STATUSI I UJËRAVE SIPËRFAQËSORE

1.1. Elementet e cilësisë për klasifikimin e statusit ekologjik

1.1.1. Lumenjtë

(a) Elementet biologjike

Përbërja dhe ngarkesa e florës ujore

Përbërja dhe ngarkesa e faunës invertebrore bentike (që gjenden në shtresën më fundore të trupave ujore)

Përbërja, ngarkesa dhe struktura e moshës së faunës së peshqeve

(b) Elementet hidromorfologjike që mbështesin elementet biologjike

Rregjimi hidrologjik

Sasia dhe dinamika e rrjedhës së ujit

Lidhja me trupat me ujëra nëntokësore

Vazhdimësia e lumore

Kushtet morfologjike

Thellësia e lumor dhe ndryshimi i gjerësisë

Struktura dhe nënshtresa e shtratit të lumor

Struktura e zonës bregore

(c) Elementet kimikë dhe fiziko-kimikë që mbështesin elementët biologjikë

(i) Të përgjithshëm

Kushtet termale

Kushtet e oksigjenimit

Kripësia

Statusi acidifikimit

Kushtet e ushqyesve

(ii) Ndotësit specifikë

Ndotja nga të gjitha substancat prioritare të identifikuara si të shkarkuara në trupa ujorë

Ndotja nga substance të tjera të identifikuara si të shkarkuara në sasi të konsiderueshme në trupa ujorë

1.1.2. Liqenet

(a) Elementet biologjike

Përbërja, ngarkesa dhe biomasa e fitoplanktonit

Përbërja dhe ngarkesa e florës tjetër ujore

Përbërja dhe ngarkesa e faunës invertebrore bentike

Përbërja, ngarkesa dhe struktura e moshës së faunës së peshqve

(b) Elementet hidromorfologjike që mbështesin elementet biologjike

Rregjimi hidrologjik

Sasia dhe dinamika e rrjedhës së ujërave

Koha e rezidencës

Lidhja e trupave me ujëra nëntokësore

Kushtet morfologjike

Ndryshimi i thellësisë së liqenit

Sasia, struktura dhe nënshtresa e shtratit të liqenit

Struktura e bregut të liqenit

(c) Elementet kimike dhe fiziko-kimike që mbështesin elementet biologjike

(i) Të përgjithshme

Transparenca

Kushtet termike

Kushtet e oksigjenimit

Kripësia

Statusi i acidifikimit

Kushtet e ushqyesve

(ii) Ndotësit specifikë

Ndotja nga të gjitha substancat prioritare të identifikuara që shkarkohen në trupa ujorë

Ndotja nga substanca të tjera të identifikuara që shkarkohen në sasi të konsiderueshme në trupa ujorë

1.1.3. Ujërat tranzitore

(a) Elementet biologjike

Përbërja, ngarkesa dhe biomasa e fitoplanktonit

Përbërja dhe ngarkesa e florës tjetër ujore

Përbërja dhe ngarkesa e faunës invertebrore bentike

Përbërja dhe ngarkesa e faunës së peshqve

(b) Elementet hidro-morfologjike që mbështesin elementet biologjike

Kushtet morfologjike

Ndryshimi i thellësisë

Sasia, struktura dhe nënshtresa e shtratit

Struktura e zonës ndëraticore

Rregjimi baticor

Rrjedha e ujërave të ëmbël

Ekspozimi i dallgëve

(c) Elementet kimike dhe fiziko-kimike që mbështesin elementet biologjike

(i) Të përgjithshme

Transparenca

Kushtet termike

Kushtet e oksigjenimit

Kripësia

Kushtet e ushqyesve

(ii) Ndotësit e veçantë

Ndotja nga të gjitha substancat prioritare të identifikuar që shkarkohen në trupa ujorë

Ndotja nga substancat e tjera të identifikuar që shkarkohen në sasi të konsiderueshme në trupa ujorë

1.1.4. Ujërat bregdetare

(a) Elementet biologjike

Përbërjet, ngarkesa dhe biomasa e fitoplanktonit

Përbërja dhe ngarkesa e florës tjetër ujore

Përbërja dhe ngarkesa e faunës invertebrore bentike

(b) Elementet hidromorfologjike që mbështesin elementet biologjike

Kushtet morfologjike

Ndryshimi i thellësisë

Struktura dhe nënshtresa e shtratit bregdetar

Struktura e zonës ndëraticore

Rregjimi baticor

Drejtimi i rrymave dominante

Ekspozimi i dallgëve

(c) Elementet kimike dhe fiziko-kimike që mbështesin elementet biologjike

(i) Të përgjithshme

Transparenca

Kushtet termike

Kushtet e oksigjenimit

Kripësia

Kushtet e ushqyesve

(ii) Ndotësit specifikë

Ndotja nga të gjitha substancat prioritare të identifikuara që shkarkohen në trupa ujorë

Ndotja nga substancat e tjera të identifikuara që shkarkohen në sasi të konsiderueshme në trupat ujorë

1.1.5. Trupat me ujëra sipërfaqësore artificial dhe tepër të modifikuar

Elementet e cilësisë të zbatueshme për trupat me ujëra sipërfaqësore artificialë dhe ata tepër të modifikuar duhet të jenë ato që janë të zbatueshme ndaj cilësdo prej katër kategorive të ujërave natyrore sipërfaqësore që ngjason më shumë me trupin ujor artificial ose tepër të modifikuar në fjalë.

1.2. Përkufizimet normative të klasifikimeve të statusit ekologjik

Tabela 1.2. Përkufizimi i përgjithshëm për lumenjtë, liqenet, ujërat tranzitore dhe ujërat bregdetare

Teksti i mëposhtëm ofron një përkufizim të përgjithshëm të cilësisë ekologjike. Për qëllime të klasifikimit vlerat për cilësinë e elementeve të statusit ekologjik për çdo kategori me ujëra sipërfaqësore janë ato që jepen në tabelat 1.2.1 deri 1.2.4 më poshtë.

Elementi	Statusi i Lartë	Statusi i Mirë	Statusi i Moderuar	Statusi i Dobët	Statusi i Keq
I përgjithshëm	<p>Nuk ekziston asnjë, ose ka vetëm pak ndryshime antropogjenike ndaj vlerave të elementeve fiziko-kimike dhe hidromorfologjike të cilësisë për llojet e trupave me ujëra sipërfaqësore përkundrajt atyre që lidhen normalisht me atë trup ujqor në kushte të rregullta.</p> <p>Vlerat e elementëve të cilësisë biologjike për trupat me ujëra sipërfaqësore reflektojnë ato që normalisht lidhen me atë lloj në kushte të rregullta, dhe nuk tregojnë ose tregojnë shumë pak evidencë të deformimit.</p> <p>Këto janë kushte specifike sipas llojeve dhe komuniteteve.</p>	<p>Vlerat e elementeve të cilësisë biologjike për llojet e trupave me ujëra sipërfaqësore tregojnë nivele të ulëta të deformimeve që rezultojnë nga aktiviteti njerëzor, por devijojnë vetëm pak nga ato që lidhen normalisht me llojin e trupit me ujëra sipërfaqësore në kushte të rregullta.</p>	<p>Vlerat e elementeve të cilësisë biologjike për llojet e trupave me ujëra sipërfaqësore devijojnë moderueshëm nga ato që lidhen normalisht me llojin e trupit me ujëra sipërfaqësore në kushte të rregullta. Vlerat tregojnë shenja të moderueshme të deformimit që rezultojnë nga aktiviteti njerëzor dhe janë konsiderueshëm më të trazuar se sa në kushtet e statusit të mirë.</p>	<p>Ujërat që tregojnë evidencë të ndryshimeve madhore ndaj vlerave të elementeve biologjike të cilësisë për llojet e trupave me ujëra sipërfaqësore dhe në të cilat komunitetet biologjike përkatëse devijojnë shumë nga ato që lidhen normalisht me llojin e trupit me ujëra sipërfaqësore në kushte të rregullta, duhet të klasifikohen si të dobëta.</p>	<p>Ujërat që tregojnë evidencë të ndryshimeve tepër të thella ndaj vlerave të elementeve biologjike të cilësisë për llojet e trupave me ujëra sipërfaqësore dhe në të cilat mungojnë porcione të mëdha të komuniteteve biologjike përkatëse që normalisht lidhen me llojin e trupit me ujëra sipërfaqësore në kushte të rregullta, duhen klasifikuar si të këqija.</p>

Tabela 1.2.1 Përkufizimet për statusin ekologjik të lartë, të mirë, të moderueshëm, të dobët dhe të keq të lumore

1.2.1.1 Elementet e cilësisë biologjike

Elementet	Statusi i Lartë	Statusi i Mirë	Statusi i Moderuar	Statusi i Dobët	Statusi i Keq
Fitoplanktoni	<p>Përbërja taksonomike (numri dhe organizimi i specieve të ndryshme që gjenden së bashku) e fitoplanktonit (përbërësit autotrofikë të planktonit – tërësia e organizmave bimorë e shtazorë që pluskojnë mbi ujë) korrespondon plotësisht ose pothuaj totalisht me kushtet e rregullta.</p> <p>Ngarkesa mesatare e fitoplanktonit është plotësisht konsistente me kushtet fiziko-kimike sipas llojeve dhe nuk është e tillë që të ndryshojë konsiderueshëm kushtet e transparencës sipas llojeve. Lulëzimi planktonik ndodh në shpeshtësi dhe intesitet që është konsistent me kushtet fiziko-kimike sipas llojeve.</p>	<p>Ekzistojnë pak ndryshime në përbërjen dhe ngarkesën e grupeve të ngashme të organizmave planktonike krahasuar me komunitetet sipas llojeve. Këto ndryshime nuk tregojnë ndonjë rritje të përshpejtuar të algave që rezultojnë në çrregullime të padëshirueshme në balancën e organizmave të pranishme në trupin ujqor ose në cilësinë fiziko-kimike të ujit apo sedimentit.</p> <p>Mund të ndodhë një rritje e lehtë në shpeshtësinë dhe intesitetin e lulëzimeve planktonike sipas llojeve.</p>	<p>Përbërja e grupeve të ngashme të organizmave planktonike ndryshon moderueshëm nga komunitetet sipas llojeve. Ngarkesa trazohet moderueshëm dhe mund të jetë e tillë që të shkakttojë një çrregullim të konsiderueshme të padëshiruar në vlerat e elementeve të tjerë biologjikë dhe fiziko-kimikë.</p> <p>Mund të ndodhë një rritje e moderueshme në shpeshtësinë dhe intesitetin e lulëzimeve planktonike. Lulëzime të vazhdueshme mund të ndodhin gjatë muajve të verës.</p>		
Makrofitet (bimë ujore të mëdha) dhe fitobentot	<p>Përbërja taksonomike korrespondon plotësisht ose pothuaj plotësisht me kushtet e rregullta.</p> <p>Nuk ekzistojnë ndryshime të dallueshme në ngarkesën mesatare makrofitike dhe atë fitobentike.</p>	<p>Ekzistojnë pak ndryshime në përbërjen dhe ngarkesën e grupeve të ngashme të organizmave makrofitike dhe fitobentike krahasuar me komunitetet sipas llojeve. Këto ndryshime nuk tregojnë ndonjë rritje të</p>	<p>Përbërja e grupeve të ngashme të organizmave makrofitike dhe fitobentike ndryshon moderueshëm nga komunitetet sipas llojeve dhe është konsiderueshëm më e deformuar se sa në statusin e mirë. Ndryshime</p>		

		<p>përshpejtuar të fitobentove apo formave më të larta të jetës bimore që rezultojnë në çrregullime të padëshirueshme në balancën e organizmave të pranishëm në trupin ujor ose në cilësinë fiziko-kimike të ujit ose sedimentit.</p> <p>Komuniteti fitobentik nuk ndikohet negativisht nga tufat me push dhe shtresat bakteriale të pranishme gjatë aktivitetit antropogjenik.</p>	<p>të moderueshme në ngarkesën mesatare makrofitike dhe fitobentike janë evidente.</p> <p>Komuniteti fitobentik mund të interferojë me dhe, në disa zona, të zhvendoset nga tufat me push dhe shtresat bakteriale të pranishme si rezultat i aktiviteteve antropogjenike.</p>		
Fauna invertebrore bentike	<p>Përbërja dhe ngarkesa taksonomike korrespondojnë plotësisht ose pothuaj plotësisht me kushtet e rregullta.</p> <p>Raporti i çrregullimit grupeve të ngashme të organizmave të ndjeshme ndaj atyre të pandjeshme nuk tregon shenja të ndryshimit nga nivelet e rregullta.</p> <p>Niveli i diversitetit të grupeve të ngashme të organizmave invertebrore nuk tregon shenja të ndryshimit nga nivelet e rregullta.</p>	<p>Ekzistojnë ndryshime të lehta në përbërjen dhe ngarkesën e grupeve të ngashme të organizmave invertebrore nga komunitetet specifike të llojeve.</p> <p>Raporti i çrregullimit grupeve të ngashme të organizmave të ndjeshme ndaj atyre të pandjeshme tregon shenja të ndryshimit të lehtë nga nivelet specifike të llojeve.</p> <p>Niveli i diversitetit të grupeve të ngashme të organizmave invertebrore tregon shenja të ndryshimit të lehtë nga nivelet specifike të llojeve.</p>	<p>Përbërja dhe ngarkesa e grupeve të ngashme të organizmave invertebrore ndryshon moderueshëm nga komunitetet specifike të llojeve.</p> <p>Mungojnë grupet e mëdha taksonomike të komuniteteve specifike të llojeve.</p> <p>Raporti i çrregullimit grupeve të ngashme të organizmave të ndjeshme ndaj atyre të pandjeshme, dhe niveli i ndryshimit, janë shumë më të ulët se sa niveli specifik i llojeve dhe konsiderueshëm më të ulëta nga ai i statusit të mirë.</p>		
Fauna e peshqve	<p>Përbërja e specieve dhe ngarkesa korrespondojnë totalisht me kushtet e rregullta.</p>	<p>Ekzistojnë ndryshime të lehta në përbërjen e specieve dhe ngarkesën nga komunitetet e llojeve</p>	<p>Përbërja dhe ngarkesa e specieve të peshqve ndryshojnë moderueshëm nga komunitetet e llojeve</p>		

	<p>Të gjitha speciet e llojeve specifike të ndjeshme ndaj çrregullimeve janë të pranishme.</p> <p>Strukturat e moshës së komuniteteve të peshqve tregojnë pak shenja të çrregullimeve antropogjenike dhe nuk tregojnë mosrealizimin e riprodhimit apo zhvillimit të ndonjë specieje të veçantë.</p>	<p>specifike që i atribuohen ndikimeve antropogjenike në elementet fiziko-kimikë dhe hidromorfologjik të cilësisë.</p> <p>Strukturat e moshës së komuniteteve të peshqve tregojnë shenja të çrregullimeve që i atribuohen ndikimeve antropogjenike në elementet fiziko-kimiko-morfologjikë të cilësisë, dhe, në pak raste, tregojnë mosrealizimin e riprodhimit apo zhvillimit të ndonjë specieje të veçantë, në atë masë sa disa klasa moshash mund të mungojnë.</p>	<p>specifike që i atribuohen ndikimeve antropogjenike në elementet fiziko-kimikë ose hidromorfologjik të cilësisë.</p> <p>Strukturat e moshës së komuniteteve të peshqve tregojnë shenja madhore të çrregullimeve antropogjenike, në atë masë sa një pjesë e moderueshme e specieve të llojeve specifike mungon ose është shumë e rrallë.</p>		
--	---	---	---	--	--

1.2.1.2 Elementet hydromorfologjike të cilësisë

Elementet	Statusi i Lartë	Statusi i Mirë	Statusi i Moderuar	Statusi i Dobët	Statusi i Keq
Rregjimi hidrologjik	Sasia dhe dinamika e rrjedhës, dhe lidhja rezultante me ujërat nëntokësore, reflektohet totalisht, apo pothuaj totalisht me kushtet e rregullta.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		
Vazhdimësia e lumor	Vazhdimësia e lumor nuk çrregullohet nga aktivitetet antropogjenike dhe lejon migrimin e organizmave ujore dhe transportin e sedimentit.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		

Kushtet morfologjike	Modelet e kanalit, gjerësia dhChannel patterns, variacionet e gjerësisë dhe gjatësisë, shpejtësitë e rrjedhës, kushtet e nënshtresave dhe si struktura ashtu edhe gjendja/kushtet e zonave bregore korrespondon totalisht apo pothuaj totalisht me kushtet të rregullta.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		
----------------------	--	---	---	--	--

1.2.1.3 Elementet fiziko-kimike

Elementet	Statusi i Lartë	Statusi i Mirë	Statusi i Moderuar	Statusi i Dobët	Statusi i Keq
Kushtet e përgjithshme	Vlerat e elementeve fiziko-kimike korrespondojnë totalisht ose pothuaj plotësisht me kushtet e rregullta. Përqëndrimet e ushqyesve mbeten brenda të njëjtës gamë që normalisht lidhet me kushtet e rregullta. Nivelet e kripësisë, pH, balancës së oksigjenit dhe kapaciteti neutralizues dhe temperatura nuk tregojnë shenja të çrregullimeve antropogjenike dhe mbeten brenda të njëjtës gamë që normalisht lidhet me kushtet e rregullta.	Temperatura, balanca e oksigjenit, pH, kapaciteti i neutralizimit acid dhe kripësia nuk arrijnë nivele jashtë gamës së krijuar në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e ekosistemeve të llojeve specifike dhe arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë. Përqëndrimet e ushqyesve nuk i tejkalojnë nivelet e krijuara në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e ekosistemeve dhe arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		

Ndotësit specifike sintetike	Përqëndrimet afër zeros dhe të paktën nën kufijtë e zbulimit të shumicës së teknikave të avancuara analitike për përdorim të përgjithshëm.	Përqëndrimet nuk i tejkalojnë normat mjedisore të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		
Ndotësit specifike jo sintetike	Përqëndrimet mbeten brenda të njëjtës gamë që normalisht lidhet me kushtet e rregullta (nivelet e sfondit).	Përqëndrimet nuk i tejkalojnë normat mjedisore të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		

Tabela 1.2.2 Përkufizimet për statusin ekologjik të lartë, të mirë, të moderuar, të dobët dhe të keq të liqeneve

1.2.2.1 Elementet biologjike të cilësisë

Elementet	Statusi i Lartë	Statusi i Mirë	Statusi i Moderuar	Statusi i Dobët	Statusi i Keq
Fitoplankton	Përbërja taksonomike dhe ngarkesa e fitoplanktonit korrespondon totalisht ose pothuaj totalisht me kushtet e rregullta. Biomasa e fitoplanktonit është konsistente me kushtet fiziko –kimike të llojeve specifike dhe nuk është e tillë që të ndryshojë konsiderueshëm kushtet e transparencës së llojeve specifike. Lulëzimet planktonike ndodhin në një shpeshësi dhe intensitet që është konsistent me kushtet fiziko-kimike të llojeve	Ekzistojnë pak ndryshime në përbërjen dhe ngarkesën e grupeve të ngashme të organizmave planktonike krahasuar me komunitetet sipas llojeve. Këto ndryshime nuk tregojnë ndonjë rritje të përshpejtuar të algave që rezultojnë në çrregullime të padëshirueshme në balancën e organizmave të pranishme në trupin ujor ose në cilësinë fiziko-kimike të ujit apo sedimentit. Mund të ndodhë një rritje e lehtë në shpeshësinë dhe intensitetin e lulëzimeve	Përbërja e grupeve të ngashme të organizmave planktonike ndryshon moderueshëm nga komunitetet sipas llojeve. Biomasa trazohet moderueshëm dhe mund të jetë e tillë që të shkaktojë një çrregullim të konsiderueshëm të padëshiruar në vlerat e elementeve të tjerë biologjike dhe fiziko-kimike të cilësisë së ujit apo sedimentit. Mund të ndodhë një rritje e moderueshme në shpeshësinë dhe intensitetin		

	specifike.	planktonike sipas llojeve.	e lulëzimeve planktonike. Lulëzime të vazhdueshme mund të ndodhin gjatë muajve të verës.		
Makrofitet dhe fitobentot	<p>Përbërja taksonomike korrespondon totalisht ose pothuaj totalisht me kushtet e rregullta.</p> <p>Nuk ka ndryshime të dallueshme në ngarkesën mesatare makrofitike dhe fitobentik.</p>	<p>Ekzistojnë pak ndryshime në përbërjen dhe ngarkesën e grupeve të ngashme të organizmave makrofitike dhe fitobentike krahasuar me komunitetet sipas llojeve. Këto ndryshime nuk tregojnë ndonjë rritje të përshpejtuar të fitobentove apo formave më të larta të jetës bimore që rezultojnë në çrregullime të padëshirueshme në balancën e organizmave të pranishëm në trupin ujor ose në cilësinë fiziko-kimike të ujit.</p> <p>Komuniteti fitobentik nuk ndikohet negativisht nga tufat me push dhe shtresat bakteriale të pranishme gjatë aktivitetit antropogjenik.</p>	<p>Përbërja e grupeve të ngashme të organizmave makrofitike dhe fitobentike ndryshon moderueshëm nga komunitetet sipas llojeve dhe është konsiderueshëm më e deformuar se sa në statusin e mirë. Ndryshime të moderueshme në ngarkesën mesatare makrofitike dhe fitobentike janë evidente.</p> <p>Komuniteti fitobentik mund të interferojë me dhe, në disa zona, të zhvendoset nga tufat me push dhe shtresat bakteriale të pranishme si rezultat i aktiviteteve antropogjenike.</p>		
Fauna invertebrore bentike	<p>Përbërja dhe ngarkesa taksonomike korrespondojnë plotësisht ose pothuaj plotësisht me kushtet e rregullta.</p> <p>Raporti i çrregullimeve të grupeve të ngashme të organizmave të ndjeshme ndaj atyre të pandjeshme nuk tregon shenja të ndryshimit nga nivelet e</p>	<p>Ekzistojnë ndryshime të lehta në përbërjen dhe ngarkesën e grupeve të ngashme të organizmave invertebrore krahasuar me komunitetet specifike të llojeve.</p> <p>Raporti i çrregullimit grupeve të ngashme të organizmave të ndjeshme ndaj atyre të pandjeshme</p>	<p>Përbërja dhe ngarkesa e grupeve të ngashme të organizmave invertebrore ndryshon moderueshëm nga komunitetet specifike të llojeve.</p> <p>Mungojnë grupet e mëdha taksonomike të komuniteteve specifike të llojeve.</p> <p>Raporti i çrregullimit</p>		

	<p>rregullta.</p> <p>Niveli i diversitetit të grupeve të ngashme të organizmave invertebrore nuk tregon shenja të ndryshimit nga nivelet e rregullta.</p>	<p>tregon shenja të ndryshimit të lehtë nga nivelet specifike të llojeve.</p> <p>Niveli i diversitetit të grupeve të ngashme të organizmave invertebrore tregon shenja të ndryshimit të lehtë nga nivelet specifike të llojeve.</p>	<p>grupeve të ngashme të organizmave të ndjeshme ndaj atyre të pandjeshme, dhe niveli i ndryshimit, janë shumë më të ulët se sa niveli specifik i llojeve dhe konsiderueshëm më të ulëta nga ai i statusit të mirë.</p>		
Fauna e peshqve	<p>Përbërja e specieve dhe ngarkesa korrespondojnë totalisht me kushtet e rregullta.</p> <p>Të gjitha speciet e llojeve specifike të ndjeshme janë të pranishme.</p> <p>Strukturat e moshës së komuniteteve të peshqve tregojnë pak shenja të çrregullimeve antropogjenike dhe nuk tregojnë mosrealizimin e riprodhimit apo zhvillimit të ndonjë specieje të veçantë.</p>	<p>Ekzistojnë ndryshime të lehta në përbërjen e specieve dhe ngarkesën nga komunitetet e llojeve specifike që i atribuohen ndikimeve antropogjenike në elementet fiziko-kimikë ose hidromorfologjik të cilësisë.</p> <p>Strukturat e moshës së komuniteteve të peshqve tregojnë shenja të çrregullimeve që i atribuohen ndikimeve antropogjenike në elementet fiziko-kimiko-morfologjikë të cilësisë, dhe, në pak raste, tregojnë mosrealizimin e riprodhimit apo zhvillimit të ndonjë specieje të veçantë, në atë masë sa disa klasa moshash mund të mungojnë.</p>	<p>Përbërja dhe ngarkesa e specieve të peshqve ndryshojnë moderueshëm nga komunitetet e llojeve specifike që i atribuohen ndikimeve antropogjenike në elementet fiziko-kimikë ose hidromorfologjik të cilësisë.</p> <p>Strukturat e moshës së komuniteteve të peshqve tregojnë shenja madhore të çrregullimeve antropogjenike që i atribuohen ndikimeve antropogjenike në elementet fiziko-kimikë ose morfologjikë të cilësisë, në atë masë sa një pjesë e moderueshme e specieve të llojeve specifike mungon ose është shumë e rrallë.</p>		

1.2.2.2 Elementet hidromorfologjike të cilësisë

Elementet	Statusi i Lartë	Statusi i Mirë	Statusi i Moderuar	Statusi i Dobët	Statusi i Keq
-----------	-----------------	----------------	--------------------	-----------------	---------------

Rregjimi hidrologjik	Sasia dhe dinamika e rrjedhës, niveli, koha e rezidencës dhe lidhja rezultante me ujërat nëntokësore, reflektohet totalisht, apo pothuaj totalisht me kushtet e rregullta.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		
Kushtet morfologjike	Variacioni i thellësisë së liqenit, sasia dhe struktura e nënshtresave, dhe si struktura ashtu edhe gjendja / kushtet e zonës së bregut të liqenit korrespondojnë totalisht ose pothuaj totalisht me kushtet e rregullta.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		

1.2.2.3 Elementet fiziko-kimikë të cilësisë

Elementet	Statusi i Lartë	Statusi i Mirë	Statusi i Moderuar	Statusi i Dobët	Statusi i Keq
Kushtet e përgjithshme	Vlerat e elementeve fiziko-kimike korrespondojnë totalisht ose pothuaj plotësisht me kushtet e rregullta. Përqëndrimet e ushqyesve mbeten brenda të njëjtës gamë që normalisht lidhet me kushtet e rregullta. Nivelet e kripësisë, pH, balancës së oksigjenit, kapacitetit të neutralizimi acid, transparenca dhe temperatura nuk tregojnë shenja të çrregullimeve antropogjenike dhe mbeten	Temperatura, balanca e oksigjenit, pH, kapaciteti i neutralizimit acid dhe kripësia nuk arrijnë nivele jashtë gamës së krijuar në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e ekosistemeve dhe arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë. Përqëndrimet e ushqyesve nuk i tejkalojnë nivelet e krijuara në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		

	brenda të njëjtës gamë që normalisht lidhet me kushtet e rregullta.	ekosistemeve dhe arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.			
Ndotësit specifikë sintetikë	Përqëndrimet afër zeros dhe të paktën nën kufijtë e zbulimit të shumicës së teknikave të avancuara analitike për përdorim të përgjithshëm.	Përqëndrimet nuk i tejkalojnë normat mjedisore të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		
Ndotësit specifikë jo sintetikë	Përqëndrimet mbeten brenda të njëjtës gamë që normalisht lidhet me kushtet e rregullta (nivelet e sfondit).	Përqëndrimet nuk i tejkalojnë normat mjedisore të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		

Tabela 1.2.3 Përkufizimet për statusin ekologjik të lartë, të mirë, të moderuar, të dobët dhe të keq në ujërat tranzitorë

1.2.3.1 Elementet biologjike të cilësisë

Elementet	Statusi i Lartë	Statusi i Mirë	Statusi i Moderuar	Statusi i Dobët	Statusi i Keq
Fitoplanktoni	Përbërja dhe ngarkesa e grupeve të ngashme të organizmave planktonike janë konsistente me kushtet e rregullta. Biomasa mesatare e fitoplanktonit është konsistente me kushtet fiziko –kimike të llojeve specifike dhe nuk është e tillë që të ndryshojë konsiderueshëm kushtet e transparencës së llojeve specifike.	Ekzistojnë pak ndryshime në përbërjen dhe ngarkesën e grupeve të ngashme të organizmave planktonike . Këto janë ndryshime të vogla në biomasë krahasuar me kushtet sipas llojeve. Këto ndryshime nuk tregojnë ndonjë rritje të përshpejtuar të algave që rezultojnë në çrregullime të padëshirueshme në balancën e organizmave të pranishme në trupin ujor ose në	Përbërja e grupeve të ngashme të organizmave planktonike ndryshon moderueshëm nga komunitetet sipas llojeve. Biomasa trazohet moderueshëm dhe mund të jetë e tillë që të shkaktojë një çrregullim të konsiderueshëm të padëshiruar në vlerat e elementeve të tjerë biologjikë të cilësisë. Mund të ndodhë një rritje e		

	Lulëzimet planktonike ndodhin në një shpeshhtësi dhe intensitet që është konsistent me kushtet fiziko-kimike të llojeve specifike.	cilësinë fiziko-kimike të ujit. Mund të ndodhë një rritje e lehtë në shpeshhtësinë dhe intensitetin e lulëzimeve planktonike sipas llojeve.	moderueshme në shpeshhtësinë dhe intensitetin e lulëzimeve planktonike. Lulëzime të vazhdueshme mund të ndodhin gjatë muajve të verës.		
Makroalgat	Përbërja e grupeve të ngjashme të organizmave makroalgore është konsistente me kushtet e rregullta. Nuk ka ndryshime të dallueshme në shtresën makroalgore për shkak të aktiviteteve antropogjenike.	Ka ndryshime të lehta në përbërjen dhe ngarkesën e grupeve të ngjashme të organizmave makroalgore krahasuar me komunitetet e llojeve specifike. Këto ndryshime ndonjë rritje të përshpejtuar të fitobentos apo formave më të larta të jetës bimore që rezultojnë në çrregullime të padëshirueshme në balancën e organizmave të pranishme në trupin ujor ose në cilësinë fiziko-kimike të ujit.	Përbërja e grupeve të ngjashme të organizmave makroalgore ndryshon moderueshëm nga kushtet sipas llojeve dhe është konsiderueshëm më e deformuar se sa në cilësinë e mirë. Ndryshime të moderueshme në ngarkesën mesatare të makroalgave janë evidente dhe të tilla sa që të rezultojnë në çrregullim të padëshirueshëm në balancën e organizmave të pranishëm në trupin ujor.		
Angiospermat (bimë me lule që riprodhohet me fara)	Përbërja taksonomike korrespondon plotësisht apo pothuaj plotësisht me kushtet e rregullta. Nuk ka ndryshime të dallueshme në ngarkesën e angiosperms për shkak të aktiviteteve antropogjenike.	Ka ndryshime të lehta në përbërjen e grupeve të ngjashme të organizmave angiosperma krahasuar me komunitetet e llojeve specifike. Ngarkesa e angiosperm tregon shenja të lehta të çrregullimit.	Përbërja e grupeve të ngjashme të organizmave angiosperm ndryshon moderueshëm nga komunitetet e llojeve specifike dhe është konsiderueshëm më e deformuar se sa në cilësinë e mirë. Ekzistojnë deformime të moderueshme në ngarkesën e grupeve të ngjashme të organizmave angiosperm.		

Fauna invertebrore bentike	Niveli i diversitetit dhe ngarkesa e grupeve të ngashme të organizmave invertebrore është brenda gamës që normalisht lidhet me nivelet e rregullta. Janë të pranishme të gjitha grupeve të ngjashme të organizmave të ndjeshme ndaj çrregullimit të lidhura me kushtet e rregullta.	Niveli i diversitetit dhe ngarkesa e grupeve të ngashme të organizmave invertebrore është paksa jashtë gamës së lidhur me kushtet specifike të llojeve. Shumica e grupeve të ngjashme të organizmave të ndjeshme të komuniteteve specifike të llojeve janë të pranishme.	Niveli i diversitetit dhe ngarkesa e grupeve të ngashme të organizmave invertebrore është moderueshëm jashtë gamës së lidhur me kushtet specifike të llojeve. Grupeve të ngjashme të organizmave që tregojnë ndotje janë të pranishme. Shumë prej grupeve të ngjashme të organizmave të ndjeshme të komuniteteve specifike të llojeve janë të pranishme.		
Fauna e peshqve	Përbërja dhe ngarkesa e specieve dhe është konsistente me kushtet e rregullta.	Ngarkesa e specieve të ndjeshmë ndaj çrregullimeve tregojnë shenja të lehta të deformimit nga kushtet e llojeve specifike që i atribuohen ndikimeve antropogjenike në elementet fiziko-kimikë ose hidromorfologjik të cilësisë.	Një pjesë e moderueshme e specieve të ndjeshme ndaj çrregullimeve sipas llojeve mungojnë si rezultat i ndikimeve antropogjenike në elementet fiziko-kimikë ose hidromorfologjik të cilësisë.		

1.2.3.2 Elementet hidromorfologjike të cilësisë

Elementet	Statusi i Lartë	Statusi i Mirë	Statusi i Moderuar	Statusi i Dobët	Statusi i Keq
Rregjimi baticor	Rregjimi i rrjedhës së ujërave të ëmbla korrespondon plotësisht ose afërsisht plotësisht me kushtet normale.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		
Kushtet morfologjike	Variacionet e thellësisë, kushtet e nënshtresave dhe si	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të		

	struktura ashtu edhe kushtet/gjendja e zonave ndërbaticore korrespondojnë plotësisht ose afërsisht plotësisht me kushtet normale.	specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.	specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		
--	---	---	---	--	--

1.2.3.3 Elementet fiziko-kimike të cilësisë

Elementet	Statusi i Lartë	Statusi i Mirë	Statusi i Moderuar	Statusi i Dobët	Statusi i Keq
Kushtet e përgjithshme	Vlerat e elementeve fiziko-kimike korrespondojnë totalisht ose afërsisht plotësisht me kushtet e rregullta. Përqëndrimet e ushqyesve mbeten brenda të njëjtës gamë që normalisht lidhet me kushtet e rregullta. Temperatura, balanca e oksigjenit dhe transparenca nuk tregojnë shenja të çrregullimeve antropogjenike dhe mbeten brenda të njëjtës gamë që normalisht lidhet me kushtet e rregullta.	Temperatura, kushtet e oksigjenimit dhe transparenca nuk arrijnë nivele jashtë gamës së krijuar në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e ekosistemeve dhe arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë. Përqëndrimet e ushqyesve nuk i tejkalojnë nivelet e krijuara në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e ekosistemeve dhe arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		
Ndotësit specifikë sintetikë	Përqëndrimet afër zeros dhe të paktën nën kufijtë e zbulimit të shumicës së teknikave të avancuara analitike për përdorim të përgjithshëm.	Përqëndrimet nuk i tejkalojnë normat mjedisore të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		
Ndotësit specifikë jo sintetikë	Përqëndrimet mbeten brenda të njëjtës gamë që normalisht	Përqëndrimet nuk i tejkalojnë normat mjedisore të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të		

	lidhet me kushtet e rregullta (nivelet e sfondit).		specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		
--	--	--	---	--	--

Tabela 1.2.4 Përkufizimet për statusin ekologjik të lartë, të mirë, të moderuar, të dobët dhe të keq në ujërat bregdetare

1.2.4.1 Elementet biologjike të cilësisë

Elementet	Statusi i Lartë	Statusi i Mirë	Statusi i Moderuar	Statusi i Dobët	Statusi i Keq
Fitoplanktoni	Përbërja dhe ngarkesa e grupeve të ngashme të organizmave planktonike grupeve të ngjashme të organizmave janë konsistente me kushtet e rregullta. Biomasa mesatare e fitoplanktonit është konsistente me kushtet fiziko –kimike të llojeve specifike dhe nuk është e tillë që të ndryshojë konsiderueshëm kushtet e transparencës së llojeve specifike. Lulëzimet planktonike ndodhin në një shpeshësi dhe intensitet që është konsistent me kushtet fiziko-kimike të llojeve specifike.	Ekzistojnë shenja të lehta të çrregullimeve në përbërjen dhe ngarkesën e grupeve të ngashme të organizmave planktonike . Ka ndryshime të vogla në biomasë krahasuar me kushtet sipas llojeve. Këto ndryshime nuk tregojnë ndonjë rritje të përshpejtuar të algave që rezultojnë në çrregullime të padëshirueshme në balancën e organizmave të pranishme në trupin ujor ose në cilësinë e ujit. Mund të ndodhë një rritje e lehtë në shpeshësinë dhe intensitetin e lulëzimeve planktonike sipas llojeve.	Përbërja dhe ngarkesa e grupeve të ngashme të organizmave planktonike tregon shenja të çrregullimit të moderueshëm. Biomasa e algave është kryesisht jashtë gamës së lidhur me kushtet e llojeve specifike dhe është e tillë që të ndikojë mbi elementet e tjerë biologjikë të cilësisë. Mund të ndodhë një rritje e moderueshme në shpeshësinë dhe intensitetin e lulëzimeve planktonike. Lulëzime të vazhdueshme mund të ndodhin gjatë muajve të verës.		
Makroalgat dhe angiospermat	Janë të pranishme të gjitha grupeve të ngashme të organizmave makroalgore dhe angiospermave të	Janë të pranishme shumica e grupeve të ngashme të organizmave makroalgore dhe angiospermave të	Është i pranishëm një numër i moderuar i grupeve të ngashme të organizmave makroalgore dhe		

	ndjeshme ndaj çrregullimeve të lidhura me kushtet e rregullta. Nivelet e shtresës makroalgore dhe ngarkesës së angiospermave janë konsistente me kushtet e rregullta.	ndjeshme ndaj çrregullimeve të lidhura me kushtet e rregullta. Nivelet e shtresës makroalgore dhe ngarkesës së angiospermave japin shenja të lehta çrregullimi.	angiospermave të ndjeshme ndaj çrregullimeve të lidhura me kushtet e rregullta. Nivelet e shtresës makroalgore dhe ngarkesës së angiospermave janë çrregulluar moderueshëm dhe mund të jenë të tilla saqë të rezultojnë në çrregullime të padëshirueshme në balancën e organizmave të pranishme në trupin ujqor.		
Fauna invertebrore bentike	Niveli i diversitetit dhe ngarkesa e grupeve të ngashme të organizmave invertebrore është brenda gamës që normalisht lidhet me nivelet e rregullta. Janë të pranishme të gjitha grupeve të ngashme të organizmave e ndjeshme ndaj çrregullimit të lidhura me kushtet e rregullta.	Niveli i diversitetit dhe ngarkesa e grupeve të ngashme të organizmave invertebrore është paksa jashtë gamës së lidhur me kushtet specifike të llojeve. Shumica e grupeve të ngjashme të organizmave të ndjeshme të komuniteteve specifike të llojeve janë të pranishme.	Niveli i diversitetit dhe ngarkesa e grupeve të ngashme të organizmave invertebrore është moderueshëm jashtë gamës së lidhur me kushtet specifike të llojeve. Grupeve të ngjashme të organizmave që tregojnë ndotje janë të pranishme. Shumë prej grupeve të ngashme të organizmave të ndjeshme të komuniteteve specifike të llojeve janë të pranishme.		

1.2.4.2 Elementet hidromorfologjike të cilësisë

Elementet	Statusi i Lartë	Statusi i Mirë	Statusi i Moderuar	Statusi i Dobët	Statusi i Keq
-----------	-----------------	----------------	--------------------	-----------------	---------------

Rregjimi baticor	Rregjimi i rrjedhës së ujërave të ëmbla dhe drejtimi dhe shpejtësia e rrymave dominante korrespondojnë plotësisht ose afërsisht plotësisht me kushtet normale.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		
Kushtet morfologjike	Variacionet e thellësisë, struktura dhe nënshtresa e shtratis bregdetar dhe si struktura ashtu edhe kushtet/gjendja e zonave ndëraticore korrespondojnë plotësisht ose afërsisht plotësisht me kushtet normale.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		

1.2.4.3 Elementet fiziko-kimike të cilësisë

Elementet	Statusi i Lartë	Statusi i Mirë	Statusi i Moderuar	Statusi i Dobët	Statusi i Keq
Kushtet e përgjithshme	Vlerat e elementeve fiziko-kimike korrespondojnë totalisht ose afërsisht plotësisht me kushtet e rregullta. Përqëndrimet e ushqyesve mbeten brenda të njëjtës gamë që normalisht lidhet me kushtet e rregullta. Temperatura, balanca e oksigjenit dhe transparencia nuk tregojnë shenja të çrregullimeve antropogjenike dhe mbeten brenda të njëjtës gamë që normalisht lidhet me kushtet e rregullta.	Temperatura, kushtet e oksigjenimit dhe transparencia nuk arrijnë nivele jashtë gamës së krijuar në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e ekosistemeve dhe arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë. Përqëndrimet e ushqyesve nuk i tejkalojnë nivelet e krijuara në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e ekosistemeve dhe arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		

		të cilësisë.			
Ndotësit specifikë sintetikë	Përqëndrimet afër zeros dhe të paktën nën kufijtë e zbulimit të shumicës së teknikave të avancuara analitike për përdorim të përgjithshëm.	Përqëndrimet nuk i tejkalojnë normat mjedisore të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		
Ndotësit specifikë jo sintetikë	Përqëndrimet mbeten brenda të njëjtës gamë që normalisht lidhet me kushtet e rregullta (nivelet e sfondit).	Përqëndrimet nuk i tejkalojnë normat mjedisore të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		

Tabela 1.2.5 Përkufizimet për potencialin ekologjik maksimal, të mirë, të moderuar, të dobët dhe të keq për trupat ujorë artificial ose tepër të modifikuar

Elementet	Potenciali ekologjik maksimal	Potenciali ekologjik i mirë	Potenciali ekologjik i moderuar	Potenciali ekologjik i dobët	Potenciali ekologjik i keq
Elementet e cilësisë biologjike	Vlerat e elementeve përkatës biologjik të cilësisë reflektojnë sa më larg që është e mundur, ato që lidhen me llojin e tupit me ujëra sipërfaqësore më tepër të ngjashme, në bazë të kushteve fizike që rezultojnë nga karakteristikat artificiale ose tepër të modifikuara të trupit ujor.	Ekzistojnë ndryshime të lehta në vlerat e elementeve përkatës biologjik të cilësisë krahasuar me vlerat e gjetura tek potenciali ekologjik maksimal.	Ekzistojnë ndryshime të moderuara në vlerat e elementeve përkatës biologjik të cilësisë krahasuar me vlerat e gjetura tek potenciali ekologjik maksimal. Këto vlera janë konsiderueshëm më të deformuara se sa ato të gjetura në cilësinë e mirë.		
Elementet hidromorfologjike	Kushtet hidromorfologjike janë konsistente me ndikimet e vetme në trupin me ujërat sipërfaqësore që janë ato që rezultojnë nga karakteristikat artificiale ose tepër të	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		

	modifikuara të trupit ujqor pasi janë marrë të gjitha masat e zbutjes për të siguruar përafërsinë më të mirë në kontinuumin ekologjik, në veçanti përsa i përket migrimit të faunës dhe bazës së përshtatshme për hedhjen e vezëve dhe kultivimit.				
Elementet fiziko-kimike					
Kushtet e përgjithshme	<p>Elementet fiziko-kimike korrespondojnë totalisht ose afërsisht plotësisht me kushtet e rregullta të lidhura me llojin e trupit me ujëra sipërfaqësore më tepër të ngjashme me trupin artificial apo tepër të modifikuar në fjalë.</p> <p>Përqëndrimet e ushqyesve mbeten brenda të njëjtës gamë që normalisht lidhet me kushtet e rregullta.</p> <p>Nivelet e temperaturës, balancës së oksigjenit dhe pH janë konsistentë me ato të gjetura në llojet e trupave me ujëra sipërfaqësore më tepër të ngjashme në kushte të rregullta.</p>	<p>Vlerat e elementeve fiziko-kimike janë brenda gamave të përcaktuara në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e ekosistemit dhe arrijten e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.</p> <p>Temperatura dhe pH nuk arrijnë nivele jashtë gamave të përcaktuara në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e ekosistemit dhe arrijten e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.</p> <p>Përqëndrimet e ushqyesve nuk i tejkalojnë nivelet e përcaktuara në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e ekosistemit dhe arrijten e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.</p>	Kushtet konsistente me arrijten e vlerave të specifikuar më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		
Ndotësit specifikë sintetikë	Përqëndrimet afër zeros dhe të paktën nën kufijtë e	Përqëndrimet nuk i tejkalojnë normat mjedisore të cilësisë.	Kushtet konsistente me arrijten e vlerave të		

	zbulimit të shumicës së teknikave të avancuara analitike për përdorim të përgjithshëm.		specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		
Ndotësit specifikë jo sintetikë	Përqëndrimet mbeten brenda të gamës që normalisht lidhet me kushtet e rregullta të gjetura në në llojet e trupave me ujëra sipërfaqësore më tepër të ngjashmëe me trupin artificial apo tepër të modifikuar në fjalë (nivelet e sfondit).	Përqëndrimet nuk i tejkalojnë normat mjedisore të cilësisë.	Kushtet konsistente me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet biologjike të cilësisë.		

1.3.Monitorimi i statusit ekologjik dhe statusit kimik për ujërat sipërfaqësore

Rrjeti i monitorimit të ujërave sipërfaqësore duhet të krijohet në përputhje me kërkesat e Pjesës 4 të këtij Vendimi. Rrjeti i monitorimit duhet të hartohet në mënyrë që të ofrojë një pasqyrë koherente dhe gjithëpërfshirëse të statusit ekologjik dhe kimik brenda çdo baseni lumi dhe duhet të lejojë klasifikimin e trupave ujore në pesë klasa në pajtim me përcaktimet normative në seksionin 1,2. Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore duhet të ofrojnë një hartë ose harta që tregojnë rrjetin e monitorimit të ujërave sipërfaqësore në planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore.

Në bazë të karakterizimit dhe vlerësimit të ndikimit të kryer në përputhje me Pjesën 2, Kreu 1 dhe Aneksi I, Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të krijojnë për çdo periudhë në të cilën zbatohet plani i menaxhimit të rrethit të baseneve lumore, një program monitorimi survejimi dhe një program monitorimi operacional. Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore në disa raste duhet gjithashtu të krijojnë programet e monitorimit investigativ.

Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore duhet të monitorojnë parametrat të cilat janë tregues i statusit të çdo elementi përkatës të cilësisë. Në përzgjedhjen e parametrave për elementët biologjikë të cilësisë, Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore duhet të identifikojnë nivelin e duhur taksonomik që kërkohet për të arritur besimin dhe saktësinë e duhur në klasifikimin e elementeve të cilësisë. Llogaritjet e nivelit të besimit dhe saktësisë së ofruar nga programet e monitorimit duhet të jepen në këtë plan.

1.3.1. Projektimi i monitorimit të survejimit

Objektivi

Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të përcaktojnë programme monitorimin për survejimin që të ofrojnë informacion për:

- plotësimin dhe bërjen të vlefshme të procedurës së vlerësimit të ndikimit të detajuar në Aneksin I,
- projektimi eficient dhe efektiv i programeve të ardhshme të monitorimit,
- vlerësimi i ndryshimeve afatgjata në kushtet natyrore, dhe
- vlerësimi i ndryshimeve afatgjata që vijnë si rezultat i aktivitetit

antropogjenik të mbarë përhapur.

Rezultatet e këtyre monitorimeve duhet të rishikohen dhe ripërdoren në kombinim me procedurat e vlerësimit të impaktit të përshkruara në Aneksin I, për të përcaktuar kërkesat për programet e monitorimit në planet aktuale dhe të mëvonshme të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore.

Përzgjedhja e pikave të monitorimit

Monitorimi mbikqyrjes duhet të kryhet për trupa ujorë sipërfaqësorë të mjaftueshëm për të dhënë një vlerësim të statusit të përgjithshëm të ujërave sipërfaqësore brenda çdo ujëmbledhësi ose nën-ujëmbledhësi brenda rrethit të baseneve lumore. Në përzgjedhjen e këtyre trupave, Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të sigurojnë ku është e mundur, që monitorimi është kryher në pikat ku:

- norma e rrjedhës së ujit është e konsiderueshme si e tërë brenda rrethit të baseneve lumore ; duke përfshirë pikat në lumenjtë e mëdhenj ku zona e shtrirjes është më e madhe se 2500 km²,
- vëllimi i ujit të pranishëm është i konsiderueshëm brenda rrethit të baseneve lumore, duke përfshirë liqenet dhe rezervuarët e mëdhenj,
- Kufirin e një Shteti e kalojnë një numër i konsiderueshëm trupash ujorë, dhe
- në vende të tjera që kërkohen për të llogaritur ngarkesën e ndotësve që është transferuar nëpërmjet kufijve të Shteteve, dhe që është transferuar në mjedisin detar.

Përzgjedhja e elementeve të cilësisë

Monitorimi i survejimit duhet kryer për çdo territor survejimi për një periudhë një vjeçare gjatë periudhës së mbuluar nga një plan menaxhimin për rrethin e baseneve lumore për:

- parametrat tregues të gjithë elementeve biologjikë të cilësisë,
- parametrat tregues të gjithë elementeve hidromorfologjikë të cilësisë,
- parametrat tregues të gjithë elementeve të përgjithshëm fiziko-kimikë të cilësisë,
- ndotësit e listës prioritare që shkarkohen në basenet ose nënbasenet e lumore, dhe

- ndotësit e tjerë të shkarkuar në sasi të rëndësishme në basenet ose nënbasenet e lumore,

Në qoftë se ushtrimi i mëparshëm i monitorimit të survejimit nuk ka treguar se trupi në fjalë ka arritur e mirë dhe nuk ka prova nga rishikimi i ndikimit të aktivitetit njerëzor në Aneksin I që ndikimet në trupin ujin kanë ndryshuar. Në këto raste, monitorimi i survejimit duhet të kryhet një herë në çdo tre plane të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore.

1.3.2. Projektimi i monitorimit operacional

Duhet të ndërmerret monitorimi operacional me qëllim që të:

- përcaktohet statusi i atyre trupave të identifikuar që janë në rrezik për të mos përmbushur objektivat e tyre mjedisore, dhe
- vlerësohen të gjitha ndryshimet në statusin e këtyre trupave që rezultojnë nga programet e masave.

Programi mund të ndryshohet gjatë periudhës së planit të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore në dritën e informacionit të përftuar si pjesë e kërkesave të Aneksit I apo si pjesë e këtij Aneksi, në mënyrë të veçantë për të lejuar një reduktim në shpeshtësi në rastet kur një është gjetur se një ndikim nuk është i rëndësishëm ose presioni përkatës është hequr.

Përzgjedhja e territoreve të monitorimit

Monitorimi operacional duhet të kryhet për të gjithë ato trupa ujore të cilët ose në bazë të vlerësimit të ndikimit të kryer në përputhje me Aneksin I ose të monitorimit të survejimit janë të identifikuar në rrezik për të mos përmbushur objektivat mjedisore sipas Aneksit III dhe për ato trupa ujore në të cilat shkarkohen substancat e listës prioritare. Pikat e monitorimit për substancat e listës prioritare duhet të zgjidhen siç specifikohet në legjislacionin që parashtron standartet përkatëse të cilësisë mjedisore. Në të gjitha rastet e tjera, duke përfshirë edhe substancat e listës prioritare, kur nuk është dhënë udhëzim specifik në legjislacion, pikat e monitorimit duhet të zgjidhen si vijon:

- për trupat në rrezik nga trysnitë e rëndësishme të burimeve pikë, pika monitorimi të mjaftueshme brenda çdo trupi me qëllim që të vlerësohet madhësia dhe ndikimi i burimit pikë. Kur një trup i nënshtrohet një sërë trysnesh të burimeve pikë, pikat e monitorimit mund të zgjidhen për të vlerësuar madhësinë dhe ndikimin e këtyre presioneve në tërësi,

- për trupat në rrezik nga trysnitë e rëndësishme të burimeve të përhapjes, pika të mjaftueshme monitorimi brenda zgjedhjes së trupave me qëllim që të vlerësohet madhësia dhe ndikimi i trysnive të burimeve të përhapjes. Zgjedhja e trupave duhet të bëhet në mënyrë të tillë që ata të jenë përfaqësues të rreziqeve relative të ndodhjes së trysnive të burimeve të përhapjes, dhe të rreziqeve relative të mos realizimit të arritjes së statusit të mirë për ujërat sipërfaqësore,
- për trupat në rrezik nga trysnitë e rëndësishme hidromorfologjike, pika të mjaftueshme monitorimi brenda një përzgjedhje të trupave me qëllim që të vlerësohet madhësia dhe ndikimi i trysnive hidromorfologjike. Zgjedhja e trupave duhet të jetë tregues i ndikimit të përgjithshëm të trysnisë hidromorfologjike të cilës i nënshtrohen të gjithë trupat.

Përzgjedhja e elementeve të cilësisë

Për të vlerësuar madhësinë e trysnisë të cilës i nënshtrohen trupat me ujëra sipërfaqësore, Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të monitorojnë për ato elemente të cilësisë të cilat janë tregues të trysnive të cilave i/u nënshtrohen trupi ose trupat. Për të vlerësuar ndikimin e këtyre trysnive, Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të monitorojnë sipas nevojës:

- parametrat tregues të elementit ose elementeve biologjike të cilësisë, që janë më të ndjeshme ndaj trysnive të cilave u nënshtrohen trupat ujore,
- të gjitha substancat prioritare të shkarkuara, dhe ndotësit e tjerë të shkarkuar në sasi të konsiderueshme,
- parametrat tregues të elementëve të cilësisë hidromorfologjike më të ndjeshëm ndaj trysnisë së identifikuar.

1.3.3. Projektimi i monitorimit investigativ

Objektivi

Monitorimi investigative duhet kryer:

- kur është e panjohur arsyeja për çdo tejkallim,
- ku monitorimi i survejimit tregon se objektivat e përcaktuara në Aneksin III për një trup ujqor nuk kanë gjasa për t'u arritur dhe monitorimi operacional nuk është krijuar ende, në mënyrë që të përcaktohen shkaqet e mos përmbushjes së objektivave mjedisore për një trup ujqor ose për trupat ujqorë, ose,

- për të konstatuar madhësinë dhe ndikimet e ndotjes aksidentale,

dhe duhet të informojë për krijimin e një programi masash për arritjen e objektivave mjedisore dhe masave specifike të nevojshme për të korrigjuar efektet e ndotjes aksidentale.

1.3.4. Shpeshtësia e monitorimit

Për periudhën e monitorimit të survejimit, shpeshtësia për monitorimin e parametrave tregues të elementeve të cilësive fiziko-kimike të dhëna më poshtë duhet të zbatohet në qoftë se nuk do të justifikohen intervale më të mëdha në bazë të njohurive teknike dhe të gjykimit të ekspertëve. Për elementet biologjikë ose hidromorfologjikë të cilësisë monitorimi duhet të kryhet të paktën një herë gjatë periudhës së monitorimit të survejimit.

Për monitorimin operacional, shpeshtësia e monitorimit e kërkuar për çdo parametër duhet të përcaktohet nga Këshillat përkatëse të Rrethit të Baseneve Lumore në mënyrë që të sigurohen të dhëna të mjaftueshme për një vlerësim të besueshëm të statusit të elementeve përkatës të cilësisë. Si një udhëzues, monitorimi duhet të zhvillohet në intervale që nuk i tejkalojnë ato që tregohen në tabelën e mëposhtme në qoftë se intervale më të madhe nuk do të jenë të justifikuara në bazë të njohurive teknike dhe gjykimit të ekspertëve.

Shpeshtësia do të zgjidhet në mënyrë që të arrihet një nivel i pranueshëm besimi dhe saktësie. Llogaritjet e besimit dhe të saktësisë të përfuara me anë të sistemit të monitorimit të përdorur duhet të konstatohen në Planin e menaxhimit rrethit të baseneve lumore.

Duhet të zgjidhen shpeshtësi të monitorimit që marrin në konsideratë ndryshueshmërinë e parametrave që rezultojnë si nga kushtet natyrore ashtu edhe ato antropogjene. Kohët në të cilat do të ndërmerret monitorimi duhet të zgjidhen në mënyrë që të minimizojnë ndikimin e ndryshimeve sezonale në rezultate, dhe kështu të sigurojnë që rezultatet pasqyrojnë ndryshimet në trupat ujore si rezultat i ndryshimeve për shkak të trysnisë antropogjenike. Për të arritur këtë objektiv, kur është e nevojshme, duhen kryer monitorime të tjera shtesë gjatë stinëve të ndryshme të të njëjtit vit.

Elementi i cilësisë	Lumenjtë	Liqenet	Ujërat tranzitorë	Ujërat bregdetarë
Biologjik				
Fitoplanktoni	6 muaj	6 muaj	6 muaj	6 muaj
Flora tjetër ujore	3 vjet	3 vjet	3 vjet	3 vjet

Makro invertetbrorët	3 vjet	3 vjet	3 vjet	3 vjet
Peshqit	3 vjet	3 vjet	3 vjet	
Hidromorfologjik				
Vazhdimësia	6 vjet			
Hidrologjia	në vazhdimësi	1 muaj		
Morfologjia	6 vjet	6 vjet	6 vjet	6 vjet
Fiziko-kimike				
Kushtet termike	3 muaj	3 muaj	3 muaj	3 muaj
Oksigjenimi	3 muaj	3 muaj	3 muaj	3 muaj
Kripësia	3 muaj	3 muaj	3 muaj	
Statusi i ushqyesve	3 muaj	3 muaj	3 muaj	3 muaj
Statusi i acidifikimit	3 muaj	3 muaj		
Ndotësit e tjerë	3 muaj	3 muaj	3 muaj	3 muaj
Substancat prioritare	1 muaj	1 muaj	1 muaj	1 muaj

1.3.5. Kërkesa shtesë për monitorimin e zonave të mbrojtura

Programet e monitorimit të kërkuara më lart duhet të plotësohen me qëllim që të përmbushin kërkesat që vijojnë:

Pikat e nxjerrjes së ujit të pijshëm

Trupat me ujëra sipërfaqësore të cilët janë caktuar për nxjerrjen e ujit të destinuar për konsum njerëzor ose që synohen për përdorime të tilla në të ardhmen dhe që ofrojnë mesatarisht më shumë se 100 m³ në ditë duhet të përcaktohen si vende monitorimi dhe duhet të jenë subjekt i monitorimeve të tilla shtesë siç mund të jetë e nevojshme për të përmbushur legjislacionin që rregullon këto ujëra. Këto trupa duhet të monitorohen për të gjitha substancat prioritare të shkarkuara dhe të gjitha substancat e tjera të shkarkuara në sasi të konsiderueshme të cilat mund të ndikojnë statusin e trupit ujqor dhe që kontrollohen sipas legjislacionit për cilësinë e ujit të pijshëm. Monitorimi duhet të kryhet në përputhje me frekuencat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Komuniteti i shërbyer	Frekuenca
<10000	4 herë në vit
10000 deri në 30000	8 herë në vit
>30000	12 herë në vit.

Habitatet dhe zonat e specieve të mbrojtura

Trupat ujorë që formojnë këto zona duhet të përfshihen brenda programeve të monitorimit operacional të referuara më sipër ku, në bazë të vlerësimit të ndikimit dhe të monitorimit të survejimit, ata janë identifikuar në rrezik për të mos plotësuar objektivat e tyre mjedisore sipas Aneksit III. Monitorimi duhet të kryhet për të vlerësuar madhësinë dhe ndikimin e trysnive të rëndësishme përkatëse në këto trupa dhe, ku është e nevojshme, të vlerësojë ndryshimet në statusin e këtyre trupave ujore që rezultojnë nga programet e masave. Monitorimi duhet të vazhdojë derisa zonat të plotësojnë kërkesat e legjislacionit të lidhura me ujërat sipas të cilit ato janë përcaktuar dhe përmbushin objektivat e tyre sipas Aneksit III.

1.4. Klasifikimi dhe prezantimi i statusit ekologjik

1.4.1. Krahasueshmëria e rezultateve të monitorimit biologjik

Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të krijojnë sisteme monitorimi për qëllim të llogaritjes së vlerave të elementeve biologjike të cilësisë të specifikuar për çdo kategori të ujërave sipërfaqësore ose për trupat me uëra sipërfaqësore tepër të modifikuar ose artificiale. Në zbatimin e procedurave të përcaktuara më poshtë për trupat ujore artificial ose tepër të modifikuar, referencat për statusin ekologjik duhet të ndërtohen si referenca ndaj potencialit ekologjik. Sisteme të tilla mund të përdorin specie ose grup specimesh të veçanta që janë përfaqësues të elementit të cilësisë në tërësi.

Me qëllim sigurimin e krahasueshmërisë për sisteme të tilla monitorimi, rezultatet e sistemeve duhet të shprehen si raporte të cilësisë ekologjike për qëllim të klasifikimit të statusit ekologjik. Këto raporte duhet të përfaqësojnë marrëdhënien ndërmjet vlerave të parametrave biologjikë të vëzhguar për një trup me ujëra sipërfaqësor të dhënë dhe vlerave për këto parametra në kushtet e referencës të aplikueshme për atë trup. Raporti duhet të shprehet si vlerë numerike ndërmjet zeros dhe njëshit, ku statusi i lartë ekologjik përfaqësohet nga vlera afër njëshit dhe statusi i keq ekologjik nga vlera afër zeros.

Shkalla e raportit të cilësisë ekologjike për sistemin e monitorimit për çdo kategori ujërash sipërfaqësore duhet të ndahet në pesë klasa që variojnë nga statusi i lartë ekologjik në atë të keq, siç përcaktohet në Seksionin 1.2, duke caktuar një vlerë numerike për secilin nga kufijtë ndërmjet klasave.

1.4.2. Prezantimi i rezultateve të monitorimit dhe klasifikimi i statusit ekologjik dhe potencialit ekologjik

Për kategoritë e ujërave sipërfaqësore, klasifikimi i statusit ekologjik për trupat ujore duhet të përfaqësohet nga vlera më e ulët për rezultatet e monitorimit biologjik and fiziko-kimik për elementët përkatës të cilësisë

të klasifikuar në përputhje me kolonën e parë të tabelës së dhënë më mëposhtë. Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të ofrojnë për çdo rreth të baseneve lumore një hartë që ilustron klasifikimin e statusit ekologjik për çdo trup ujqor, me kode me ngjyra në përputhje me kolonën e dytë të tabelës së dhënë më mëposhtë për të reflektuar klasifikimin e statusit ekologjik të trupit ujqor:

Klasifikimi i statusit ekologjik	Kodi i ngjyrës
I lartë	Blu
I mirë	Jeshile
I moderuar	E verdhë
I dobët	Portokalli
I keq	E kuqe

Për trupat ujqore artificiale dhe tepër të modifikuar, klasifikimi i potencialit ekologjik për trupin ujqor duhet të përfaqësohet nga vlera më e ulët për rezultatet e monitorimit biologjik dhe fiziko-kimik për elementët përkatës të cilësisë të klasifikuar në përputhje me kolonën e parë të tabelës së mëposhtme. Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të ofrojnë për çdo rreth të baseneve lumore një hartë që ilustron klasifikimin e potencialit ekologjik për çdo trup ujqor, me kode me ngjyra përta i përket trupave ujqore artificial në përputhje me kolonën e dytë të tabelës së mëposhtme dhe përta i përket trupave ujqore tepër të modifikuar në përputhje me kolonën e tretë të kësaj table:

Klasifikimi i potencialit ekologjik	Kodi i ngjyrës	
	Trupat ujqore artificiale	Tepër të modifikuar
I mirë dhe më lart	Jeshile e njëtrajtshme dhe vija gri të lehta	Jeshile e njëtrajtshme dhe vija gri të errëta
I moderuar	E verdhë e njëtrajtshme dhe vija gri të lehta	E verdhë e njëtrajtshme dhe vija gri të errëta
I dobët	Portokalli e njëtrajtshme dhe vija gri të lehta	Portokalli e njëtrajtshme dhe vija gri të errëta
I keq	E kuqe e njëtrajtshme dhe vija gri të lehta	E kuqe e njëtrajtshme dhe vija gri të errëta

Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të tregojnë gjithashtu, me anë të një pike të zezë në hartë, ato trupa ujqore ku mos arritja për të arritur status të mirë ose potencial të mirë ekologjik ndodh për shkak të mos

përputhjes me një ose më shumë standarte të cilësisë mjedisore që janë përcaktuar për atë trup ujqor në lidhje me ndotësit specifikë sintetike dhe jo sintetike.

1.4.3. Prezantimi i rezultateve të monitorimit dhe klasifikimi i statusit kimik

Ku një trup ujqor arrin përmbushjen e të gjitha normave mjedisore të cilësisë të përcaktuara në legjislacionin që vendos normat mjedisore të cilësisë duhet të regjistrohet si arritje e statusit të mirë kimik. Në rast të kundërt, trupi duhet të regjistrohet që nuk ka arritur status të mirë kimik.

Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të ofrojnë një hartë për çdo rreth të baseneve lumore që ilustron statusin kimik për çdo trup ujqor, me kode me ngjyra në përputhje me kolonën e dytë të tabelës së dhënë më poshtë për të reflektuar klasifikimin e statusit kimik të trupit ujqor:

Klasifikimi i statusit kimik	Kodi i ngjyrës
I mirë	Blu
Dështon për të arritur status të mirë	E kuqe

2. UJËRAT NËNTOKËSORE

2.1. Statusi sasior i ujërave nëntokësore

2.1.1. Parametrat për klasifikimin e statusit sasior

Regjimi i nivelit të ujërave nëntokësore

2.1.2 Përkufizimi i statusit sasior

Elementet	Status i mirë
Niveli i ujërave nëntokësore	Niveli i ujërave nëntokësore në trupin me ujëra nëntokësor është i tillë që burimi i disponueshëm me ujëra nëntokësore nuk tejkalohet nga norma mesatare vjetore afatgjatë e nxjerrjes.

	<p>Përkatësisht, niveli i ujërave nëntokësore nuk i nënshtrohet ndryshimeve antropogjenike të tilla që do të rezultojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • mos përmbushjen e objektivave mjedisore të specifikuar në Aneksin III për ujërat sipërfaqësore në fjalë, • ndonjë reduktim të rëndësishëm në statusin e këtyre ujërave, • ndonjë dëmtim të rëndësishëm në ekosistemet tokësore që varen direkt nga trupi me ujëra nëntokësore, <p>dhe ndryshimet në drejtimin e rrjedhës që rezultojnë nga ndryshimet e nivelit mund të ndodhin përkohësisht, ose vazhdimisht në një zonë të kufizuar në hapësirë, por këto të tilla nuk shkaktojnë futjen e ujërave të kripur ose ndërhyrje të tjera, dhe nuk tregojnë një tendencë të qëndrueshme dhe të identifikuar qartësisht të shkakuar antropogjenikisht në drejtimin e rrjedhës që ka gjasa të rezultojë në ndërhyrje të tilla.</p>
--	--

2.2. Monitorimi i statusit sasior të ujërave nëntokësore

2.2.1. Rrjeti i monitorimit të nivelit të ujërave nëntokësore

Rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësore duhet të krijohet në përputhje me kërkesat e Pjesës 4 dhe legjislacionit që rregullon trupat ujore që janë përcaktuar për nxjerrjen e ujit të synuar për konsum njerëzor ose që synohet për përdorim të tillë në të ardhmen. Rrjeti i monitorimit duhet të hartohet në mënyrë që të ofrojë një vlerësim të besueshëm të statusit sasior të gjithë trupave ose grupit të trupave me ujëra nëntokësore duke përfshirë vlerësimin e burimeve të disponueshme me ujëra nëntokësore. Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të ofrojnë një hartë ose harta që tregojnë rrjetin e monitorimit të ujërave nëntokësore në planin e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore.

2.2.2. Dendësia e territoreve të monitorimit

Rrjeti duhet të përfshijë pika monitorimi përfaqësuese të mjaftueshme për të vlerësuar nivelin e ujërave nëntokësore për çdo trup apo grup trupash me ujëra nëntokësore duke marrë në konsideratë ndryshimet afat shkurtër dhe afat gjatë në rimbushje dhe në veçanti:

- për trupat me ujëra nëntokësore të identifikuar në rrezik për të mos përmbushur objektivat mjedisore sipas Aneksit III, të sigurojë dendësi të mjaftueshme të pikave të monitorimit për të vlerësuar ndikimin e nxjerrjeve dhe shkarkimeve në nivelin e ujërave nëntokësore,
- për trupat me ujëra nëntokësore brenda të cilëve ujërat nëntokësore rrjedhin përmes një kufiri Shtetëror, të sigurojë që janë ofruar pika të mjaftueshme monitorimi për të vlerësuar

drejtimin dhe normën e rrjedhjes së ujërave nëntokësore përmes kufirit Shtetëror.

2.2.3. Shpeshtësia e monitorimit

Shpeshtësia e vëzhgimeve duhet të jetë e mjaftueshme për të lejuar vlerësimin e statusit sasior të çdo trupi ose grupi trupash me ujëra nëntokësorëduke marrë në konsideratë ndryshimet afat shkurtër dhe afat gjatë në rimbushje. Në veçanti:

- për trupat me ujëra nëntokësore të identifikuar në rrezik për të mos përmbushur objektivat mjedisore sipas Aneksit III, të sigurojë shpeshtësi të mjaftueshme të matjeve për të vlerësuar ndikimin e nxjerrjeve dhe shkarkimeve në nivelin e ujërave nëntokësore,
- për trupat me ujëra nëntokësore brenda të cilëve ujërat nëntokësore rrjedhin përmes një kufiri Shtetëror, të sigurohet shpeshtësi e mjaftueshme matjesh për të vlerësuar drejtimin dhe normën e rrjedhjes së ujërave nëntokësore përmes kufirit Shtetëror.

2.2.4. Interpretimi dhe prezentimi i statusit sasior të ujërave nëntokësore

Rezultatet e përfuara nga rrjeti i monitorimit për një trup ose grup trupash me ujëra nëntokësorë duhet të përdoren për të vlerësuar statusin sasior të atij trupi ose atyre trupave. Sipas pikës 2.5, Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të ofrojnë një hartë të vlerësimit rezultues të statusit sasior të ujërave nëntokësore, me kode me ngjyra në përputhje me regjimin që vijon:

I mirë	Jëshile
I dobët	E kuqe

2.3. Statusi kimik i ujërave nëntokësore

2.3.1. Parametrat për përcaktimin e statusit kimik të ujërave nëntokësore

(a) Konduktiviteti

(b) Përqëndrimet e ndotësve

Ndotësi	Norma e cilësisë
Nitratat	50mg/l
Substancat aktive të pesticidet, përfshirë metabolitët (substancat e lidhura me metabolizmin) e tyre përkatës, produktet e degradimit dhe reaksionit	0.1µg/l 0.5µg/l (total) Ku totali nënkupton shumën e të gjitha pesticideve individuale të zbuluara dhe me sasi të përcaktuar në procedurat e monitorimit, duke përfshirë metabolitët e tyre përkatës, produktet e degradimit dhe të reaksionit

Këshilli i Ministrave, me propozim të Këshillit Kombëtar të Ujërave, duhet të përcaktojë me legjislacion të veçantë vlerat e pragut për ndotësit, grupet e ndotësve dhe treguesit e ndotjes që janë identifikuar nga Këshillat e Baseneve Lumore si kontribues të karakterizimit të trupave ose grupeve të trupave me ujëra nëntokësore që janë në rrezik. Vlerat e pragut do të krijohen në mënyrë të tillë që, nëse rezultatet e monitorimit në një pikë përfaqësuese monitorimi tejkalojnë pragun, kjo do të tregojë rrezik që një ose më shumë kushte nuk janë plotësuar për statusin e mirë kimik të ujërave nëntokësore.

Në përcaktimin e vlerave të pragut, duhet marrë parasysh:

1. përcaktimi i vlerave të pragut duhet të bazohet në:
 - a. masën e ndërveprimeve ndërmjet ujërave nëntokësore dhe ekosistemeve të lidhura ujore dhe ekosistemeve tokësore të varura
 - b. interferimin me përdorimet e ligjshme aktuale ose potenciale ose funksionet e ujërave nëntokësore
 - c. të gjithë ndotësit që karakterizojnë trupat me ujëra nëntokësore në rrezik
 - d. karakteristikat hidro-gjeologjike përfshirë informacion për nivelet e sfondit dhe balancën e ujërave.

2. përcaktimi i vlerave të pragut duhet të marrë parasysh edhe origjinën e ndotësve, ndodhjen e tyre të mundshme natyrore, tendencën e tyre toksikologjike dhe shpërndarëse, potencialin e tyre të vazhdimësisë/kohëzgjatjes dhe bio-akumulimit.
3. në të gjitha rastet kur ka nivele sfondi të ngritura të substancave ose joneve ose indikatorëve të tyre si rezultat i shkaqeve natyrore hidro-gjeologjike, duhet të merren në konsideratë këto nivele sfondi në trupin përkatës me ujëra nëntokësore gjatë përcaktimit të vlerave të pragut.
4. përcaktimi i vlerave të pragut duhet të mbështetet nga një mekanizëm kontrolli për të dhënat e mbledhura, bazuar në vlerësimin e cilësisë së të dhënave, konsideratat analitike, dhe nivelet e sfondit për substancat që mund të ndodhin si në mënyrë natyrore, ashtu edhe si rezultat i aktivitetit njerëzor.
5. Vlerat të pragut të aplikueshme për statusin e mirë kimik duhet të bazohen në mbrojtjen e trupit me ujëra nëntokësore në përputhje me pikat 1-3 më sipër, duke patur parasysh në mënyrë të veçantë ndikimin e tij, dhe ndërmarrëdhënien me, ujërat sipërfaqësore përkatëse dhe ekosistemet e varura direkt dhe ligaëtinat dhe duhet, ndërmjet të tjerash, të marri parasysh konsideratë njohuritë njerëzore për toksikologjinë dhe ekotoksikologjinë.

Kur përcaktohen vlerat e pragut minimalisht duhet të merren në konsideratë ndotësit e mëposhtëm:

1. Substancat ose jonet ose indikatorët që mund të ndodhen si në mënyrë natyrore dhe/ose si rezultat i aktiviteteve njerëzore, përfshirë: arsenikun, kadmiumin, plumbin, mërkurin, amoniakun, klorin, sulfatin.
2. Substancat sintetike artificiale, përfshirë: trikloroetilenin, tetrakloroetilenin.
3. Parametrat tregues të kripësisë ose futjeve të tjera, përfshirë: konduktivitetin.

Vlerat e pragut mund të përcaktohen në nivel kombëtar, në nivel rrethi të baseneve lumore, ose në nivel të një trupi ose grupi trupash me ujëra nëntokësore. Për trupat me ujëra nëntokësore që janë të përbashkët me një Shtet tjetër dhe për trupa me ujëra nëntokësore brenda të cilëve ujërat nëntokësore rrjedhin përmes kufirit kombëtar, Këshilli i Ministrave duhet të bëjë përpjekjet maksimale për të përcaktuar vlerat e pragut në

bashkëpunim me Shtetet e tjera përkatëse në përputhje me Nenin xxxx të Ligjit “Për Menaxhimin e Ujërave”.

Lista e vlerave të pragut duhet të amendohet sa herë që një informacioni i ri për ndotësit, grupet e ndotësve ose indikatorët e ndotjes tregojnë se vlera e pragut duhet të vendoset për një substancë shtesë, që një vlerë pragu ekzistuese duhet të amendohet, ose që një vlerë pragu e hequr më parë nga lista duhet të rifutet, me qëllim që të mbrohet shëndeti i njerëzve dhe mjedisi. Vlerat e pragut mund të hiqen nga lista kur trupi me ujëra nëntokësore në fjalë nuk është më në rrezik nga ndotësit përkatës, grupet e ndotësve, ose indikatorët e ndotjes.

Të gjitha ndryshimet e tilla në listën e vlerave të pragut duhet të raportohen në kontekstin e rishikimit periodik të Planeve të Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore.

2.3.2. Përkufizimi i statusit kimik të mirë të ujërave nëntokësore

Një trup ose një grup trupash me ujëra nëntokësorë duhet të konsiderohet se kanë status kimik të mirë kur:

(a) vlerat e pragut të përcaktuara në përputhje me paragrafin 2.3.1 më sipër nuk tejkalohen në ndonjë pikë monitorimi në atë trup ose grup trupash me ujëra nëntokësorë, ose

(b) monitorimi përkatës demonstroi që janë plotësuar kushtet e përcaktuara në tabelën e mëposhtme: ose

Elementet	Statusi i mirë
Të përgjithshme	<p>Përbërja kimike e trupit me ujëra nëntokësor është e tillë që përqëndrimet e ndotësve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • siç specifikohet më poshtë, nuk shfaqin efekte të kripësisë ose futjeve të tjera • nuk tejkalojnë normat e aplikueshme cilësisë të zbatueshme sipas legjisllacioneve të tjera • nuk janë të tilla që të rezultojnë në mos përmbushjen e objektivave mjedisore të specifikuara sipas Aneksit III për trupat me ujëra sipërfaqësore përkatës, në asnjë reduktim të rëndësishëm të cilësisë ekologjike ose kimike të këtyre

	trupave dhe as në ndonjë dëmtim të rëndësishëm të ekosistemeve tokësore që varen direkt nga trupi me ujëra nëntokësore
Konduktiviteti	Ndryshimet në konduktivitet nuk janë treguese të kripësisë ose futjeve të tjera në trupin me ujëra nëntokësore

(c) vlera për normën e cilësisë ose vlera e pragut e ujërave nëntokësore tejkalohe në një ose më shumë pika monitorimi, por një investigim i duhur në përputhje me paragrafin 2.3.3 konfirmon që:

- (i) në bazë të vlerësimit të referuar në pikën 3 të paragrafit 2.3.3, përqëndrimet e ndotësve që tejkalojnë standartet e cilësisë ose vlerat e pragut të ujërave nëntokësore nuk konsiderohen se paraqesin risk të rëndësishëm mjedisor, duke marrë parasysh, ku është e mundur, shkallën në të cilën është ndikuar trupi me ujëra nëntokësore;
- (ii) kushtet e tjera për statusin e mirë kimik të ujërave nëntokësore të përcaktuara në Tabelën 2.3.2 në Aneksin V janë plotësuar, në përputhje me pikën 4 të paragrafit 2.3.3;
- (iii) trupat me ujëra nëntokësore të përdorur ose që synohen të përdoren në të ardhmen për nxjerrjen e ujit për konsum njerëzor dhe të identifikuar në përputhje me Nenin xxx të Ligjit “Për Menaxhimin e Ujërave”, kërkesat e Nenit xxx të Ligjit “Për Menaxhimin e Ujërave” janë plotësuar, në përputhje me pikën 4 të paragrafit 2.3.3;
- (iv) mundësia e trupit me ujëra nëntokësore ose ndonjërit prej trupave në grupin e trupave më ujëra nëntokësore për të mbështetur përdorimet nga njerëzit nuk është dëmtuar në mënyrë të konsiderueshme nga ndotja.

Në qoftë se një trup me ujëra nëntokësore është klasifikuar që ka status kimik të mirë, Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të ndërmarrin masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të mbrojtur ekosistemet ujore, ekosistemet tokësore dhe përdorimet nga njerëzit të ujërave nëntokësore që varen nga ajo pjesë e trupit me ujëra nëntokësore e përfaqësuar nga pika ose pikat monitoruese tek të cilat është tejkalar vlera për normën e cilësisë të ujërave nëntokësore ose vlera e pragut.

2.3.3 Vlerësimi i statusit kimik të ujërave nëntokësore

1. Proçedura e vlerësimit për përcaktimin e statusit kimik të një trupi ose grupi trupash me ujëra nëntokësore duhet të kryhet në lidhje me të gjithë trupat ose grupet e trupave me ujëra nëntokësore të karakterizuar në rrezik dhe në lidhje me secilin nga ndotësit që kontribuojnë në trupin ose grupin e trupave me ujëra nëntokësore të karakterizuar si të tillë.
2. Gjatë kryerjes së investigimeve të referuara në paragrafin 2.3.2 (c) më sipër, Këshillat përkatës të Baseneve Lumore duhet të marrin në konsideratë:
 - (a) informacioni i mbledhur si pjesë e karakterizimit që do të kryhet në përputhje me Paragrafin 25 dhe me seksionin 2.1, 2.2 dhe 2.3 të Aneksit I;

- (b) rezultatet e rjetit të monitorimit të ujërave nëntokësore të përfuara në përputhje me seksionin 2.4 më poshtë; dhe
- (c) Çdo informacion tjetër përkatës përfshirë krahasimin e përqëndrimit mesatar aritmetik vjetor të ndotësve në pikën e monitorimit me normat e cilësisë së ujërave nëntokësore të përcaktuara në seksionin 2.3.2 dhe secilës prej vlerave të përcaktuara të pragut.
3. Për qëllime të investigimit nëse janë plotësuar kushtet për statusin e mirë kimik të ujërave nëntokësore të referuara në seksionin 2.3.2(c)(i) dhe (iv) më sipër, Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore, ku duhet dhe është e nevojshme, dhe në bazë të aggregateve të përshtatshëm rezultatet e monitorimit, mbështetur sipas nevojës nga vlerësimet e përqëndrimit bazuar në një model konceptual të trupit ose grupit të trupave me ujëra nëntokësore, duhet të vlerësojnë shkallën e trupit me ujëra nëntokësore që ka përqëndrim vjetor aritmetik mesatar të një ndotësi më të lartë se norma e cilësisë ose vlera e pragut e ujërave nëntokësore.
4. Për qëllime të investigimit janë plotësuar kushtet për statusin e mirë kimik të ujërave nëntokësore të referuara në seksionin 2.3.2(c)(ii) dhe (iii) më sipër, Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore, ku duhet dhe është e nevojshme, dhe në bazë të rezultateve përkatëse të monitorimit dhe modelit konceptual të përshtatshëm të trupit me ujëra nëntokësore, vlerëson:
- (a) ndikimin e ndotësve në trupin me ujëra nëntokësor;
- (b) sasi të dhe përqëndrimet e ndotësve që janë ose kanë gjasa të jenë transferuar nga trupi me ujëra nëntokësore tek ujërat sipërfaqësore përkatës ose ekosistemet tokësore në varësi direkte;
- (c) ndikimin e mundshëm të sasive dhe përqëndrimet e ndotësve të transferuar tek ujërat sipërfaqësore përkatës dhe ekosistemet tokësore në varësi direkte;
- (d) shkallën e çdo kripësie ose futjeve të tjera në trupin me ujëra nëntokësore; dhe
- (e) rreziku nga ndotësit në trupin me ujëra nëntokësore ndaj cilësisë së ujit të nxjerrë, ose që synohet të nxirret nga trupi me ujëra nëntokësore për konsum njerëzor.
5. Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore duhet të paraqesin statusin kimik të ujërave nëntokësore të një trupi ose grupi trupash me ujëra nëntokësore në harta në përputhje me Seksionet 2.4.5 dhe 2.5 më poshtë. Përveç kësaj, Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore do të tregojnë në këto harta të gjitha pikat e monitorimit ku janë tejkalluar normat e cilësisë dhe/ose vlerat e pragut të ujërave nëntokësore, ku duhet dhe është e mundur.
6. Plani përkatës i Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore duhet të përfshijë një përmbledhje të vlerësimit të statusit kimik të ujërave nëntokësore. Kjo përmbledhje duhet të përfshijë një shpjegim për mënyrën si janë marrë në konsideratë për vlerësimin final tejkallimet e

normave të cilësisë ose vlerat e pragut të ujërave nëntokësore në pikat individuale të monitorimit.

2.4. Monitorimi i statusit kimik të ujërave nëntokësore

2.4.1. Rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësore

Rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësore duhe të krijohet në përputhje me kërkesat e Pjesës 4 dhe legjislacionit që rregullon trupat ujqorë të përcaktuar për nxjerrjen e ujërave të synuar për konsum njerëzor ose që synohen për përdorime të tilla në të ardhmen. Rrjeti i monitorimit duhet projektuar në mënyrë të tillë që të ofrojë një përmbledhje koherente dhe gjithëpërfshirëse të statusit kimik të ujërave nëntokësore brenda çdo baseni lumi për të ofruar të dhëna monitorimi përfaqësuese për të dalluar prezencën e tendencave afat gjata në rritje të shkaktuara antropogjenikisht tek ndotësit.

Në bazë të e vlerësimit të ndikimit të kryer në përputhje me Pjesën 2 Kreu 1 dhe Aneksi I, Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore duhet të krijojnë një program monitorimi survejues për çdo periudhë për të cilën aplikohet plani i menaxhimit të rrethit të baseneve lumore. Rezultatet e këtij programi duhet të përdoren për të hartuar një program monitorimi operacional që do të aplikohet për periudhën e mbetur të planit.

Në plan duhet të jepen përlllogaritjet e nivelit të besimit dhe saktësisë së rezultateve të ofruara nga programet e monitorimit.

2.4.2. Monitorimi i survejimit

Objektivi

Monitorimi i survejimit duhet të kryhet me qëllim që:

- të plotësojë dhe të bëjë të vlefshme procedurën e vlerësimit të ndikimit,
- të ofrojë informacion për përdorimin në vlerësimin e tendencave afat-gjata si rezultat i ndryshimeve të kushteve natyrore dhe nëpërmjet aktivitetit antropogjenik.

Përzgjedhja e territoreve të monitorimit

Duhen të përzgjidhen territore të mjaftueshme monitorimi për secilën nga pikat që vijojnë:

- trupat e identifikuar në rrezik në bazë të ushtrimit të karakterizimit të ndërmarrë në përputhje me Aneksin I,
- trupat që kalojnë kufirin Shtetëror.

Përzgjedhja e parametrave

Grupi i mëposhtëm i parametrave kryesorë duhet të monitorohet për të gjithë trupat e përzgjedhur për ujëra nëntokësorë:

- përmbajtja e oksigjenit
- vlera e pH
- konduktiviteti
- nitratet
- amoniaku

Trupat që janë identifikuar në rrezik për të mos përmbushur statusin e mirë në përputhje me Aneksin I duhet të monitorohen për ato parametra që janë tregues të ndikimit të këtyre trysnive.

Trupat ujore ndër-kufitare duhet të monitorohen gjithashtu për ato parametra që kanë lidhje me mbrojtjen e të gjitha përdorimeve të mbështetura nga rrjedha e ujërave nëntokësore.

2.4.3. Monitorimi operacional

Objekti

Monitorimi operacional duhet të ndërmerret në periudhat midis programeve të monitorimit survejues me qëllim që:

- të përcaktojë statusin kimik të të gjithë trupave ose grupeve të trupave me ujëra nëntokësorë të përcaktuar në rrezik,
- të përcaktojë prezencën e çdo tendence afatgjndonjë në rritje të shkaktuar antropogjenikisht në përqëndrimin e çdo ndotësi.

Përzgjedhja e territoreve të monitorimit

Monitorimi operacional duhet të kryhet për ato trupa ose grupe trupash me ujëra nëntokësore të cilët si në bazë të vlerësimit të ndikimit të kryer në përputhje me Aneksin I, ashtu edhe në bazë të monitorimit të survejimit jaën identifikuar në rrezik për të mos përmbushur objektivat e

Aneksit III. Përzgjedhja e territoreve të monitorimit duhet të reflektojë gjithashtu një vlerësim për mënyrën se si të dhënat përfaqësuese të monitorimit nga ai territor kanë të njëjtën cilësi si të trupit apo trupave përkatës me ujëra nëntokësore.

Shpeshësia e monitorimit

Monitorimi operacional duhet të kryhet për periudha ndërmjet programeve të monitorimit të survejimit me një shpeshësi të mjaftueshme për të zbuluar ndikimet e trysnive përkatëse, por të paktën një herë në vit.

2.4.4. Identifikimi i tendencave tek ndotësit

Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore duhet të përdorin të dhëna nga monitorimi operacional dhe ai survejues për identifikimin e tendencave afatgjata në rritje të shkaktuara antropogjenikisht tek përqëndrimet e ndotësve dhe rikthimin e këtyre tendencave. Duhet të identifikohet viti ose periudha bazë në të cilën duhet të llogaritet identifikimi i tendencave. Llogaritja e tendencave duhet të ndërmerret për një trup, ose kur duhet, për një grup trupash ujorë. Rikthimet e tendencave duhet të demonstrohen statistikisht dhe duhet të deklarohet, niveli i konfidencës i shoqëruar me identifikimin.

2.4.5. Interpretimi dhe prezantimi i statusit kimik të ujërave nëntokësore

Gjatë vlerësimit të statusit, rezultatet e pikave individuale të monitorimit brenda një trupi me ujëra nëntokësore duhet të grumbullohen për trupin si një i tërë. Për arritjen e statusit të mirë nga një trup me ujëra nëntokësore, për ato parametra kimike për të cilat normat e mjedisore të cilësisë janë përcaktuar në një legjislacion tjetër:

- vlera mesatare e rezultateve të monitorimit në çdo pikë të trupit apo grupit të trupave me ujëra nëntokësore, duhet të llogaritet, dhe
- këto vlera mesatare duhet të përdoren për të demonstruar përputhshmërinë me statusin kimik të mirë të ujërave nëntokësore.

Subjekt i pikës 2.5, Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore duhet të ofrojnë një hartë të statusit kimik të ujërave nëntokësore, më kode me ngjyra si tregohet më poshtë:

I mirë	Jeshile
I dobët	E kuqe

Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore duhet të tregojnë gjithashtu me një pikë të zezë në hartë, ato trupa me ujëra nëntokësore që janë subjekt i një tendence të rëndësishme dhe të qëndrueshme në rritje tek përqëndrimet e të gjithë ndotësve që vijnë nga ndikimi i aktiviteteve njerëzore. Rikthimi i një tendence duhet të tregohet me një pikë blu në hartë.

Këto harta duhet të përfshihen në Planin e Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore.

2.5. Prezantimi i Statusit të Ujërave Nëntokësore

Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore duhet të ofrojnë në Planin e Menaxhimit të Rrethit të Baseneve Lumore një hartë ku të tregojnë për çdo trup ose grup trupash me ujëra nëntokësore si statusin sasior ashtu edhe atë kimik të atij trupi apo grupi trupash, me kode me ngjyra në përputhje me kërkesat e pikave 2.2.4 dhe 2.4.5. Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore mund të zgjedhin që të mos ofrojnë harta të ndara sipas pikave 2.2.4 dhe 2.4.5, por në këtë rast duhet të ofrojnë një tregues në përputhje me kërkesat e pikës 2.4.5 në hartë të kërkuar sipas kësaj pike, për ato trupa ujore që janë subjekt i tendencave të rëndësishme dhe të qëndrueshme në rritje tek përqëndrimi i çdo ndotësi apo rikthimi të tendencave të tilla.

Aneksi VI. Specifikimet teknike për analizën kimike dhe monitorimin e statusit të ujërave

1. Ky aneks parashton specifikimet teknike për analizat kimike dhe monitorimin e statusit të ujërave në përputhje me këtë vendim dhe me ligjin "Për Menaxhimin e Ujërave ". Ai përcakton kriteret minimale të performancës për metodat e analizave që do të zbatohen gjatë monitorimit të statusit të ujërave, sedimentit dhe biota, si dhe rregullat që demonstronë cilësinë e rezultateve analitike.

Metoda e analizave

2. Të gjitha metodat e analizave, duke përfshirë ato laboratorike, metodat në terren ose ato elektronike, të përdorura për qëllim të programeve të monitorimit kimik janë bërë të vlefshme dhe janë dokumentuar në përputhje me standardin EN ISO/IEC-17025 ose standarte të tjera ekuivalente të pranuar në nivel ndërkombëtar.

Kriteret minimale të performancës për metodat e analizave

3. Kriteret minimale të performancës për të gjitha metodat e aplikuara të analizave duhet të bazohen në një pasiguri të matjes prej 50% ose më poshtë ($k = 2$) të llogaritura në nivelin e normave përkatëse të cilësisë mjedisore dhe për një kufi të kuantifikimit të barabartë ose më poshtë vlerës prej 30% të normave përkatëse mjedisore të cilësisë.
4. Në mungesë të një norme përkatëse të cilësisë mjedisore për një parametër të caktuar, ose në mungesë të metodave të analizave që plotësojnë kriteret minimale të performancës të përcaktuara në paragrafin 3, monitorimi duhet të kryhet duke përdorur teknikat më të mira të mundshme që nuk kërkojnë kosto ekstreme.

Llogaritja e vlerave mesatare

5. Kur shumtë e matjeve fiziko-kimike ose kimike të një kampioni të caktuar janë nën kufirin e kuantifikimit, rezultatet e matjes duhet të vendosen në gjysmën e vlerës së kufirit të kuantifikimit në fjalë për llogaritjen e vlerave mesatare.
6. Kur një vlerë mesatare e llogaritur e rezultateve të matjeve të referuara në paragrafin 5 është nën kufijtë e kuantifikimit, vlera duhet të referohet si "më pak se kufiri i kuantifikimit".
7. Paragrafi 5 nuk zbatohet për matjet që janë shumtë totale të një grupi të caktuar të parametrave fiziko-kimike ose matjeve kimike, duke përfshirë metabolitët përkatës të tyre, degradimin dhe produktet e reaksioneve. Në këto raste, rezultatet nën kufirin e kuantifikimit për substanca të veçanta duhet të vendoset në zero.

Kontrolli dhe sigurimi i cilësisë

8. Labororet ose palët e kontraktuara nga labororet duhet të zbatojnë praktikën e sistemeve të menaxhimit të cilësisë në përputhje me EN ISO/IEC-17025 apo standarte të tjera ekuivalente të pranuar në nivel ndërkombëtar.
9. Labororet ose palët e kontraktuara nga labororet duhet të demonstronë kompetencat e tyre në analizimin përkatës të matjeve fiziko-kimike ose kimike nëpërmjet:
 - a. Pjesëmarrjes në programet e testimit të zotësisë që mbulojnë metodat e analizave të referuara në Paragrafin 2 për matjet në nivele të përqendrimeve që janë përfaqësuese të programeve të monitorimit kimik;

- b. Analiza e materialeve të referencës në dispozicion që janë përfaqësues të kampioneve të mbledhur që përmbajnë nivelet të përshtatshme përqendrimi në lidhje me normat përkatëse mjedisore të cilësisë të referuara në Paragrafin 3.
-
- 10. Programet e testimit të zotësisë të referuara në Paragrafin 9 (a) duhet të organizohen nga organizata të akredituara ose organizata të njohura në rang kombëtar ose ndërkombëtar të cilat plotësojnë kërkesat e udhëzuesit 43-1 ISO / IEC ose të standarteve të tjera ekuivalente të pranuar në nivel ndërkombëtar.
 - 11. Rezultatet e pjesëmarrjes në programet e referuara në Paragrafin 10, duhet të vlerësohen në bazë të sistemeve të llogaritjes së pikëve të përcaktuara në udhëzuesin 43-1 ISO / IEC ose në standartin ISO-13528, ose në standarte të tjera ekuivalente të pranuar në nivel ndërkombëtar.

Aneksi VII. Identifikimi dhe rikthimi i tendencave të rëndësishme e të qëndrueshme në rritje tek ndotja e ujërave nëntokësore

Pjesa A

Identifikimi i tendencave të rëndësishme e të qëndrueshme në rritje

Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore duhet të identifikojnë tendencat e rëndësishme dhe të qëndrueshme në rritje tek të gjithë trupat ose grupet e trupave me ujëra nëntokësore që janë karakterizuar si të rrezikuar në përputhje me Aneksin I të këtij Vendimi, duke marrë parasysh kërkesat e mëposhtme:

- 1) në përputhje me Seksionin 2.4 të Aneksit V të këtij Vendimi, programi i monitorimit duhet të hartohet në mënyrë që të zbulojë tendencat e rëndësishme dhe të qëndrueshme në rritje tek përqëndrimet e ndotësve të identifikuar sipas Seksionit 2.4 të Aneksit V të këtij Vendimi;
- 2) procedura për identifikimin e tendencave të rëndësishme dhe të qëndrueshme në rritje duhet të bazohet në elementet e mëposhtme:
 - (a) shpeshtësitë e monitorimit dhe vendet e monitorimit do të zgjidhen në mënyrë që të jenë të mjaftueshme për të:
 - (i) ofruar informacionin e nevojshëm për të siguruar që tendencat në rritje mund të dallohen nga ndryshimet natyrore me nivelin e duhur të besimit dhe të saktësisë;
 - (ii) mundësuar që tendenca të tilla në rritje të identifikohen në kohë të mjaftueshme për të lejuar zbatimin e masave për të parandaluar, ose të paktën për t'i zbutur sa është e mundur, ndryshimet e dëmshme të rëndësishme mjedisore në cilësinë e ujërave nëntokësore. Ky identifikim do të kryhet për herë të parë në vitin 2015, nëse është e mundur, dhe do të marrë parasysh të dhënat ekzistuese, në kontekstin e raportit për identifikimin e tendencës brenda e planit të parë të menaxhimit të rrethit të baseneve llumore, dhe më pas të paktën çdo gjashtë vjet;
 - (iii) marrë parasysh karakteristikat e përkohshme fizike dhe kimike të trupit me ujëra nëntokësore, duke përfshirë kushtet e rrjedhës së ujërave nëntokësore dhe normat e rimbushjeve dhe kohën e filtrimit nëpërmjet tokës ose nëntokës;
 - (b) metodat e monitorimit dhe analizat e përdorura duhet të jenë në përputhje me parimet ndërkombëtare të kontrollit të cilësisë, duke

përfshirë, nëse është e mundur, CEN ose metoda të tjera kombëtare të standartizuara, për të siguruar cilësi shkencore të njëjtë dhe krahasueshmëri të të dhënave të ofruara;

- (c) vlerësimi do të bazohet në metoda statistikore, të tilla si analiza e regresionit, për analizën e tendencave në intervale kohore në pika monitorimi individuale;
 - (d) në mënyrë që të shmangen paragjykimet në identifikimin e tendencave, të gjitha matjet nën kufirin e kuantifikimit duhet të vendosen në gjysmën e vlerës së kufirit më të lartë të kuantifikimit që ndodh në intervale kohore, me përjashtim të pesticideve totale;
- 3) identifikimi i tendencave të rëndësishme dhe të qëndrueshme në rritje tek përqëndrimet e substancave të cilat ndodhin si në mënyrë të natyrore ashtu dhe si rezultat i aktiviteteve të njeriut do të konsiderojë nivelet bazë dhe, ku këto të dhëna janë të disponueshme, të dhënat e mbledhura përpara fillimit të programit të monitorimit në mënyrë që të raportohet për identifikimin e tendencave brenda planit të parë të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore.

Pjesa B

Pikat e nisjes për kthimin e tendencave

Këshillat përkatëse të Baseneve Lumore duhet të kthejnë tendencat e identifikuara të rëndësishme e të qëndrueshme në rritje, në përputhje me Pjesën 5 të këtij Vendimi, duke marrë parasysh kërkesat e mëposhtme:

- 1) pikë nisjeje për zbatimin e masave për të kthyer tendencat e rëndësishme dhe të qëndrueshme në rritje do të jetë kur përqëndrimi i ndotësve të arrijë 75% të vlerave parametrike të vlerave të normave të cilësisë së ujërave nëntokësore të përcaktuara në Seksionin 2,4 të Aneksit V të këtij Vendimi dhe vlerave të pragut të përcaktuara aty, përveç nëse:
 - (a) për të mundësuar masat për kthimin e tendencave kërkohet një pikë nisjeje më e hershme për të parandaluar me pak kosto ndryshimet e rëndësishme mjedisore të dëmshme në cilësinë e ujërave nëntokësore ose të paktën t'i zbutur ato sa më shumë të jetë e mundur;
 - (b) një pikë nisjeje e ndryshme është e justifikuar kur kufiri i zbulimit nuk lejon përcaktimin e prezencës së një tendence në 75% të vlerave parametrike, ose

- (c) norma e rritjes dhe rikthimi i tendencës janë të tilla që një pikë nisjeje e mëvonshme për masat e kthimit të tendencës ende do t'i mundësonte këto masave për të parandaluar me pak kosto ndryshimet e rëndësishme mjedisore të dëmshme në cilësinë e ujërave nëntokësore ose të paktën për t'i zbutur ato sa më shumë të jetë e mundur. Këto pika nisjeje të mëvonshme mund të mos çojnë në ndonjë vonesë për arritjen e afatit të fundit për objektivat mjedisore.
- 2) Pasi është përcaktuar pika e nisjes për një trup me ujëra nëntokësore të karakterizuar në rrezik në përputhje me Seksionin 2.4.4 të Aneksit V dhe në përputhje me pikën 1 më lart, ajo nuk do të ndryshohet gjatë ciklit gjashtë vjeçar të planit të menaxhimit të rrethit të baseneve lumore;
- 3) kthimi i tendencave do të demonstrohet, duke marrë parasysh dispozitat përkatëse të monitorimit të përfshira në Pjesën A, pika 2.

Aneksi VIII. Planet e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet

Pjesa 1 Planet e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet

1. Përbërësit e planit të parë të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet:
 - (a) (Konkluzionet e vlerësimit paraprak të rreziqeve nga përmbytjet në formën e një harte përmbledhëse të rrethit të baseneve lumore që vijëzon zonat e përcaktuara nga Paragrafi 87, ku ekziston risku potencial ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, dhe që janë subjekt i atij plani menaxhimi të rrezikut nga përmbytjet;
 - (b) Hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe hartat e riskut nga përmbytjet dhe konkluzionet që mund të nxirren nga këto harta;
 - (c) Një përshkrim i objektivave të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet të përcaktuara në përputhje me Paragrafin 100;
 - (d) Një përmbledhje të masave dhe të përparësive të tyre që synojnë arritjen e objektivave të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, përfshirë masat e lidhura me përmbytjet të ndërmarra sipas legjislacioneve të tjera, përfshirë:
 - i. Ligjin "Për Menaxhimin e Ujërave"
 - ii. Ligji "Për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor"
 - iii. Ligji "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor"
 - iv. Ligji "Për kontrollin e rreziqeve madhore nga aksidentet që përfshijnë substancat e rrezikshme".
 - (e) Një përshkrim të metodologjisë, ku është e disponueshme, për rrethet ose nën-rrethet ndërkombëtare të baseneve lumore, së përcaktuar nga Shtetet përkatëse, të analizave kosto-përfitim të përdorura për të vlerësuar masat me efekt trans-kombëtar.
2. Përshkrimi i zbatimit të planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet:
 - (a) Një përshkrim të prioritizimit dhe të rrugës me anë të së cilës do të monitorohet progresi i zbatimit të planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet;
 - (b) Një përmbledhje të informimit publik dhe të masa/veprimeve të konsultimit të ndërmarra;
 - (c) Një listë të autoriteteve përkatëse dhe, si të jetë e përshtatshme, një përshkrim të procesit të koordinimit brenda çdo rrethi ndërkombëtar të baseneve lumore dhe të koordinimit me planet e menaxhimit të rrethit të baseneve lumore.

Pjesa 2 Përbërësit e të gjitha përditësimeve vijuese të Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet

1. Çdo ndryshim apo përditësim që nga botimi i versionit të mëparshëm të planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, duke përfshirë një përmbledhje të rishikimeve të kryera në përputhje me Paragrafët 85, 97 dhe 107.
2. Vlerësimi i progresit të bërë drejt arritjes së objektivave të përshtatshme për menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet të përcaktuara në përputhje me paragrafin 100.

3. Përshkrimi i, si dhe shpjegimi për, të gjitha masat e parashikuara në versionin e mëparshëm të planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet të cilat kanë qenë të planifikuara për t'u ndërmarrë dhe nuk janë kryer.
4. Një përshkrim të masave shtesë që nga botimi i mëparshëm i planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.